

BULETIN I VENDIMEVE GJYQËSORE

VOLUMI 2

(Gusht – Dhjetor 2017)



Tabelë Përmbledhëse

1.	VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PROCEDURËN E ANKIMIT	4
2.	MATERIALE REFERIMI	4
3.	PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE.....	5
3.1.	Vendimi nr.56 Datë 02.05.2017, “Për proces të rregullt gjyqësor”	5
4.	PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS SË LART.....	11
4.1.	Vendimi nr.776 datë 19.07.2017, “Për përfshirjen e avokatëve në skemën e TVSH-së”	11
5.	PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE.....	23
5.1.	PAVLEFSHMËRI ABSOLUTE	23
5.1.1.	Vendimi nr.1 datë 21.11.2017	23
5.1.2.	Vendimi nr.2 datë 15.11.2017	30
6.1.3	Vendimi nr.3 datë 22.11.2017	40
5.2.	PAVLEFSHMËRI RELATIVE	49
5.2.1.	ÇËSHTJE TË KONTROLLIT TATIMOR	49
5.2.1.1.	Vendimi nr.1 datë 07.11.2017	49
5.2.2.	ÇËSHTJE TË HETIMIT TATIMOR	61
5.2.2.1.	Vendimi nr.2, “Për mosdeklarim punonjësish”	61
5.2.2.2.	Vendimi nr.3, “Për moslëshim kuponi tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve”	71
5.2.3.	ÇËSHTJE TË TJERA JOTATIMORE.....	79
5.2.3.1.	Vendimi nr.1, “Për mosezauruar rekursi administrative”	79

Në zbatim të nenit 28, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo gjashtë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe në bazë të të cilave, për raste të unifikuara, reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

Ky buletin përmban disa njohuri bazë mbi hapat që ndiqen nga tatimpagusi gjatë procedurës së ankimit, si dhe përmbledhje të disa vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore. Ai është hartuar me një gjuhë të thjeshtë, por duke iu përmbajtur me saktësi terminologjisë ligjore të përdorur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PROCEDURËN E ANKIMIT

Sipas përcaktimeve në Kreun XI, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kur tatimpaguesi nuk është dakord me një akt administrativ dhe beson se Administrata Tatimore nuk e ka zbatuar në mënyrë korrekte ligjin, ka të drejtën e ankimit në Drejtorinë e Apelit Tatimor (DAT) pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke kërkuar shqyrtimin e pavarur të çështjeve që lidhen me këtë akt.

Drejtoria e Apelit Tatimor është përgjegjëse për kryerjen e një shqyrtimi të drejtë dhe të paanshëm të të gjitha ankesave të iniciuara pranë Ministrisë së Financave sipas legjislacionit në fuqi. Për shqyrtimin dhe vendimmarrjen e apeliave tatimore, për vlera mbi 20.000.000 lekë, në Ministrinë e Financave është ngritur Komisioni për Shqyrtimin e Apelit Tatimor (KSHAT), në përbërje të të cilit janë 7 anëtarë, tre përfaqësues të Ministrisë së Financave, dy përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtori i Apelit Tatimor dhe një përfaqësues i Avokaturës së Shtetit. Tatimpaguesi ka të drejtë gjithashtu, të ankohet në rrugë administrative në Drejtorinë Rajonale, apo në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për çdo veprim apo mosveprim të zyrtarëve tatimorë, që mund të shkelin të drejtat e tatimpaguesit. Dërgimi i ankimit pranë DAT është hapi i parë në procesin e apelit/ankimit. Ky hap duhet të merret përpara se ankesa të paraqitet në gjykatë.

Nëse tatimpaguesi nuk pajtohet me vendimin e Drejtorisë së Apelit Tatimor, ka të drejtën ta kundërshtojë atë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Nëse nuk pajtohet me vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, mund ta apeli atë (vendimin) në Gjykatën Administrative të Apelit.

2. MATERIALE REFERIMI

Informacion më të detajuar mund të gjeni në faqen tonë të internetit: <https://www.tatime.gov.al>

Qasja e lirë në legjislacionin dhe rregulloret e përditësuara është e aksesueshme lehtësisht në në ndërfaqjen Legjislacioni, në linkun: <https://ëëë.tatime.gov.al/c/6/legjislacioni>

Kujdes!

Informacioni i paraqitur në këtë material përshkruan situatën sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ky legjislacion mund të jetë objekt ndryshimi apo shfuqizimi. Informacioni ka vetëm qëllim informimi dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillim apo opinion ligjor. Për zgjidhjen e një rasti specifik kërkoni ndihmë profesionale.

3. PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

3.1. Vendimi nr.56 Datë 02.05.2017, “Për proces të rregullt gjyqësor”

KËRKUESE:	Shoqëria X
SUBJEKTE TË INTERESUARA:	Dr.R.T Tatimpaguesve të Mëdhenj Dr.Apelimit Tatimor
OBJEKTI:	Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 30, 49 dhe 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, parashtrimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga materialet e çështjes rezulton se pas kontrollit të ushtruar në shoqërinë “X” sh.a. nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT) të Tatimpaguesve të Mëdhenj është mbajtur raportkontrolli i datës 9.6.2015, në bazë të të cilit është nxjerrë akti administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore me nr. 3339/6 Prot., datë 9.6.2015, sipas të cilit ajo duhet të paguajë detyrimet tatimore së bashku me gjobat në vlerën 293.595.809 lekë.
2. Ndaj këtij akti administrativ shoqëria “X” sh.a. (kërkuësja) ka ushtruar ankim pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor (DAT) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Kjo e fundit, me vendimin nr. 21871/3, datë 12.10.2015, ka vendosur: “*Refuzimin e ankimit për shkak se nuk është paguar apo nuk është vënë garanci bankare për detyrimin e plotë tatimor objekt ankimi (kamatëvonesat e TVSH-së për periudhën 2011/2012, në shumën 5.075.734 lekë) sipas njoftim vlerësimi nr. 3339/6 Prot., datë 9.6.2015, nxjerrë nga DRT e Tatimpaguesve të Mëdhenj*”, me argumentimin se në sistemin informatik konstatohet se ndaj shoqërisë është llogaritur edhe kamatëvonesë për detyrimin për TVSH-në për periudhën dhjetor 2011, në shumën 5.075.734 lekë.
3. Kërkuësja i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë,

me objekt shfuqizimin e akteve të mësipërme administrative.

4. Gjatë gjykimit nga ana e palëve të paditura është kërkuar në gjykim nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, me pretendimin se akti administrativ Njoftim Vlerësimi nuk mund të merret në shqyrtim nga gjykata në kushtet kur ai nuk është marrë më parë në shqyrtim nga organi administrativ epror, pasi pala paditëse në gjykim (kërkuesja) i është drejtuar organit administrativ pa plotësuar detyrimin ligjor të kryerjes së pagesës së detyrimit.

5. Me vendimin e datës 8.2.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur:

“Rrëzimin e kërkesës së ngritur nga Avokati i Shtetit dhe palët e paditura, Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për nxjerrjen e çështjes administrative jashtë juridiksionit gjyqësor”. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë pala e paditur DRT-ja dhe Avokatura e Shtetit.

6. Me vendimin nr. 00-2016-2904, datë 30.3.2016, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *“Prishjen e vendimit (i panumërtuar), datë 8.2.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nxjerrjen e çështjes gjyqësore administrative nr. 6848/420 (31010-07196-80-2015) Regj. Themeltar, jashtë juridiksionit gjyqësor”.*

II

7. Kërkuesja, shoqëria X sh.a., i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

7.1. *Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë*, pasi, duke nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, Gjykata e Lartë i ka mohuar kërkueses gjykimin në themel të pretendimeve të saj. Sipas dispozitave ligjore në fuqi, detyrimi i tatimpaguesit për të bërë ankim në organet tatimore është pagimi paraprak i detyrimit kryesor dhe kamatëvonesave. Përcaktimi i detyrimit është një tagër i organeve tatimore dhe, për rrjedhojë, ligji i referohet shumës së përcaktuar nga tatimet. Por, nga ana tjetër, përlllogaritja e kamatëvonesës nuk është një çështje subjektive e organeve tatimore, por një çështje objektive, që del nga një përlllogaritje matematikore, që bëhet edhe nga vetë subjekti tatimor. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me të drejtë nuk e ka marrë të mirëqenë pretendimin e palës së paditur dhe ka caktuar një ekspert kontabël për të arritur në përfundimin nëse kërkuesja ka paguar shumën e pretenduar. Sipas këtij akti rezulton se shuma që pretendohet si detyrim bazuar në të dhënat e sistemit është fiktive, dhe verbalisht nga pala e paditur është pranuar se ky problem ka lindur edhe për subjekte të tjera. Por në të kundërt me arsyetimin e gjykatës së faktit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kamatëvonesa e detyrimit kryesor duhet të parapaguhet në shumën e përlllogaritur nga organet tatimore, pavarësisht nëse llogaritja është e drejtë apo e gabuar.

7.2. Gjykata e Lartë ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor edhe për kërkimin që ka si shkak të padisë pavlefshmërinë absolute të akteve administrative, ndërkohë që sipas nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative, në të gjitha rastet kur pretendohet pavlefshmëria absolute e aktit, gjykata ka juridiksion për shqyrtimin e çështjes. Në këto raste gjykatat janë të detyruara të shqyrtojnë çështjen dhe nuk mund ta refuzojnë atë me arsyetimin se nuk është shqyrtuar në themel nga organi administrativ. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë të paktën

duhej të kishte urdhëruar Gjykatën Administrative që të vazhdonte shqyrtimin e çështjes për padinë me kërkesë dhe shkak ligjor pavlefshmërinë e akteve administrative.

7.3. *Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.* Neni 9 i ligjit nr. 49/2012 i ka dhënë të drejtë Gjykatës së Lartë që të vendosë për prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit kur ato vendosin nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, por nuk i kanë dhënë të drejtë për të kundërtën, pra për të prishur vendimet e faktit kur e kanë vlerësuar çështjen brenda juridiksionit. Sipas paragrafit të dytë të nenit 9, gjykata që vlerëson çështjen e juridiksionit duhet ta ketë çështjen në shqyrtim në themel. Po sipas kësaj dispozite, vendimi kundër të cilit mund të bëhet ankim i veçantë është vendimi i nxjerrjes së çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Paragrafi i tretë i nenit 9 parashikon vendimin e Gjykatës së Lartë kur konstaton se çështja është brenda juridiksionit, por nuk ka asnjë parashikim për rastet kur Gjykata e Lartë konstaton se çështja është jashtë juridiksionit. Pranimi I ankimit të veçantë edhe në rastet kur gjykatat e faktit vlerësojnë se çështja është brenda juridiksionit gjyqësor bie në kundërshtim me rolin dhe natyrën e Gjykatës së Lartë, e cila shqyrton në shkallë të tretë çështjet për moszbatimin e ligjit ose shkelje të rënda procedurale. Përgjatimisht, Gjykata e Lartë ndërhyr, jashtë funksionit të saj të zakonshëm, për të mbrojtur të drejtat themelore procedurale të palëve në procesin gjyqësor. Në këtë kuptim, ndërhyrja e Gjykatës së Lartë nuk është e domosdoshme dhe nuk përlligjet kur gjykata e faktit vlerëson se çështja duhet të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor. Në përfundim, Gjykata e Lartë nuk duhej të pranonte gjykimin e ankimit të veçantë, por duhej të urdhëronte gjykatën administrative të vazhdonte gjykimin e themelit të çështjes.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuar

8. Kërkuarja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, në kuptim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 30.3.2016, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë me postë në datën 28.2.2017, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar të zbatueshëm sipas ligjit organik të Gjykatës deri në datën 1 mars, kur kanë hyrë në fuqi ndryshimet e reja ligjore në lidhje edhe me afatin e paraqitjes së ankimit individual.

9. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, neni 131/1/f i Kushtetutës parashikon se individ mund t’i drejtohet asaj për gjykimin përfundimtar të pretendimeve për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individ duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi nënkupton se kërkuar duhet t’i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 17, datë 16.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Objekt kërkesë në rastin konkret është një vendim i Kolegjit Administrativ të

Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur përfundimisht nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Në kushtet kur ky vendim është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim nga gjykatat, kërkesja nuk ka mjet tjetër ligjor për të goditur këtë vendim. Po ashtu, pretendimet e ngritura në kërkesë janë të tilla që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Për rrjedhojë, kërkesja legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës në kuptim të nenit 131/1/f të Kushtetutës.

B. Lidhur me themelin e çështjes

B.1. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të së drejtës së aksesit në gjykatë

10. Sipas kërkeses, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit, pasi duke nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor i ka mohuar kërkeses gjykimin në themel të pretendimeve të saj. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me të drejtë nuk e ka marrë të mirëqenë pretendimin e palës së paditur dhe ka caktuar një ekspert kontabël për të arritur në përfundimin nëse kërkesja ka paguar shumën e pretenduar dhe sipas këtij akti shuma që pretendohet si detyrim bazuar në të dhënat e sistemit është fiktive. Por në të kundërt me arsyetimin e gjykatës së faktit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kamatëvonesa e detyrimit kryesor duhet të parapaguhet në shumën e përlllogaritur nga organet tatimore, pavarësisht nëse llogaritja është e drejtë apo e gabuar. Po ashtu, sipas kërkeses, neni 9 i ligjit nr. 49/2012 i ka dhënë të drejtë Gjykatës së Lartë që të vendosë për prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit kur ato vendosin nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, por nuk i kanë dhënë të drejtë për të kundërtën, pra për të prishur vendimet e faktit kur e kanë vlerësuar çështjen brenda juridiksionit. Në zbatim të kësaj dispozite, Gjykata e Lartë nuk duhej të pranonte gjykimin e ankimit të veçantë, por të urdhëronte Gjykatën Administrative të vazhdonte gjykimin e themelit të çështjes.

11. Gjykata ka theksuar se bazuar në parimin *jura novit curia* ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që i është bërë fakteve të çështjes nga kërkesi (*shih vendimet nr. 27, datë 9.5.2012; nr. 50, datë 9.5.2012; nr. 19, datë 25.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pretendimet e kërkeses, edhe pse janë paraqitur veçmas prej saj, duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

12. Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata ka theksuar se termi “*gjykatë*” karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.03.2009; nr.22, datë 22.7.2009; nr. 16, datë 27.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim

i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit. Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjyqtarit të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Bazuar në standardet e mësipërme dhe në rrethanat e çështjes konkrete në shqyrtim rezulton se kërkesja i është drejtuar gjykatës administrative për shfuqizimin e akteve administrative në lidhje me detyrimet tatimore për vlerën e TVSH-së (përfshirë detyrimin, gjoba dhe interesa) dhe vendimit të organit administrativ që ka refuzuar ankimin administrativ. Në gjykim pala e paditur në proces ka pretenduar se kërkesja nuk ka parapaguar detyrimet sipas parashikimeve ligjore dhe për këtë arsye ankimi administrativ nuk është marrë në shqyrtim. Për rrjedhojë është kërkuar edhe nga gjykata nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, për sa kohë që nuk është shteruar rruga administrative. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e ka rrëzuar këtë kërkim, duke arsyetuar se në rastin konkret nga provat e paraqitura nga palët dhe akti i ekspertimit kontabël rezulton se shoqëria paditëse ka paguar të gjithë detyrimin dhe kamatëvonesat që lidheshin me shumën e plotë. Sipas saj, kërkesja i është nënshtruar edhe më parë një kontrolli tatimor, nga i cili kanë rezultuar detyrimet dhe gjobat që ajo duhej të paguante. Pasi ka shlyer detyrimet, shoqëria ka paraqitur ankim administrativ, në përfundim të të cilit DAT-ja ka vendosur shfuqizimin e detyrimit shtesë për periudhën dhjetor 2011 dhe ka kërkuar kryerjen e rikontrollit tatimor për këtë periudhë. Në përfundim të rikontrollit (që i përket çështjes në shqyrtim) rezulton se për kërkesen janë vendosur detyrime tatimore më të ulëta në krahasim me kontrollin e mëparshëm, të cilat shoqëria i kishte të kompensuara dhe për këtë ka paraqitur në gjykim një shkresë nga Drejtoria Tatimore Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, se nuk ka pasur detyrime të papaguara. Kjo rezulton të jetë konfirmuar edhe nga eksperti i thirrur nga gjykata dhe sipas aktit të ekspertimit rezulton se është kryer pagesa e të gjitha detyrimeve dhe kamatëpagesave për qëllime të ankimit administrativ.

15. Vendimi për rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor është kundërshtuar nga pala e paditur në Gjykatën e Lartë. Kolegji Administrativ, në kundërshtim me qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, ka arsyetuar se ankimi administrativ nuk është ezauruar nga kërkesja për faj të saj, sepse ka pasur dijeni lidhur me vlerësimin tatimor dhe kamatëvonesat, si dhe nuk rezulton të ketë kundërshtuar faktin e marrjes dijeni për urdhërpagesën që u përket këtyre të fundit. Po ashtu, ajo arsyeton: “*Gjykata administrative pranon sa nga përmbajtja e shkresave dhe urdhërpagesave përkatëse të lëshuara nga sistemi informatik tatimor, pala paditëse nuk ka shlyer*

shumën... për sa i përket kamatëvonesave sikurse rezulton nga urdhërpagesa... Por, nga ana tjetër, kjo gjykatë thjesht arsyeton se në rastin në gjykim nga provat e paraqitura nga palët dhe akti i ekspertimit kontabël, shoqëria paditëse rezulton të ketë paguar detyrimet tatimore, por pa treguar se përse nuk është shlyer edhe shuma që u përket kamatëvonesave, sikurse rezulton nga urdhërpagesa e administruar dhe pranuar si provë nga vetë gjykata”.

16. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në kundërshtim me funksionin e saj si gjykatë e ligjit, si dhe me standardet e vendosura prej saj, ka bërë një vlerësim të ndryshëm të provave të administruara gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë. Në këtë mënyrë, ajo ka dalë jashtë funksionit të saj ligjor, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

17. Lidhur me argumentin shtesë të kërkuarit, sipas të cilit Gjykata e Lartë nuk ka kompetenca të vendosë nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, Gjykata çmon se ky pretendim është haptazi i pabazuar, pasi është në funksionin e saj të vendosë për të gjitha çështjet që lidhen me kompetencën dhe juridiksionin.

18. Lidhur me pretendimin se Gjykata e Lartë ka cenuar standardin e aksesit në gjykatë kur ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor edhe për kërkimin që ka si shkak të padisë pavlefshmërinë absolute të akteve administrative, Gjykata çmon se ky pretendim është bazuar.

19. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata vlerëson se në rastin konkret Gjykata e Lartë, referuar objektit dhe shkakut të padisë, si dhe pretendimeve të kërkuarit, ishte e detyruar të merrte në shqyrtim e të verifikonte nëse akti administrativ ishte ose jo absolutisht i pavlefshëm dhe nuk mund të refuzonte shqyrtimin e çështjes me arsyetimin se çështja nuk ishte shqyrtuar në themel nga organi administrativ dhe se pala paditëse nuk kishte respektuar kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2016-2904, datë 30.3.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

4. PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS SË LART

4.1. Vendimi nr.776 datë 19.07.2017, “Për përfshirjen e avokatëve në skemën e TVSH-së”

PADITËS: DHOMA KOMBËTARE E AVOKATISË SË SHQIPËRISË;

TË PADITUR: KËSHILLI I MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË;
ME PJESEMARRJEN E AVOKATURËS SË SHTETIT;

PERSON I TRETË: MINISTRIA E FINANCAVE

OBJEKTI: Shfuqizimi pjesërisht i aktit administrativ, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, pika 2, përcaktimi i kufirit minimal për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Baza Ligjore: Nenet 7/a, 10, 15/d, 16, 17/1/a, 18/1, 21 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; nenet 32/a, 106, 154 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, nenet 117, 118 dhe 120 të ligjit nr.92/104, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 11/3 si dhe nenet 107, 108, 109, 116/b, 135 dhe 137 të Kodit të Procedurave Administrative.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.23 datë 28.09.2015 ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesë padisë së paditësit Dhoma Kombëtare e Avokatisë së Shqipërisë si e pabazuar në ligj. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse”.

Kundër vendimit nr.23 datë 28.09.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka ushtruar rekurs, brenda afatit ligjor, pala paditëse Dhoma Kombëtare e Avokatisë, të cilët kanë kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesëpadisë, duke parashtruar këto shkaqe:

- Në padinë e depozituar nga ana jonë, por edhe në zhvillimin e seancave gjyqësore, në asnjë rast nuk është vënë në dyshim identiteti i organit administrativ, në rastin konkret Këshilli i Ministrave

si dhe tagrat ligjore që ligji autorizon për nxjerrjen e aktit ligjor, si në raport me nenin 117/2 ashtu edhe në referim të nenit 159 të ligjit nr.42/2014. Në këto kushte e konsiderojmë të tepërt dhe të pavlerë referimin ndaj germës “b” të nenit 116 të K.Pr.Administrative.

- Situata e shkëljes së ligjit në drejtim të kompetencave që ligji i jep Këshillit të Ministrave është e tillë sa që ka prodhuar pasoja në vlerësim të gabuar të ligjit, pasoja këto të cilat bien ndesh me parime themelore të Tvsh dhe që lidhen me aktivizimin e subjekteve që detyrohen të regjistrohen, të deklarojnë dhe të paguajnë Tvsh.
- Gjykata ka shpallur kërkesën tonë si të pabazuar në ligj, pasi përveç trajtimit doktrinar të pavlefshmërisë absolute, nuk ka paraqitur asnjë fakt real që ti referohet ligjit material.
- VKM nr 953 dt 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, pika 2 është nxjerrë në tejkalim të kompetencave ligjore që ligji material përcakton në nenin 117/2 të tij, është jo vetëm rezultat i leximit linear të dispozitës, ku sigurisht të gjithë njohim morfologjikisht kuptimin e fjalës “kufirit në dallim me fjalën “kufijtë” që tentohet të interpretohet, por ajo që është më e rëndësishme është se ky VKM ka prodhuar pasoja të cilat cenojnë në themel jo vetëm veprimtarinë e profesioneve të lira në përgjithësi dhe të profesionit të avokatit në veçanti, por cenojnë edhe parime të rëndësishme të objektit të Tvsh dhe të sjelljes së saj në raport me ligjin.
- Duke mos marrë në konsideratë qarkullimin vjetor të xhiros për avokatët, si një përjashtim që nuk parashikohet nga ligji, avokatët nuk përfitojnë të drejtën e mospasqyrimit të Tvsh në xhiron e kryer nga ana e tyre. E thënë ndryshe, vetëm për efekt të këtij vendimi, në kundërshtim me kërkesat që përcakton ligji, avokati duhet të raportojë padrejtësisht 20 % më shumë se homologët e tij, subjekte të biznesit në fusha që nuk përfshihen në profesionet e lira, duhet të ritë çmimin e shërbimit të ofruar në masën 20 % dhe duhet të paguajë në formën e Tvsh po 20 % të xhiros së realizuar.
- Sjellim në vëmendje të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë faktin se seancat gjyqësore në Gjykatën e Apelit Administrativ janë drejtuar nga kryetari i kësaj gjykate, njëkohësisht anëtar i trupit gjykues në marrjen e këtij vendimi, z. Kastriot Selita, i cili ka për bashkëshorte një personalitet të lartë të fushës së tatimeve dhe si i tillë nuk duhej të merrte pjesë në një gjykim prej të cilit mund të preken direkt ose indirekt interesat e saj, fakt ky i cili ka ardhur në dijeninë tonë pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe shpalljes së vendimit.

Ka ushtruar kundër rekurs Avokatura e Shtetit duke parashtruar shkaqet e mëposhtme;

- Rekursi i paraqitur prej palës paditëse nuk plotëson kriteret e nenit 58 të ligjit 49/2012 «Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative », për faktin se në rast objekt gjykimi nuk jemi përpara rastit kur prej Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me vendimin e dhënë të mos jetë respektuar ligji material dhe procedural apo vendimi të jetë dhënë në kundërshtim me një vendim të Kolegjit të Administrativ të Gjykatës së Lartë apo me një vendim unifikues.
- Prej palës paditëse nuk merret në konsideratë fakti se kërkimi për pavlefshmëri absolute të aktit pasjellë pavlefshmëri absolute të të gjithë aktit dhe jo vetëm për një pjesë të tij e në këto kushte pala paditëse nuk legjitimohet për të kërkuar pavlefshmërinë absolute të gjithë aktit, i cili në vetvete

krijon rregulla të përgjithshme të cilat janë të detyrueshme për të dalë në zbatim të ligjit.

- Është detyrim ligjor i Këshillit të Ministrave për të nxjerre aktet nën ligjore në zbatim të ligjit e konkretisht të nenit 159 të ligjit 49/2014 që detyron Këshillin e Ministrave dhe Ministrin e Financave për nxjerrjen e akteve nënligjore.
- Vendimi i dhënë prej Gjykatës është i drejtë pasi kërkesë padia e ngritur prej palës paditëse është e pabazuar pasi neni 11 i kësaj VKM nuk është marrë në tejkalim të kompetencave që jep ligji pasi ky përcaktim është bërë për të gjithë tatimpaguesit, që ofrojnë shërbime në veprimtarinë ekonomike, sipas profesioneve, të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, etj.
- Tatimi mbi vlerën e shtuar është taksë, që në fund paguhet nga konsumatori dhe përfshirja në skemën e TVSH, u lejon profesioneve të lira (mes tyre edhe avokatëve), të rimbursojnë tepricën e TVSH se kreditueshme.
- I pabazuar është edhe pretendimi i ngritur në rekurs i faktit se prezenca në gjykim dhe në vendimmarrje i kryesuesit të trupit gjykues Z.Selita pas sjelle sipas palës paditëse në referim të nenit 40 të ligjit 9367 dt.07.04.2005 “Për parandalimin e interesave në ushtrimin e funksioneve publike” pavlefshmërinë e akteve në rastin konkret të vendimmarrjes së Gjykatës, pasi bashkëshortja e tij është një personalitet i lartë në fushën e tatimeve është i pabazuar.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarës Arjana Fullani, përfaqësuesin e palës paditëse Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Av. Fatmir Braka i cili kërkoi ndryshimin e vendimit dhe pranimin padisë, përfaqësuesin e palëve të paditura, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave Avokatin e Shtetit, Z. Abaz Deda i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

1. Dhoma Kombëtare e Avokatisë është person juridik, që ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga shteti dhe që përgjigjet për rregullimin dhe kontrollin e ushtrimit të profesionit të avokatit në Republikën e Shqipërisë sipas dispozitave të ligjit nr.9190, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.
2. Ndër detyrat e saj të ngarkuara nga ky ligj është kontrolli i veprimtarisë ekonomike në fushën e shërbimit të avokatisë që lidhet me regjistrimin e avokatit në organet tatimore dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore që lindin.
3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 100 të Kushtetutës dhe nenin 159 të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” me propozim të Ministrisë së Financave, ka miratuar Vendimin nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.
4. Neni 11, pika 1 e këtij Vendimi në zbatim të nenit 117 të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ka përcaktuar si kufi minimal të qarkullimit vjetor për regjistrimin për TVSH shumën 5.000.000(pesë milion) lekë në një vit kalendarik, përveç rasteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi. Në pikën 2 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Personat e tatueshëm që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike, sipas profesioneve të tilla si: avokatë, noter,...pavarësisht nga qarkullimi vjetor, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në është zero dhe të gjithë janë persona të tatueshëm të regjistruar për TVSH-në, edhe nëse kryejnë veprimtari të përjashtuar sipas ligjit”.

5. Ndodhur në këto kushte, pala paditëse Dhoma Kombëtare e Avokatisë duke mos qenë dakord me pikën 2 të nenit 11 të VKM-së së sipërcituar, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me padinë objekt gjykimi.

6. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.23 datë 28.09.2015 ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesë padisë së paditësit Dhoma Kombëtare e Avokatisë së Shqipërisë si e pabazuar në ligj. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse”.

6.1 Arsyetimi i gjykatës: “Referuar përkufizimit të dhënë në nenin 2, pika 2 të ligjit nr.49/2012 “Vendimi nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë ” i Këshillit të Ministrave, përbën akt nënligjor normative. Në këtë akt nënligjor janë përcaktuar rregulla të përgjithshme, rregulla të cilat nuk shpëtojnë në zbatimin e tyre. Në lidhje me afatin e kundërshtimit të aktit nënligjor normativ, neni 18, pika 3 e ligjit nr.49/2012 parashikon se padia duhet të paraqitet në gjykatë brenda 3 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të aktit. Pala e tretë në këtë gjykim ka prapësuar se padia është ngritur jashtë afatit 3-vjeçar me argumentin se rregullimi nënligjor i kundërshtuar në këtë gjykim, ka ekzistuar në të njëjtën përmbajtje që në vitin 2011 i përcaktuar si i tillë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.18, datë 12.01.2011 dhe se miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.953, datë 29.12.2014 nuk e ka prekur këtë rregullim. Gjykata Administrative e Apelit vëren se në këtë gjykim pala paditëse nga pikëpamja formale pretendon shfuqizimin e nenit 11, pika 2 të VKM-së nr.953, datë 29.12.2014, akt normativ që është miratuar si i tillë dhe ka hyrë në fuqi në datë 01.01.2015 sipas nenit 14 të VKM-së në fjalë. Pavarësisht formulimeve dhe riformulimeve të ngjashme sipas ndryshimeve që ky rregull ka pësuar ndër vite, Këshilli i Ministrave në datë 29.12.2014 me vendimin nr.953, ka miratuar një Vendim të ri, akt i cili mund të goditet për paligjshmërinë që nga data 01.01.2015, kohë në të cilën ky akt nënligjor normativ ka hyrë në fuqi. Për këto arsye Gjykata konkludon se pala paditëse e ka ushtruar të drejtën e ngritjes së padisë brenda afatit 3-vjeçar. Gjithsesi, padia mbi pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, sipas nenit 18, pika 8 e ligjit nr.49/2012 mund të paraqitet në çdo kohë. Referuar bazës juridike dhe shtjellimit të padisë së paraqitur me shkrim në datë 05.04.2015, pretendimeve të palës paditëse gjatë gjykimit të çështjes dhe diskutimit përfundimtar me shkrim, rezulton që pala paditëse ka ngritur pretendime mbi paligjshmërinë e aktit nënligjor normativ objekt gjykimi në nivelin e pavlefshmërisë absolute, konkretisht nxjerrjes së aktit administrativ në kapërcim të kompetencave që i janë dhënë Këshillit të Ministrave me ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë ” në përcaktimin e rasteve përjashtuese të kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar. Në kuptim të shkronjës “b” të nenit 116 të këtij Kodi, akti administrativ do të quhet absolutisht i pavlefshëm kur organi administrativ merr dhe ushtron kompetencat e një organi tjetër administrativ ose kur vepron në kapërcim të kompetencave të tij ligjore. Pala paditëse ka pretenduar në gjykim se përcaktimi i shkallëzuar i kufirit të xhiros, në varësi të llojit të aktivitetit nuk konstatohet në asnjë dispozitë të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” apo të ndonjë ligji tjetër që ushtron ndikimin e vet në këtë fushë. Përkundrazi po ky ligj, pasi përfundon kuptimin dhe kompetencat lidhur me përcaktimin e kufirit minimal të xhiros, në nenin 118 të tij përcakton qartazi rastet përjashtimore të veprimtarive për të cilat regjimi i bizneseve të vogla nuk aplikohet, të cilat janë: furnizimet e kryera në mënyrë rastësore të pasurive të paluajtshme; aktivitetet e përfshira në skemën e prodhuesve bujqësore; furnizimet e shërbimeve të kryera nga një person i tatueshëm që nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, vend në të cilin lind detyrimi për

TVSH-në. Sipas palës paditëse ligji ka përcaktuar kompetencat e Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kufirit të xhiros për regjistrimin si subjekt i pagesës së TVSH-së në rang kombëtar dhe njëkohësisht ka përcaktuar edhe llojet e veprimtarive të cilat lejojnë Këshillin e Ministrave të bëjnë përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i caktimit të këtij kufiri dhe për korrektësi, profesioni i avokatit nuk klasifikohet në asnjë prej rasteve përjashtimore të përcaktuara në pikat a, b, c të nenit 118 të ligjit nr.92/2014 dhe vetëm për të cilat do të lejohej Këshilli i Ministrave të bënte përjashtime në përcaktimin e kufirit të xhiros. Në kushtet që ligji nuk e jep një kompetencë të tillë, sipas palës paditëse Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.953, datë 29.12.2014, neni 11 i tij, është në tejkalim të kompetencave që ligji i jep Këshillit të Ministrave. Tatimit mbi vlerën e shtuar i nënshtrohen ndër të tjera të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, të kryera kundrejt pagesës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë. Person i tatueshëm konsiderohet çdo person, pavarësisht nga forma e organizimit të tij, i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari ekonomike, cilido qoftë vendi dhe qëllimi ose rezultati i kësaj veprimtarie. Neni 118 i këtij ligji që citon pala paditëse bën ijalë për veprimtaritë për të cilat nuk aplikohet regjimi i biznesit të vogël dhe nuk lidhet me kompetencën ligjore të përcaktimit të nivelit minimal të regjistrimit për TVSH-në. Ndërkohë rezulton që neni 117, pika 2 e këtij ligji i ka lënë në rezervë ligjore relative Këshillit të Ministrave kompetencën e përcaktimit të kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar, duke detajuar normat e zbatueshme në këtë drejtim, pa ndalim të shprehur në përcaktimin e rasteve përjashtuese. Edhe neni 159 i ligjit në fjalë ka ngarkuar Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Financave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, në funksion të përcaktimit të politikave ekonomike të shtetit. Në analizë të dispozitave ligjore të lartëcituar Gjykata konstaton se në nxjerrjen e aktit nënligjor normativ, sa i takon normës së kundërshtuar në këtë gjykim, Këshilli i Ministrave nuk ka kapërcyer kompetencat e dhëna nga ligji. ”.

7. Kundër vendimit nr.23 datë 28.09.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka ushtruar rekurs, brenda afatit ligjor, pala paditëse Dhoma Kombëtare e Avokatisë, të cilët kanë kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesëpadisë, duke parashtruar shkaqet e pasqyruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË VLERËSON:

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, rekursi i paraqitur nga pala paditëse Dhoma Kombëtare e Avokatisë përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të Ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të cilat e bëjnë të cënueshëm vendimin nr.23 datë 28.09.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

9. Ky kolegji në analizë të shkaktuar ligjor të kërtimeve të paditësit , provave të administruara në dosjen gjyqësore, si dhe të vendimit të gjykatës arrin në konkluzionin se Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë nuk e ka kuptuar drejtë natyrën e vërtetë të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, aplikimin e drejtë të ligjit dhe për rrjedhojë nuk e ka zgjidhur atë në përputhje me ligjin dhe konkretisht me nenin 17/2 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i cili parashikon shprehimisht se: “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjet në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme.

Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët”.

10. Ky kolegji vlerëson të evidentojë faktin se kjo çështje është duke u gjykuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë për faktin se natyra juridike e këtij gjykimi është administrative. Konflikti ka lindur si pasojë e nxjerrjes nga ana e paditur Këshilli i Ministrave të Vendimit nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

11. Akti administrativ objekt gjykimi është akt nënligjor/akte administrative të cilat në bazë të nenit 10/2/b të ligjit 49/2012 gjykohen nga Gjykata Administrative e Apelit. Në këtë dispozite parashikohet shprehimisht se gjykata administrative e apelit shqyrton në shkallë të parë

mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative si dhe rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

12. Do të jenë objekt i gjykimit nga kjo gjykate pikërisht rastet kur këto akte goditen për ligjshmërinë e tyre (nëse ato kanë dalë në bazë dhe zbatim të ligjit) fushe kjo zbatimi e cila është përcaktuar qartë në nenin 37/4 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në të cilin thuhet se: “Në rastin e aktit nënligjor normativ, gjykata shqyrton ligjshmërinë e aktit që kundërshtohet, duke vlerësuar të tre kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni”.

13. Në analize të kësaj dispozite si dhe të shkakut ligjor të kërtimeve (nga ku rezulton se kërkohet pavlefshmëria absolute e aktit administrativ) arrihet në konkluzionin se është pikërisht Gjykata Administrative e Apelit ,gjykata kompetente që duhet të shqyrtojë ligjshmërinë e këtyre akteve dhe jo një gjykatë tjetër . Është kjo gjykate që në rastin kur këto akte kundërshtohen me shkakun ligjor që ato mund të mos kenë dalë në përputhje me ligjin dhe mund të paraqesin kundërligjshmëri, të shqyrtoje ligjshmërinë e tyre në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe situatës ligjore e faktike që ekzistonte në kohën e daljes së akteve.

14. Ky parashikim vjen në përputhje dhe me nenin 118/2 të Kushtetutës (kushtetuta që ka qenë në fuqi në momentin e daljes së akteve objekt shqyrtimi) në të cilën thuhet se: “ 1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të cilave nxirren këto akte. 3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t’ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër”.

15. Janë pikërisht këto parime baze dhe këto kriteret të përcaktuara në kushtetutë cilat jo vetëm ligji specifik por edhe organi kompetent shtetëror që nxjerr akte administrative duhet ti zbatojë dhe nuk duhet ti kapërcejë apo ti shkelë. Sa më sipër përbën atë që quhet respektimi i “parimit të ligjshmërisë “i cili qëndron në themel të veprimtarisë së organeve administrative dhe që siç do të analizojmë më poshtë në këtë vendim nuk është respektuar nga ana e paditur. Duke patur parasysh hierarkinë e normave ky kolegji evidenton faktin që çdo organ në veprimtarinë e tij duhet të ketë parasysh normat kushtetuese dhe duhet ti respektojë dhe ti zbatojë ato duke qenë se këto të fundit përbejnë aktin më të lartë të shtetit. Rendi juridik është një sistem hierarkik ku secila nga aktet që nga piramida dhe deri në bazë kanë vlera të ndryshme. Nga vlefshmëria e këtyre akteve përcaktohet dhe fuqia e zbatimit të tyre.

16. Rezulton që akti administrativ i nxjerrë nga pala e paditur dhe që është objekt shqyrtimi rregullon

një marrëdhënie konkrete të posaçme, një çështje specifike dhe që u kundërdrejtohet një grupi të caktuar subjektsh pikërisht të gjithë subjekteve tregtar apo personave fizik që ushtrojnë profesionin e avokatit. Me anë të këtij akti administrativ organi administrativ synon të përcaktojë kufirin minimal të TVSH-se në zero lekë pavarësisht xhiros vjetore të realizuar nga subjektet. Ardhja e pasojës së këtij akti direkt në veprimtarinë e këtij grupi subjektsh e legjitimon DHKA në kërkimin e saj para gjykatës.

17. Rezulton që paditësi në këtë gjykim, përkatësisht Dhoma Kombëtare e Avokatisë kërkon: "Shfuqizimi pjesërisht i aktit administrativ, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.953, datë 29.12.2014 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", neni 11, pika 2, përcaktimi i kufirit minimal për tatimin mbi vlerën e shtuar", vetëm për profesionin e Avokatit.

18. Pavarësisht mënyrës se si e kanë formuluar paditësit kërkimin e tyre , në analizë të shkakt ligjor të kërkimeve të palëve , i cili del qartë nga kërkesë padia, debati gjyqësor, konkluzionet e fundit, etj, rezulton qartë se palët në këtë gjykim kanë kërkuar pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ.

19. Ky qëndrim është konsoliduar tashmë dhe vjen në përputhje të plotë edhe me vendimin unifikues nr.3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin thuhet shprehimisht se: "Gjykata e zbulon shkaktun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë, del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë. Në këtë rast, gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakt që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar".

20. Në kushtet që pala ka kërkuar pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ ky kolegji vlerëson të vërë në diskutim vetëm kërkimin për pavlefshmërinë absolute të aktit. Pavlefshmëria absolute e një akti administrativ është një nga format më të rënda të pavlefshmërisë së aktit. Në kuptimin e së drejtës, akte administrative absolutisht të pavlefshme janë ato akte, të cilat për shkak të shkeljes thelbësore të ligjeve mbi bazën e të cilave janë nxjerrë nuk kanë fuqinë e një akti administrativ të vlefshëm dhe objektivisht nuk konsiderohen që të kenë ekzistuar në asnjë çast.

21. Një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, që nga momenti i nxjerrjes së tij, nuk krijon dhe as mund të krijojë pasojat juridike për të cilat ai është nxjerrë. Një akt absolutisht i pavlefshëm nuk është akt, ai është një nulitet i plotë, i cili konsiderohet se nuk ka hyrë në fuqi asnjëherë. Për shkak të shkeljes së rëndë thelbësore të ligjit, pavlefshmëria absolute e një akti nuk mund të rregullohet në të ardhmen, as nga palët dhe as nga organi që ka lëshuar aktin, pasi ky akt konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë. Si i tillë ai nuk mund të ketë fuqi detyruese, as ndaj personave apo subjekteve, të cilëve iu kundërdrejtohet dhe as ndaj organeve të tjera të administratës shtetërore.

22. Nisur nga analiza e bërë me lart, arrijmë në konkluzionin se dhe goditja e kësaj pavlefshmërie mund të bëhet (i) në çdo kohë dhe (ii) direkt në gjykatë, në ndryshim nga kërkimi për pavlefshmërinë relative të aktit ku subjekti është i detyruar që të respektojë afatet ligjore të parashikuara shprehimisht në KPrA apo në ligjet specifike si dhe ka detyrimin që të ezaurojë rrugën administrative, nëse një detyrim i tillë është parashikuar shprehimisht në ligjin e posaçëm që rregullon marrëdhënien juridike nga ku buron akti. Sa më sipër është parashikuar qartë në nenin 117 të K.Pr.Civile dhe në nenin 16 /2, pika b) të Ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe

gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, qe çdo person i interesuar, në çdo kohë, (pra nuk ka afat si pavlefshmëria relative), ka të drejtë t’i drejtohet drejtpërsëdrejti gjykatës, për të kërkuar konstatimin e kësaj pavlefshmërie.

23. Këtë qëndrim kane mbajtur edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr.3/2008, ku shprehimisht thuhet: “38.3. ... nëse pretendohet pavlefshmëria absolute e akteve, kërkim që nuk është i ndërruarur nga ndonjë afat parashkrimi, gjykata, nuk mund të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, por në zbatim të nenit 121 të K.Pr.Administrative dhe 331 të K.Pr.Civile, konstaton pavlefshmërinë për efekt të zgjidhjes së pasojave juridike që janë krijuar nga akti.

24. Kur kërkohet konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një akti administrativ gjykatat duhet të hetojnë e gjykojnë vetëm ekzistencën e shkaqeve ligjore që i përkasin këtij lloj kërkit, të cilat janë të parashikuara shumë qartë në nenin 116 dhe 117 të K.Pr.Administrative. Këto dispozita shprehimisht thonë: Neni 116: Aktet administrative absolutisht të pavlefshme

Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:

- a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;
- b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;
- c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.

Neni 117: Efektet e aktit administrativ absolutisht të pavlefshëm:

- 1. Aktet administrative absolutisht të pavlefshme nuk prodhojnë pasoja ligjore pavarësisht nga fakti nëse janë deklaruar apo jo si të tillë.
- 2. Secila palë e interesuar mund të kërkojë që akti administrativ të shpallet absolutisht i pavlefshëm. Kërkesa në fjalë mund të bëhet në çdo kohë. Organi administrativ kompetent, me iniciativën e tij, mundet të deklarojë një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm në çdo kohë.
- 3. Në qoftë se vetëm një pjesë e aktit është absolutisht e pavlefshme, i gjithë akti do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm në rast se pjesa që anulohet është aq e rëndësishme sa që organi administrativ nuk do ta nxirrte aktin pa këtë pjesë.

25. Ne analize të dispozitave të mësipërme, rezulton se si kriter kryesor për të dalluar pavlefshmërinë absolute nga ajo relative është pikërisht shkalla e shkeljes së ligjit, rrezikshmëria e aktit, shkalla e mundësisë së eliminimit të shkeljes nga vet organi që ka nxjerrë aktin etj. Tre janë rastet qe ligji ka parashikuar për të kuptuar nëse një akt është absolutisht i pavlefshëm: i) aktet që nxirren nga një organ administrativ i paidentifikuar dhe që nuk njihet si i tillë, ii) aktet që nxirren nga një organ administrativ në kapërcim të kufijve të kompetencave të tij; iii) aktet me shkelje në mënyrë flagrante të formës dhe procedurës për nxjerrjen e tij.

26. Gjykata e Lartë ka tashme një praktikë të konsoliduar, përse i përket trajtimit të shkaqeve që çojnë në pavlefshmërinë absolute të një akti administrativ. Një nga rastet e pavlefshmërisë absolute është dhe rasti “ kur akti administrativ nxirret nga një organ administrativ në kapërcim të kufijve të kompetencave të tij“. Çdo organ është kompetent në fushën që ai mbulon dhe këtë veprimtari e ushtron vetëm brenda kompetencave që i ka dhënë ligji dhe në respektim të parimit të ligjshmërisë.

Ushtrimi i kompetencave jashtë kufijve të ligjit përbën cenim të këtij parimi dhe si rrjedhim akti apo çdo veprim i organit administrativ që mund të nxirren si pasojë e një veprimtarie të pakufizuar dhe arbitrare shpie domosdoshmërisht në pavlefshmërinë juridike të tyre .

27. Sa më sipër është sanksionuar në ligjin tonë themeltar Kushtetutë, në nenin 118, nga ku del qarte disiplinimi i veprimtarisë së organeve të administratës publike. Kushtetuta jo vetëm që i detyron këto organe që të veprojnë brenda hapësirave dhe kompetencave që u jep ligji por edhe prevalon në çdo rast, në rast se këto organe nxjerrin akte të cilat nuk janë konform pushtetit që ligji u ka dhënë. Këto organe janë të detyruara që në zbatim të Kushtetutës të nxjerrin vetëm akte nënligjore në bazë dhe në zbatim të ligjit. Në rastet kur ligji nuk parashikon gjë, ose nuk jep kompetenca të veçanta për organe apo subjekte të veçanta për nxjerrjen e këtyre akteve atëherë është vetëm ligji ai i cili duhet të zbatohet. Në asnjë rast organet e administratës (në rast se ligji nuk ja u jep këtë të drejtë që të nxjerrin një akt normativ nënligjor siç mund të jepet shpesh me dispozita transitorë) nuk mund të bëjnë interpretime të ligjit, (atribut kjo i gjykatës kushtetuese) shtesa apo amendime të tij. Në rast se do të ndodhte një gjë e tillë do të ndodheshim para abuzivizmit të organit administrativ dhe një veprimtarie arbitrare nga ana e tij. Përveç sa më sipër akti i një organi më të ulët nuk mund të ndryshojë ligjin apo aktin e një organi më të lartë. (akti i një organi administrativ nuk mund të ndryshojë ligjin me të cilin ky organ operon por duhet të jetë në bazë dhe në zbatim të tij).

28. Sa më sipër është në koherencë dhe me qëndrimin që kanë mbajtur Kolegjet e Bashkuara në vendimin e tyre Unifikues nr 8/2007 në të cilën kanë theksuar se : “ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton në nenin 116 të saj hierarkinë e akteve normative që kanë fuqi në gjithë territorin e Republikës dhe në këtë hierarki ligjet qëndrojnë mbi aktet normative të Këshillit të Ministrave. Është detyrim kushtetues (buron nga neni 118/2 i saj) që ligji duhet jo vetëm të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore dhe organin kompetent që do ta nxjerrë, por edhe të përcaktojë çështjet që duhet të rregullohen dhe parimet në bazë të të cilave duhet të nxirren këto akte. Në fakt, dispozita kushtetuese e lartpërmendur e autorizon Këshillin e Ministrave, ndër të tjera, me nxjerrjen e akteve në fushën e organizimit të administratës doganore. Në mënyrë me konkrete këtë gjë e parashikon dhe paragrafi i parë i nenit 13 të këtij kodi, sipas të cilit: “Brenda 15 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij Kodi, Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave, përcakton organiken e administratës doganore në mënyrë që të garantojë, nga njëra anë, mbrojtjen e interesave fiskale të Republikës së Shqipërisë dhe nga ana tjetër, një organizim të përshtatshëm për dinamizmin dhe veçantinë e veprimtarisë doganore...” Por vërehet se, aktet e nxjerra nga Këshilli i Ministrave i kanë kaluar kufijtë e autorizimit të dhënë nga ligji, pasi janë shtrire për çështje që ligji nuk i ka parashikuar dhe tej parimeve që vetë ligji ka pranuar.

29. Pikërisht nisur nga analiza e mësipërme si dhe kërkimet e paditësit Dhoma Kombëtare e Avokatisë Kolegji administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson të marrë në analize ligjshmërinë e aktit objekt kundërshtimi Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, pika 2, vetëm për profesionin “Avokat”.

30. Në analize të përmbajtjes së vendimit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, pika 2 si dhe të efektit që ky akt ka pasur si qellim, arrihet në përfundimin se me anë të këtij vendimi ky organ Këshilli i Ministrave nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka “përcaktuar se për profesionin e avokatit pavarësisht nga qarkullimi vjetor, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-

në është zero” .

31. Vendimi i mësipërm i nxjerrë nga Këshilli i Ministrave rezulton që ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 159 të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

32. Nisur nga analiza e mësipërme , si dhe marre shkas nga pretendimet e palëve në proces, për t’u dhënë atyre një përgjigje përfundimtare si dhe për një zgjidhje të drejtë të çështjes, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se duhet të analizojë dhe ti japë përgjigje pyetjes: A është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, pika 2 i nxjerrë nga ana e këtij organi në kapërcim të kufijve të kompetencave të tij?

33. Për t’i dhënë përgjigje pyetjes së mësipërme ky kolegji vlerëson të marrë në analizë dispozitat e ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

34. Në nenin 117 të këtij ligji parashikohet se : “1. Personat e tatueshëm rezidentë në Shqipëri, qarkullimi vjetor i të cilëve është nën kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, janë objekt i regjimit për bizneset e vogla, duke përfutur një përjashtim nga detyrimi për të llogaritur TVSH-në në shitje për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të kryera prej tyre. 2. Kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave...”

35. Po kështu në nenin 159 të këtij ligji parashikohet se: “Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Financave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, jo më vonë se 4 muaj nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare”.

36. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, pika 2 parashikon se: “Në zbatim të nenit 117, të ligjit, kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar është qarkullimi prej 5 milionë (pesë milionë) lekë në një vit kalendarik, përveç rasteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni. Personat e tatueshëm, që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike, sipas profesioneve të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë, si dhe kryejnë veprimtari ekonomike në fushën e hotelërisë, pavarësisht nga qarkullimi vjetor, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në është zero dhe të gjithë janë persona të tatueshëm të regjistruar për TVSH-në, edhe nëse kryejnë veprimtari të përjashtuar sipas ligjit”.

37. Bazuar në dispozitat e mësipërme si dhe në analizën që u bëhet atyre ky kolegji vlerëson se kompetencat e Këshillit të Ministrave shtrihen vetëm brenda parashikimit që ka bërë neni 117/2 i ligjit dhe në mënyrë të veçantë duke ndalur tek ajo që i duhet këtij procesi “Kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

38. Por si duhet të interpretohet dhe të zbatohet kjo dispozitë, a do të interpretohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtë të përcaktojë vetëm kufirin minimal të regjistrimit të TVSH-së apo të bëjë edhe përjashtime nga kufiri minimal i përcaktuar?

39. Në analize të dispozitave të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” , dhe VKM nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, konstatohet dhe kuptohet fakti që ky organ (Këshilli i Ministrave) ka detyrimin që të mblidhet për të nxjerrë dhe përcaktuar kufirin

minimal të regjistrimit për TVSH-në dhe asnjë përjashtim tjetër nga ky kufi i përcaktuar.

40. Marrë në analize sa më sipër dalin qartë faktet që Këshilli i Ministrave përcakton vetëm kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në dhe nuk kryen asnjë rregullim tjetër që ligji nuk ia ka dhënë shprehimisht, pasi të gjithë subjektet tregtare qofshin këta edhe avokatë do të përfshihen në kufirin e përcaktuar nga KM që në rastin konkret është 5 Milion Lekë. Ligjvënësi kur ka bërë këtë parashikim, pra dhënien e kompetencës për përcaktimin e kufirit minimal të TVSH-së Këshillit të Ministrave ka patur parasysh si respektimin e parimit të “sigurisë juridike” i cili është shumë i rëndësishëm në një shtet demokratik ashtu dhe faktin që të mos dëmtojë subjektet tregtare. Doktrina juridike e së drejtës kushtetuese ka pranuar se siguria juridike është një ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Në vendimet e saj ajo shprehet se “siguria juridike parakupton besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluar. Besueshmëria ka të bëjë me faktin që qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Parimi kushtetues i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i dhunuar nëse mohohen ose shkelen siguria juridike, stabiliteti ligjor dhe mbrojtja e pritshmërie të ligjshme. Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfill interesat legjitime të tyre. Për këtë qëllim ligji duhet të ofrojë siguri qartësi, vazhdimësi në mënyrë që individët ti drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të (vendime të gjykatës kushtetuese nr 20 dt 29.9.2008, nr 9 datë 26.2.2007 nr 8 datë 2.5.2006 dhe 36/2007)

41. Parë në këtë aspekt jo vetëm ligjet nuk duhet të jenë lehtësisht dhe shpeshtesisht të ndryshueshme, por nga ana tjetër subjektet duhet të kenë garancinë që të drejtat e tyre (dhe nga të drejtat më themelore është dhe ajo e pronës) do të mbrohen dhe garantohen nga shteti. Shteti nuk mund të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë nga ai vetë. Rregullimet ligjore duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme në mënyrë që të sigurohet dhe vazhdimësia e të drejtave. Është pikërisht detyrë e gjykatës (qoftë, administrative apo kushtetuese) ajo e cila kontrollon zbatimin e këtij parimi nga ana e organeve shtetërore. Në vazhdim të kësaj analize, si dhe të analizës së bërë me lart nga ky kolegji (për hierarkinë dhe rëndësinë e normës), ky i fundit thekson dhe njëherë se nuk mundet në asnjë rast që organi administrativ të ndryshojë me anë të akteve administrative /nënligjore atë çka ligji ka përcaktuar qartë.

42. Parashikimet e bëra në ligj janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga ana e organit administrativ, Këshilli i Ministrave. Kështu elementet e parashikuar më lart (përcaktimi i kufirit minimal) janë të domosdoshme jo vetëm nga ana formale por dhe se vete ligji në mënyrë të shprehur i kërkon ato.

43. Në rast se ligjvënësi do t’i jepte të drejtë organit administrativ të përjashtonte disa profesione nga kufiri minimal i regjistrimit për TVSh-në, ai patjetër, për shkak të rëndësisë së madhe që ka ky fakt dhe pasojat që sjellin akte të tilla, do ta kishte bërë një parashikim të tillë në ligj të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë dhe nuk do ta linte këtë në dëshirën e organit administrativ.

44. Ligjvënësi e ka parashikuar dhe është shprehur qartë në ligj duke i përcaktuar në mënyrë shteruese kompetencat e organit administrativ, (Këshillit të Ministrave). Ai duhet të ushtrojë vullnetin e tij brenda kornizës ligjore dhe në interes të publikut. Kështu në analize të nenit 117 të ligjit, e cila përcakton kompetencën që i është dhënë Këshillit të Ministrave, ky organ ka të drejtë vetëm të përcaktojë kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, por nga ana e Këshillit të Ministrave me anë të VKM-së objekt gjykimi përveçse është përcaktuar kufiri minimal i regjistrimit të TVSH-së, në

pikën 2 të saj janë bërë edhe disa përjashtime ku përfshihet edhe profesioni i avokatit, duke përcaktuar kufirin minimal “Zero” për regjistrimin si subjekt i TVSH-së.

45. Në rastin objekt gjykimi rezulton se normat juridike të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” që rregullojnë këtë lloj veprimtarie nuk kanë ndryshuar, ligji vazhdon të jetë po ai dhe kompetencat e organit administrativ po ato. Pra nuk kemi interpretim të ri të normave të ligjit dhe zbatueshmëri të ndryshme në asnjë rast pasi, normat dhe ligji interpretohen dhe zbatohen njësoj që në momentin që ligji ka hyrë në fuqi.

46. Përfundimisht Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në interpretim të dispozitave të ligjit rezulton qartë që Këshilli i Ministrave duhet të përcaktojë vetëm kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në por jo të përcaktojë ndonjë rregullim tjetër apo kufi tjetër minimal regjistrimi për TVSH-në për subjekte të veçanta pasi në asnjë rast ligji nuk e përcakton shprehimisht që Këshilli i Ministrave i ka kompetencat për të përcaktuar kufi minimal të ndryshëm për subjekte të apo profesione të veçanta.

47. Nxjerrja e dispozitave të tilla nga Këshilli i Ministrave, duke përcaktuar kufi minimal të ndryshëm regjistrimi për profesione të veçanta, pa qenë në asnjë nga kushtet e parashikuara nga neni 117 i ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” passjell faktin që pala e paditur ka vepruar jashtë kompetencave ligjore të dhëna nga ligji organik dhe për rrjedhojë ky përcaktim i parashikuar në nenin 11/2 të VKM nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, për profesionin e avokatit, është absolutisht i pavlefshëm.

48. Ky disponim në VKM nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i këtij organi administrativ është jashtë kompetencave që ligji i ka njohur pasi siç u tha dhe me lart KM është kompetent vetëm për të vendosur kufizimin minimal të regjistrimit për TVSH-në.

49. Kolegji Administrativ e Gjykatës së Lartë, mbi argumentet e sipërcituara arrin në përfundimin se Gjykata Administrative e Apelit, ka zbatuar gabim ligjin kur ka rrëzuar padinë. Rrjedhimisht, jemi në kushtet kur vendimi i Gjykatës së Apelit Administrativ duhet të ndryshohet dhe të pranohet kërkesëpadia duke u konstatuar neni 11/2 i VKM nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, për profesionin e avokatit si akt absolutisht i pavlefshëm dhe duke u shfuqizuar.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 63 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

V E N D O S I

Ndryshimin e vendimit nr.23 datë 28.09.2015 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.

Shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ VKM nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” në nenin 11, pika 2, për profesionin e avokatit.

5. PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE

5.1. PAVLEFSHMËRI ABSOLUTE

5.1.1. Vendimi nr.1 datë 21.11.2017

PADITES: Subjekti X,

I PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Durres.

OBJEKTI: Konstatim i pavlefshmerise absolute te aktit Njoftim-Vleresimi X leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durres, si nje detyrim ne kundershtrim me ligjin dhe shuarjen e detyrimit dhe te pasojave qe sjell.

Baza ligjore: Neni 15, 17, 35 Ligji nr.49/2012, VKM nr. 1058, date 21.10.2009 "Per percaktimin e kufirit minimal te regjistrimit per TVSH", Udhhezimi nr.1, date 13.05.2008 "Mbi tatimin per vleren e shtuar" te Ministrise se Financave, ligji nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne R. SH" i ndryshuar, nenet 31, 32 i K.Pr.Civile, neni 92/a i kodit Civil, neni 76 I Kodit te Procedures Administrative, vendimi unifikues i Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte date 29.03.2012.

Me vendimin nr. 884, date 13.07.2015, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Durres ka vendosur:

- Rrezimin e kerkese-padise.

Kunder ketij vendimi ka bere ankim pala paditese, e cila ka kerkuar ndryshimin e vendimit te shkalles se pare dhe pranimin e padise, duke sjelle keto pretendime ndaj vendimit te gjykates:

- Ju parashtroj se une paditesi X, jam person fizik me dhe ushtroj aktivitet ne tregtine ushqimore (Mini-Market), fakt i provuar nga ekstrakti I QKR me dokumentin leshuar nga dega QKR-s qytetit Kavaje dhe administruar ne dosje. Kam dorezuar rregullisht bilancin per periudhen 2011 ne Drejtorise Rajonale Durres, me vleren vjetore eshte 1.064.805 leke. Pala paditur D.R.T Durres, gjate verifikimeve te pretenduara ana e saj, vendos nje gjobe shume te rende e ne kundershtrim me ligjin, si subjekt i tatueshem me T.V.SH (Tatim mbi Vleren e Shtuar) eshte absurde sepse bie ne kundershtrim konstatimet e kryera nga vete pala e paditur ne lidhje me deklarimet vjetore te vitit 2012, 2013, 2014 ku nuk arrihet as te imagjinohet te arrije xhiron e perfshirjes si subjekt me VSH. Regjistrimin si subjekt TVSH-je, pala e paditur e bazon ne nje akt-kontrolli, fantazios ku arrin ne konkluzion se aktiviteti im tregtar arrin ne xhiro nga 5-8 milion te reja, sic konstatohet edhe ne NJOFTIMIN nr. prot., date 13.12.2010, leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durres. Pas regjistrimit te njeanshem, arbitrar, si subjekt me TVSH, paditesi i dergon nje Kerkese zyrtare pales se paditur me ane te postes rakomande (nr.0495323 kod.J58476, dt.17.01.2012) dhe i kerkonte beje cregjistrimin tim si subjekt TVSH-je, se nuk permbush kushtet ligjore dhe xhiron vjetore per tu tatuar me TVSH. Me ane te aktit "Njoftim Vleresimi" per Detyrimet date 29.12.2014, pala paditur me ngarkon me detyrimin ne shumen 960.848 leke, si rezultat i mosdeklarimit dhe pageses se TVSH per periudhat vjetore te vitit 2012, 2013, 2014. Nuk jam absolutisht dakort me detyrimin e mesiperm pasi eshte nje veprim i pabazuar ne prova e ligj. Detyrimi i mesiperm eshte thjeshte nje veprim arbitrar dhe vjen ne kundershtrim flagrant me ligjin dhe aktet nenligjore. Hetimi i bere nga Gjykata eshte shume i ceket dhe jo sic parashikon procedura qe duhet te jete i plote dhe i gjithanshem.

- Gjykata nuk ka identifikuar sic duhet objektin e padise time, duke gabuar ne menyre flagrante ne cdo faze te gjykimit, duke e konsideruar si te relativisht te pavlefshme detyrimin tatimore dhe jo Absolutisht te pavlefshem.
- Gjykata dhe vete nuk ishte ne gjendje te identifikojke ku eshte pjesa relative e pavlefshmerise, pasi ne gjykojme se jemi para nje veprimi absolutisht te pa vlefshem ne referim te nenit 92 te K.Civil. Ligji Nr 7928 date 27.4.1995, "Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar" Ligji i posacem, ne nenin 3.4 te tij sakteson se Kufiri minimal i regjistrimit percaktohet nga Keshilli i Ministrave, sipas pikes 5 te ketij neni.
- Nisur nga sa me siper Keshilli i Ministrave ka nxjerre: VKM Nr. 1 058, date 21.10.2009 me ndryshime, per Percaktimin e Kufirit Minimal te Regjistrimit per Tatimin mbi Vleren e TVSH dhe ka percaktuar se: Kufiri minimal i regjistrimit per tatimin mbi vleren e shtuar (TVSH) te vete 5 000 000 milione leke per vit kalendarik.
- Sa me siper, nisur nga dispozita detyruese ligjore, dhe vete aktet e verifikimit e pales se paditur, ku une paditesi as nuk e permbush, dhe as nuk i afrohem kesaj shume, nuk mund tejerne subjekt I VSI 1-se, pasi eshte ne reterim te nenit 92 te K.Civil. eshte veprim ne kundershkrim flagrant me ligjin ndaj eshte nje veprim absolutisht i pavlefshem dhe si rrjedhoje edhete gjitha pasojat qe ai sjell jane nul. Kam ndjekur edhe rrugen e ankimit administrativ, por me eshte refuzuar nga ana e Drejtorise se Apelimit Tatimore, me arsyetimin(anti-kushtetues), se duhej te parapaguaj shumen e detyrimit qe te shqyrtohet nga ana e Apelimit Tatimore. Ne situaten kritike ekonomike qe ndodhet paditesi nuk e ka luksin te parapaguaj shumen e mesiperme pasi nuk e disponon ate shume.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

pasi degjoi relatimin e ceshtjes nga gjyqtari kryesues, referuar akteve si dhe verifikoi kushtet e pranueshmerise se ankimit,

VEREN

Se Vendimi i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Durres, eshte rrjedhoje zbatimit te ligjit procedural e material e kjo ceshtje lihet ne fuqi.

Nga shqyrtimi gjyqesor ka rezultuar se, paditesi eshte regjistruar si person fizik, me numer unik te identifikimit K92527804A dhe adrese Kavaje, dhe ushtron aktivitet ne tregtimin e artikujve ushqimore, Drejtoria Rajonale Tatimore Durres ka nxjerre ne ngarkim te ketij tatimpaguesi aktin administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore me nr.yyyy Prot, date 29.12.2014 per shumen 960.848 leke ne te cilin eshte perfshire shuma e detyrimit theme/tar dhe gjobat, konkretisht detyrim per tvsh-ne per periudhen 2012-2014/10 i cili eshte perllogaritur ne shumen 496. 679 leke, kamatevonesa sipas sistemit informatik dhe gjobe ne shumen 464.169 leke.

Paditesi ka ankimuar aktin administrativ te lartpermendur ne Drejtorine e Apelimit Tatimor e cila eshte shprehur me vendim dhe ka refuzuar te marre ne shqyrtim ankimin e bere duke qene se nga ana e tatimpaguesit nuk jane permbushur kerkesat dhe procedurat ne lidhje me pagesen e detyrimit tatimor para skadimit te afatit te ankimit.

(Drejtoria e Apelimit Tatimor ka konstatuar se nga hq limi ara ra 1 dokumentacionit nuk jane plotesuar kushtet ligjore sipas nenit 10 te ligji nr.9920/2008, pagesa e detyrimit tatimor objekt ankimi 496.679 leke dhe te percaktuar ne njoftim, 29.12.2014 objekt ankimi.)

Pas venies ne dijeni te ketij fakti, paditesi ne kete gjykim rezulton ti jete drejtuar me kerkese-padi Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Durres me kerkesepadine objekt gjykimi.

Gjate gjykimit ne shkalle te pare, pala paditese ka pretenduar te njejtat fakte te konfirmuara edhe ne ankimin e saj ndaj vendimit te gjykates se shkalles se pare, pasqyruar ne pjesen hyrese te ketij

vendimi.

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Durres me Vendimin nr.884, date 13 .07.2015 ka vendosur "Rrezimin e padise", • sipas disponirneve te pasqyruara ne pjesen hyrese te ketij vendimi, duke argumentuar nder te tjera se pari ne lidhje me ceshtjen e juridiksionit gjyqesor te gjykates ne shqyrtimin e kesaj padie, gjykata vlereson se nga citimi i neneve 117 II dhe 121 te K.Pr.Administrative nxirren dy perfundimet e meposhtme: Aktet administrative absolutisht te pavlefshem nuk prodhojne asnje pasoje juridike (jane nu!), Organet administrative nuk mund t 'i shfuqizojne apo revokojne aktet administrative absolutisht te pavlefshme.

Meqenese neni 121/2 i K.Pr.Administrative ne menyre te shprehur parashikon se organi administrativ nuk ka te drejte qe te shfuqizojte ose revokojte aktet administrative absolutisht te pavlefshme, atehere arrihet ne perfundimin se ne rastin kur kerkohet pavlefshmeria absolute e aktit administrativ nuk eshte e nevojshme qe te ndiqet me pare rruga administrative e ankimit. Gjykata vlereson se, ne rastet kur kerkohet pavlefshmeria absolute e aktit administrativ, gjykata e shkalles se pare nuk shqyrton the/bin e tij, par mjaftohet vetem me verifikimin e kushteve te kerkuara nga neni 116 i K.Pr.Administrative. Edhe Gjykata e Larte ka nje qendrim te konsoliduar ne raste te tilla, pasi ne shume vendime te saj eshte mbajtur qendrimi qe, kur kerkohet pavlefshmeria absolute e aktit administrativ juridiksioni gjyqesor nuk mungon, prandaj pala e interesuar mund t 'i drejtohet direkt gjykates pa qene nevoja qe me pare t 'i drejtohet organit administrativ, par ne ket« rast gjykata qe shqyrton ceshtjen eshte e detyruar qe te zbatoje me rigorozitet kerkesat e nenit 116 te K.Pr.Administrative, duke u mjaftuar vetem me verifikimin e tre rasteve qe parashikohen ne te. Me te tille arsytim gjykata konkludon se paditesi duhet te ezuaronte rrugen e ankimit administrativ perpara se t 'i drejtohej gjykates per goditjen e akteve administrative si absolutisht te pavlefshem. Ne haze te nenit 9 te Ligjit nr. 49 te vitit 2012 "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative" dhe nenit 36 - 40 te K.Pr. Civile ceshtja administrative hen pjese ne juridiksionin gjyqesor.Nga ana e pales paditese kerkohet te konstatohet pavlefshmeria absolute e aktit administrativ Njoftim Vleresimi Per Detyrimet me nr.27527 prot, date 29.12.2014 dhe ky eshte nje kerkim per te cilin gjykata ka juridiksion per ta marre ate ne shqyrtim . Ne haze te nenit 7 dhe 10 te Ligjit nr. 49 te vitit 2012 "Per Organizimin dhe Funkcionimin e e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative" mosmarreveshja administrative ben pjese ne kompetence lendore, funksionale dhe tokesore te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Durres. Pala paditese ne padine e seq sikunder eshte permendur ka evidentuar ne menyre te sakte dhe te qarte llojin e objektit te padise qe ka zgjedhur per te mbrojtur interesat e saj qe pretendon t 'i Jene shkelur nga ana e pales se paditur.nepermjet veprimit administativ te kryer pre} saj, llogaritjes se detyrimeve tatimore sipas akti administrativ njoftim vleresimi tatimor nr. 2 752 7, date 29.12.2014 te DRT Durres; dhe kjo eshte ngritja e padise se konstatimit te pavlefshmerise absolute te aktit administrativ, dhe per te gjykuar mbi bazueshmerine ne ligj te pretendimeve te paditesit, gjykata referon tek rastet e pavlefshmerise absolute te cilat jane te permendura ne menyre te qarte ne nenin 116 te K.Pr. Administrative, duke pretenduar se ne rastin konkret ndodhemi perpara rastit te nxJerrJes se akteve ne kundershtrim me formen dhe proceduren sikunder me siper esht« referuar. Ne analize te dispozitave te mesiperme, si dhe pretendimeve te paraqitura nga palet rezulton se si kriter kryesor per te dalluar pavlefshmerine absolute nga aJo relative merret shkalla e shke/jes se ligjit, rrezikshmeria e aktit te shkelur, shkalla e mundesise se eliminimit te shke/jes nga vet organi qe ka nxjerre aktin et}. Tre Jane rastet qe ligji ka parashikuar per te kuptuar nese nje akt eshte absolutisht i pavlefshem.

i) Rasti i pare lidhet me ato akte qe nxirren nga nje organ administrativ I paidentifikuar dhe qe nuk nJihet si i title. Organi administrativ qe te konsiderohet i nJohur nga ligji duhet te jete paJisur me tagre pushteti, te jete kompetent per veprimtarine konkrete administrative qe do te kryeje, si dhe te kete strukturen perkatese organizative administrative. Keto tre elemente percaktojne gjendjen

Juridike te organit administrativ. Akti do te quhet i nxjerre nga nje olean administrativ i pidentifikuar edhe kur aktit i mungojne simbolet e pushtetit i koka, vula, firma dhe elemente te tjere si data etj.

ii) Ras ti i dyte i pavlefshmerise absolute ka te beje me aktet admini trativ e qe nxirren nga nje organ administrativ ne kapercim te kufij e te kompetencave te tij. Cdo organ administrativ eshte kompetent ne fushen qe ai mbulon dhe nuk mundet te ushtroje te drejtat e nje organi tjeter administrativ pasi ushtrimi i kompetencas e teJ kufiJve te ligjit perben cenim te parimit te ligj hmerise dhe i rrjedhoje cdo veprim apo akt administrativ qe mund te nxirret nga kjo veprimtari e pakufizuar dhe arbitrare shpie domosdoshmerish. ne pavlefshmerine juridike te tyre.

iii) Rasti i trete lidhet me shkeljet ne menyre flagrante te forme dhe procedure per nxjerrjen e aktit administrativ. Respektimi i formes dhe i procedure per nxjerrjen e aktit administrativ perben nje tjeter element te rende i hem qe percakton vlefshmerine e tij. Shkelja e formes dhe e procedure mund te paraqitet ne menyra te ndryshme, par Jo te gjitha shkeljet qe lidhen me formen dhe proceduren mund te shpien detyrimisht ne pavlefshmerine e aktit. Mosrespektimi i ketyre elementeve duhet te jete i atij karakteri dhe asaj rendesie qe te kete ndikuar drejtperdrejt ne nxjerrjen e aktit administrativ. Nje shkelje e parendesishme e procedures apo formes se aktit nuk mund te shkaktoje pavlefshmeri absolute te aktit. Natyra e shkeljes vleresohet nga vete organi qe shqyrton pavlefshmerine e aktit.

Gjykata vlereson se organet tatimore kane vepruar ne rastin objekt gjykimi ne perputhje me Ligjit nr.9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise. Procesi gjyqesor ne gjykimin administrativ sikunder dhe ne gjykimet e tjera eshte i karakterizuar nga kontradiktoriteti i cili eshte nje parim qe ka te beje me ballafaqimin e pretendimeve te paleve, provave, kriterëve dhe interpretimeve te kuadrit ligjor te zbatueshem ne rastin konkret, ku merr rendesi verifikimi i ligjshmerise se veprimtarise administrative si dhe procesi i te provuarit te rrethanave faktike. Referuar provave shkresore te paraqitura nga pala e paditur ne mbeshtetje te pretendimeve te saj, rezulton se ne date 23.11.2010 ne Kavaje eshte ushtruar nga administrata tatimore kontroll tek subjekti, personi fizik dhe eshte mbajtur akti i konstatimit perkates ne permbajtje te te eilit thuhet se "... Subjekti ushtron aktivitet ne pronen e tij ne nje siperfaqje pre } 70 m2. Bazuar ne llojin e aktiviteti. siperfaqjen. inventaret ne shpnezime pre } 1.2 milion leke , xhiros se realizuar dhe qarkores nr.1, date 24. 12.2009 te Ministrise se Financave subjekti propozohet te kaloje ne skemen e TVSH me xhiro vjetore 5-8 milione leke biznes i vogel me TVSHSubjekti u njoftuar ne lidhje me pajisjen me kase fiskale brenda 15 diteve nga marrja e njoftimit te TVSH-se .. " Ky akt konstatimi eshte nenshkruar nga ana e tatimpaguesi.

-Ne date 13.12.2010 nga ana e DRT Durres ka dale njoftimi derguar ketij subjekti ne lidhje me ndryshimin e pergjegjesise se tij tatimore ne subjekt tatimpagues me TVSH

-Ne date 29.12.2014 me shkresen nr. yyyy/1 Prot DRT Durres ka njoftuar tatimpaguesin se ne haze te te dhenave te regjistruara ne kase per vitin 2012,2013 dhe 2014 eshte kryer vleresimi per vitin 2012,2013,2014 dhe se pre } tij eshte nderprere deklarimi i TVSH-se ne periudhen 201112,duke iu kerkuar te deklaroje TVSHper periudhat ne vazhdim ne haze te ligjit nr.9920/2008.

-Ne date 29.12.2014 ka dale njoftim vleresimi per detyrimet me nr.yyyy prot me te cilin paditesi I tatimpaguesi eshte njoftuar per nje detyrim ne shumen 960. 848 leke ' i cili eshti: i perllogaritur mbi te dhenat e procesverbalit te mbajtur ne DVATK ne date 26.12.2014 sipas te dhenave te kases te cilat administrohen nga DRT Durres dhe u perllogaritur ne total si gjoba dhe detyrime , si dhe Kamate vonesat sipas sistemit.

Paditesi pretendon se detyrimet per shkak te TVSH-se nuk qendrojne pasi kalimi i tij si subjekt me TVSH nuk eshte here ne perputhje me kriteret ligjore, per shkak te mospermbushjes nga ana e tij te nivelit te xhiros vjetore. Vendimi i marre nga pala e paditur per kalimin e tatimpaguesit ne subjekt me TVSH pasqyruar /90 ne regjistrimin e ketij tatimpaguesi si te tille, daton ne vitin 2010, dhe subjekti deri ne vitin 2012 ka deklaruar TVSH, qe do te thote se nuk ka nje akt administrative

apovendim gjyqesor qe te kete disponuar per cregjistrimin e tij nga kjo skeme, dhe ndryshimin e pergjegjesise se tij tatimore si subjekt me TVSH ne subjekt pa TVSH Pra i tille kalim apo ndryshim i pergjegjesise tatimore nuk eshte kundershuar nga ana e paditesit, dhe the/bi i kerkimit te tij ne kete padi dhe shkaku per te cilin tatimpaguesi ne padine e tij godet aktin administrativ, njoftim. per vleresimin e detyrimeve me nr.27527 prot. date 29.12.2014 ne kete g/vk-im eshte pikerisht fakti se ai pa te drejte eshte ngarkuar me detyrim per tvsh-ne, pa qene subjekt i saj, nderkohe qe ai figuron i rregjistruar si i tille dhe per rrjedhoje me te drejte detyrimet i Jane perlllogaritur ne keti: menyre. Administrata tatimore ne ushtrim te kompetencave te parashikuara ne ligjin nr.9920/2008 ka bere perlllogaritjen mbi bazen e te dhenave te dala nga kasa fiskale, pra te asaj qe ka deklaruar tatimpaguesi, dhe ka bere perlllogaritjen e detyrimit dhe llogaritur gjobot per vonese ne pagese. Pretendimet ne lidhje me xhiron vjetore te paditesit. nese kalon apo kufirin e vendosur ne aktet nenligjore jane pretendime te cilat nuk jane shkaqe te pavlefshmerise absolute te aktit administrativ, ato Jane pretendime qe mund te ngrihen ne kuadrin e padise per goditjen e aktit si relativisht te pavlefshem, padi qe i nenshtrohet kushteve te tjera ligjore. Per te gjitha sa me larte gjykata cmon se gjithe procedura e ndjekur deri ne nxjerrjen e njoftim vleresimit tatimor eshte e mbeshetur ne ligj dhe ky akt administrativ nuk eshte i prekur nga vese te pavlefshmerise absolute dhe si tille duhet te lihet ne fuqi. Per sa me siper gjykata ne perfundim te kesaj analize ligjore te fakteve objekt verifikimi duke vleresuar kerkimet e pales paditese, prapsimet e pales se paditur, raportin shkak ligjor - haze juridike objekt kerkimesh pasi cmoi provat e marra ne gjykim 1 endo rrezoje kerkese - padine si te bazuar ne ligj dhe ne prova. Shpenzimet gjyqesore te evidentuara ne dosjen gjyqesore i ngarkohen pales paditese i pale gj qhumbe e. Vleresimi i Gjykates Administrative te Apelit

Ky kolegji vlereson se ne analize te prova e, shpjegimeve te paleve shkaqeve te ngritura ne ankim nga pala paditese dhe ligjit te aplikueshem ne rastin konkret, cmon se vendimi i gjykates administrative te shkalles se pare Durres eshte rrjedhoje e zbatimit te ligjit material dhe te ligjit procedural e duhe te lihet ne fuqi. Konkretisht, mbeshetur Drejtoria Rajonale Tatimore Durres ka nxjerre ne ngarkim te ketij tatimpaguesi aktin administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore me nr.yyyy prot, date 29.12.2014 per shumen 960.848 leke ne te cilin eshte perfshire shuma e detyrimit themeltar dhe gjobot, konkretisht detyrim per tvsh-ne per periudhen 2012-2014/10 i cili eshte perlllogaritur ne shumen 496.679 leke, kamatevonesa sipas sistemit informatik dhe gjobe ne shumen 464.169 leke. Paditesi ka ankimuar aktin administrativ te siperpermendur ne Drejtorine e Apelimit Tatimor e cila eshte shprehur me vendimin nr. 1851/1 Prot, date 19 .03.2015 dhe ka refuzuar te marre ne shqyrtim ankimin e bere duke qene se nga ana e tatimpaguesit nuk jane permbushur kerkesat dhe procedurat ne lidhje me pagesen e detyrimit tatimor para skadimit te afatit te ankimit. si te gjitha arsyetimin e tij ne lidhje me paligjshmerine e aktit administrative shqyrtimi i eshte referuar nenit 116/c te K.Pr.Administrative.

Qe te jemi perpara kushteve te parashikuara nga neni 116, pika c te K.Pr.Administrative duhet ti referohemi vete dispozites' Aktet administrative do te quhen absolutisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, ne rastet e meposhtme:

- a) kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ i paidentifikuar;
- b) kur akti eshti: nxjerre nga nje organ administrativ ne kapercim te kompetencave te tij ligjore;
- c) kur akti eshte nxjerre ne kundershkim me formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji e analize te dispozites se lartepermendur dhe akteve administrative objekt shqyrtimi Drejtoria Rajonale Tatimore Durres ka vepruar ne perputhje me formen dhe procedure ligjore te parashikuara nga ligji nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore me nr.yyyy Prot, date 29.12.2014 per shumen 960.848 leke ne te cilin eshte perfshire shuma e detyrimit themeltar dhe gjobot, konkretisht detyrim per tvsh-ne per periudhen 2012-2014/10 i cili eshte perlllogaritur ne shumen 496.679 leke, kamatevonesa sipas

sistemit informatik dhe gjobe ne shumen 464.169 leke te Drejtorise Rajonale Tatimore Durres, kane dale brenda kompetencave qe ka ne kete rast pala e paditur DRT Durres (ligjit te lartepemendur) dhe konform formes dhe procedurave ligjore te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Ne lidhje me piken "b" te nenit 116 te K.Pr.Administrative, persa i perket kompetencave te Drejtorise Rajonale Tatimore Durres per nxjerrjen e njoftim vleresimit tatimor, gjykata i referohet serish neneve 91, 112, dhe 119 te ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", dhe pikes 112 dhe 119 te udhezimit nr. 24, date 02.09.2008 i ndryshuar "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise". Ne keto dispozita eshte parashikuar e drejta e administrates tatimore per te aplikuar denimin me gjobe ne shumen 960.848 leke per detyrimet tatimore dhe gjoba. Pra, ne mbeshtetje dhe kendveshtrim te nenit 68, 113, 114 te ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", dhe pikes 119 te Udhezimit nr.24, date 02.09.2008 i ndryshuar "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", Drejtoria Rajonale Tatimore Durres ka qene kompetente ne nxjerrjen e njoftim vleresimit tatimor, objekt kontestimi.

Kolegji vlereson ashtu si gjykata e shkalles se pare se nisur nga aktet provuese vlereson se referuar provave shkresore te paraqitura nga pala e paditur ne mbeshtetje te pretendimeve te saj, rezulton se ne date 23.11.2010 ne Kavaje eshte ushtruar nga administrata tatimore kontroll tek subjekti, personi fizik = dhe eshte mbajtur akti i konstatimit perkates ne permbajtje te te eilit thuhet se "... Subjekti ushtron aktivitet ne pronen e tij ne nje siperfaqje prej 70 m2. Bazuar ne llojin e aktiviteti. siperfaqjen. inventaret ne shpenezime prej 1.2 milion leke , xhiros se realizuar dhe qarkores nr.1.datel-t. 1 2.2009 te Ministrise se Financave subjekti propozohet te kaloje ne skemen e TVSH me xhiro vjetore 5-8 milione leke biznes i vogel me TVSH Subjekti u njoftuar ne lidhje me pajisjen me kase fiskale brenda 15 diteve nga marrja e njoftimit te TVSH-se.. " Ky akt Icon tatimi eshte nenshkruar nga ana e tatimpaguesit, nga ana e DRT Dun-es ka dale njoftimi derguar ketij subjekti ne lidhje me ndreqjen e pergjegjesise se tij tatimore ne subjekt tatimpagues. Ne date me shkresen nr. yyyy/1 Prot DRT Dunes ka njoftuar tatimpaguesin e ne baze e te dhenave te regjistruara ne kase per vitin 2012, 2013, dhe 2014 eshte kter vleresimi per vitin 2012, 2013, 2014 dhe se prej tij eshte nderprere deklarimi i TVSH-se ne periudhen 2011-12, duke iu kerkuar te deklaroj e T SH per periudha ne vazhdim ne baze te ligjit nr.9920/2008. e date 29.12.2014 ka dale nj i vleresimi per detyrimet me nr.yyyy prot me te cilin paditesi I tatimpag njoftuar per nje detyrim ne shumen 960.848 leke , i cili eshte i perlllogari dhenat e procesverbalit te mbajtur ne DVATK ne date 26.12.2014 ipa e te kases te cilat administrohen nga DRT Durres dhe u perlllogaritur ne total detyrimet, si dhe kamte vonesat sipas sistemit.

Paditesi pretendon se detyrimet per shkak te TVSH-se nuk qendrojne pasi kalimi i tij si subjekt me TVSH nuk eshte bere ne perputhje me kriteret ligjore, per shkak te mospermbushjes nga ana e tij te nivelit te xhiros vjetore. Vendimi i marre nga pala e paditur per kalimin e tatimpaguesit ne subjekt me TVSH pasqyruar kjo ne regjistrimin e ketij tatimpaguesi site tille, daton ne vitin 2010, dhe subjekti deri ne vitin 2012 ka deklaruar TVSH, qe dote thote se nuk ka nje akt administrativ apo vendim gjyqesor qe te kete disponuar per cregjistrimin e tij nga kjo skerme, dhe ndryshimin e pergjegjesise se tij tatimore si subjekt me TVSH ne subjekt pa TVSH.

Ne analize te fakteve dhe kuadrit ligjore te sipercituar, gjykata konkludon se administrative objekt gjykimi nuk eshte nje akt administrativ absolutisht te lefshem, lidhje me piken "c" te nenit 116 te K.Pr.Administrative sipas doktrines respektimi i formes dhe i procedures per nxjerrjen e aktit administrativ perben nje element te rendesishem qe percakton vlefshmerine e tij. Shkelja e formes dhe e procedures mund te paraqitet ne menyra te ndryshme, por jo te gjitha shkeljet qe lidhen me formen dhe proceduren mund te shpien detyrimisht ne pavlefshmerine absolute te aktit. Pavaresisht se shkronja "c" e nenit 116 i referohet

cdo lloj shkeljeje te formes apo procedures qe ta quaje aktin absolutisht te pavlefshem, ndoshta dispozita nuk duhet kuptuar ne kete menyre. Mosrespektimi i ketyre elementeve duhet te jete e atij

karakteri dhe asaj rendesie qe te kete ndikuar drejtepersedrejti ne nxjerrjen e aktit administrativ. Ky kolegji vlereson se pala e paditur ka respektuar formen dhe proceduren e kerkuar ne ligj.

Eshte e vertete qe sipas nenit 17/2 te ligjit 49/2012 "Gjykata zgjidh mosmarreveshjet ne perputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera ne fuqi, qe jane te detyrueshme. Ajo ben nje cilesim te sakte te fakteve dhe veprimeve qe lidhen me mosmarreveshjen, pa u lidhur me percaktimin qe mund te propozojne palet" por ne rastin konkret paditesi ka shtrire kerkimin e tij ne lidhje me aktin administrativ, objekt shqyrtimi gjyqesor vetem tek pavlefshmeria absolute sipas kushteve te parashikuara nga neni 116 te K.Pr. Administrative, e ky kolegji sa siper analizoi kushtet e kesaj dispozite duke argumentuar se akti administrativ objekt shqyrtimi gjyqesor eshte nxjerre konform ligjit 9920/2008 i ndryshuar (brenda kompetencave qe ka pala e paditur ne nxjerrjen e tyre) dhe se eshte nxjerre brenda kompetencave te saj duke u respektuar forma dhe procedura per nxjerrjen e tij, cka do te thote se vendimet Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr. yyy date 29.12.2014 i Drejtorise Rajonale e Tatimore Durres e duhet te mbeten ne fuqi.

Kolegji Administrativ vlereson se, ne rastet kur kerkohet pavlefshmeria absolute e aktit administrativ, gjykata e shkalles se pare nuk shqyrton thelbin e tij, por mjaftohet vetem me verifikimin e kushteve te kerkuara nga neni 116 i K.Pr.Administrative.

Ky kolegji vlereson se ky qendrim eshte i konsoliduar ne raste te tilla, pasi ne shume vendimarrje te Kolegji Administrativ te Gjykates se Larte eshte mbajtur qendrimi se, kur kerkohet pavlefshmeria absolute e aktit administrativ juridiksioni gjyqesor nuk mungon, prandaj pala e interesuar mund ti drejtohet direkt gjykates pa gene nevoja qe me pare ti drejtohet organit administrativ, por ne kete rast gjykata qe shqyrton ceshtjen eshte e detyruar qe te zbatoje me rigorizitet kerkesat e nenit 116 te K.Pr.Administrative, duke u mjaftuar vetem me verifikimin e tre rasteve qe parashikohen ne te, sikunder u analizuan ne rastin konkret.

Ne keto kushte, Shkaqet qe ka bere ankuesi (pala paditese) ne ankim kane lidhje me themelin e kesaj ceshtjeje jane te atilla qe nuk te cojne ne cenimin e ketij vendimi per shkaqet e analizuara me detaje sa siper.

Sa siper, Gjykata Administrative e Apelit, c;mon se gh kata e shkalles se pare, ne kuptim te Nenit 17/2 te Ligjit Nr.49/2012, ka cilesuar sakte faktet dhe veprimet e lidhura me kete mosmarreveshie, ne funksion te zgjidhjes se drejte te ceshtjes dhe duke i interpretuar ato ne menyre korrekte, shkaqe qe cojne dhe ne lenien ne fuqi te ketij vendimi.

Shpenzime gjyqesore lidhur me kete ceshtje ne Gjykatën Administrative e Apelit, nuk u kryen.

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenin 50 te Ligjit Nr.49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshje e administrative",

VENDOSI

Lenien ne fuqi te vendimit Nr., date 13.07.2015 te Gjykates Administrative e Shkalles se Pare Durres.

.....

PADITES: Shoqeria " Sh.p.k.

TE PADITUR:

1. Drejtoria Rajonale Tatimore Diber.
2. Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane.
3. Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve.

OBJEKTI:

- 1)Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Aktit Administrativ "Akt-Konstatimi" Nr.abcd, date 09.09.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Diber.
- 2)Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Aktit Administrativ "Akt-Denimi" Nr. yyyy Prot., pa date te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane.
- 3)Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Aktit Administrativ "Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore" Nr.yyyy/1 Prot., date 20.10.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane.
- 4)Konstatimin e pavlefshmerise relative te Aktit Administrativ "Vendim" Nr.xxx/4 Prot., date 23.01.2015 te Drejtorise te Apelimit Tatimor prane Drejtorise te Pergjithshme te Tatimeve, dhe shfuqizimin e plote te ketij akti.
- 5)Pezullimin e ekzekutimit te Akteve Administrative, "Akt - Konstatimi" Nr.abcd, date 09.09.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Diber, "Akt - Denimi" Nr.yyyy Prot., pa date te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane, "Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore" Nr.yyyy/1 Prot., date 20.10.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane; dhe "Vendim" Nr. xxx/4 Prot., date 23.01.2015 te Drejtorise te Apelimit Tatimor prane Drejtorise te Pergjithshme te Tatimeve.
- 6)Detyrimin e paleve te paditura te paguajne shpenzimet gjyqesore dhe ato avokatore.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.8485, date 12.5.1999 "Kodi Procedurave Administrative", i ndryshuar; Ligji Nr. 49/2012, date 03.05.2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative", i ndryshuar; Ligji Nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar.

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr. 2195 (80-2015-892), date 23.04.2015 ka vendosur

1. Rrezimin e kerkese-padise.
2. Shpenzimet gjyqesore mbeten sic;Jane bere.

Kunder ketij vendimi ka bere ankim ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane, pala paditese shoqeria, me te cilin ka kerkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padise, per shkaqet:

Rezulton se ne daten 09.09.2014 ne ambientet e aktivitetit tregtar te lartpermendur ne Bulqize jane paraqitur shtetasit, me detyre inspektore ne sektorin e vleresimit ne terren prane Drejtorise Rajonale Tatimore Diber, te cilet kane ushtruar kontroll ne vendin e ushtrimit te aktivitetit te subjektit, dhe sipas tyre kane konstatuar se ne mjediset e minieres te fshatit Ternove, te administruara nga shoqeria

tregtare. jane gjetur te punesuar, pretendim ky i paraqitur nga ana e inspektoreve ne akt - konstatimin perkates. Ne baze te Listes te Punonjesve te deklaruar nga pala paditese ne organet kompetente tatimore per muajin Shtator 2014 rezulton se personi juridik ka te punesuar shtetasit nderkohe qe dy shtetasit e lartpermendur, nuk figurojne si punonjes te shoqerise tregtare Sh.p.k.

Shtetasi nuk eshte i punesuar prane shoqerise tregtare sic provohet plotesisht ne baze te Deklarates Noteriale Nr.xxxx Rep. dhe xxxx Kol., date 26.12.2014, ku shtetasi deklaroi me pergjegjesi te plote ligjore, duke qene i njohur me pasojat penale qe sjell nje deklarim i rreme se nuk

eshte punonjes 'prane minieres te kromit Ternove, dhe se ai banon ne Durres, Lagja 17 dhe punon ne Durres dhe si emigrant ne Greqi.

Deklaruesi shprehet se arsyeja per te cilen ai viziton fshatin eshte pasi ky fshat eshte vendlindja e tij, dhe familjaret e tij jetojne ende aty. • Ai deklaroi se gjate vizites se tij ne fshatin e lindjes ai ka shkuar te takojte vellain e tij (i cili punon si roje ne ambientet qe administrohen nga, dhe nuk eshte punonjes i , fakt ky i cili provohet ne baze te Deklarates Noteriale Nr. 18 Repertori, date 05.01.2014, te leshuar nga deklaruesi. Nder te tjera, deklaruesi shprehet se gjate kohes te pritjes te vellait te tij ne ambientet e ish - repartit te Temoves, nje person te cilin ai nuk e njohte e ka pyetur ate per emrin e tij, te cilin ai ia ka treguar. Menjehere pas shkembimit te ketyre fjaleve ai person eshte larguar, dhe ne ditet ne vijim deklaruesi eshte informuar ne lidhje me aktet administrative te lartpermendura, te cilat kane vendosur sanksion mbi subjektin ".

Per me teper, ne baze te nje kerkese per informacion date 16.01.2015 te derguar nga shoqeria tregtare Sh.p.k ne drejtim te komunes Zerqan, ku ne kerkuam adresen e banimit te shtetasit, duke i shpjeguar komunes se ky shtetas nuk ishte punonjesi yne, komuna Zerqan e ka informuar kete shoqeri tregtare nepermjet shkreses se pas verifikimeve te kryera nga Zyra e Gjendjes Ci vile nuk rezulton asnje person banor i Bashkise i quajtur, dhe per kete arsye nuk disponohet asnje e dhene ne lidhje me personin e lartpermendur apo adresen e tij.

Ne vijim te procedures te dergimit te akt - konstatimit per procedure te metejshme, Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane ka vijuar me nxjerrjen e akteve administrative "Akt- Denimi" Nr.yyyy Prot., pa date, dhe "Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore" Nr.yyyy/1 Prot., date 20.10.2014, ne baze te te cilave subjekti detyrohet te paguaje nje gjobe prej 1.000.000 Leke, ne mbeshtetje te Nenit 118 te Ligjit Nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, per mosmbajtje te sakte te librave, regjistrave dhe dokumentacionit.

Pasi na jane komunikuar aktet administrative te lartpermendura, ne daten 03.11.2014 ne kemi depozituar ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve nje kerkese Nr. 26680 Prot per apelim te aktit administrativ, "Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore" Nr.yyyy/1 Prot, date 20.10.2014, ne baze te Nenit 106 te Ligjit Nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, si dhe paragrafit 106.1 te Udhhezimit Nr. 24, date 02.09.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, ne te cilin kemi theksuar faktin se shtetasit nuk jane te punesuar prane shoqerise , dhe gjithashtu kemi theksuar faktin se nuk ekziston asnje dokument vertetues, i cili te provoje se dy shtetasit e lartpermendur jane punonjes te shoqerise tregtare

Ne pergjigje te kerkeses te lartpermendur per apelim, ku ne kemi kerkuar te jemi prezente ne momentin e shqyrtimit te ankimit, Drejtoria e Apelit Tatimor i ka derguar shoqerise tregtare shkresen Nr. 26680/1 Prot, date 19.01.2015, ku e ka informuar kete shoqeri se

takimi midis ishte caktuar ne daten 22.01.2015, ora 13.00, dhe ne vijim kjo shoqeri tregtare ka marr pjese ne kete takim, ne te cilin asaj i eshte kerkuar verbalisht ge te parages argumenta shtese ne lidhje me sqartmrn e rrethanave te• ngjarjes ne fjafe.

Ne vijim te kesaj procedure, sic e kemi shpjeguar dhe ne kerkese - padine perkatese dhe ne pretendimet e paraqitura nga ana jone ne Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare Tirane, shoqeria tregtare ka derguar ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve shkresen "Dergim shtese dokumentacioni e kerkeses per apelim te njoftim - vleresimit Nr. yyyy Prot., date 20.10.2014", ne te cilen kjo shoqer

i tregtare ka bashkelidhur dokumentacion se as shtetasi nuk jane punonjes te shoqerise tregtare.

Per me teper, ne daten 16.01.2015 shoqeria tregtare ka derguar ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve (Drejtoria e Apelimit Tatimor) informacionin shtese ne lidhje me proceduren e lartpermendur te apelimit, i protokolluar ne DPT me Nr.xxxx/2 Prot, ne te cilin kemi cituar shkeljet e renda procedurale te kryera nga administrate tatimore ne lidhje me publikimin dhe njoftimin e akteve administrative "Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore" Nr. xxxx/1 Prot, date 20.10.2014 te Drejtoris Rajonale Tatimore Tirane,dhe "Akt - Konstatim Nr. xxxx,date 09:09:20-I4-1e-Drejtorise-Rajonaie Tatiruore Diber

Ne vijim te kesaj procedure, Drejtoria e Apelimit Tatimor prane Drejtorise te Pergjithshm te Tatimeve i ka derguar shoqerise tregtare Vendimin e saj Nr.xxx/4 Prot, date 23.01.2015, ne haze te se cilit ka lene ne fuqi Aktin Administrativ "Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore" Nr. yyyy/1 Prot, date 20.10.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane, ne lidhje me gjoben per "punonjes te paregjistruar", ne shumen 1.000.000 Leke.

Theksojme per Gjykatën se ne vendimin e lartpermendur Drejtoria e Apelimit Tatimor ka kryer thjesht nje citim te disa dispozitave te Ligjit Nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, dhe ka anashkaluar plotesisht faktin thelbesor se as shtetasi dhe as shtetasi nuk jane punonjes te shoqerise tregtare por ndodheshin rastesisht ne vendine ushtrimit te aktivitetit te kesaj shoqerie, sic rezulton nga i gjithe dokumentacioni perkates bashkelidhur si prove ndaj kesaj kerkese - padie.

Nga ana procedurale, rezulton se tre aktet administrative, "Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore" Nr.yyyy/1 Prot., date 20.10.2014 i Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane, "Akt - Konstatimi" Nr.abcd, date 09.09.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Diber dhe "Akt - Denimi" Nr. yyyy Prot, pa date i Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane jane akte administrative absolutisht te pavlefshme, per arsye se jane nxjerre ne kundersizhtim me proceduren e kerkuar nga ligji.

Se pari, rezulton se administrata tatimore nuk i ka derguar tatim paguesit njoftimin e kontrollit, ne haze te Nenit 81 te Ligjit Nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, i cili duhet te percaktoje daten dhe vendin e kontrollit, per arsye se shoqeria tregtare nuk ka marre asnje njoftim ne lidhje me kontrollin qe do te kryhej tek kjo shoqeri, dhe per rrjedhoje, procedura ne fjale nuk eshte zbatuar.

Ne rastin konkret, rezulton se ne Akt - Konstatimin e dates 09.09.2014 inspektoret e administrates tatimore Diber citojne nje urdher pune me Nr.5863, date 09.09.2014, nderkohe qe anashkalohet fakti se ky urdher pune i hartuar dhe i zbatuar brenda dates 09.09.2014, nuk i eshte njoftuar subjektit te kontrolluar, aq me teper kur selia e ketij te fundit ndodhet ne qytetin e Tiranes, ndersa aktiviteti i ktij subjekti zhvillohet ne minieren e Ternoves, ne Bulqize, Ne kete menyre, rezulton se programi i kontrollit apo urdhri i punes nuk i jane dhene asnje perfaqesuesi te subjektit, por jane gjetur persona te cilet ndodheshin rastesisht ne vendin e ushtrimit te aktivitetit te ketij subjekti, dhe eshte hartuar nje akt - konstatimi, i cili nuk eshte nenshkruar nga shtetasit ne lidhje me te cilet adrnistrata tatimore pretendon se jane te punesuar ne shoqerine tregtare Sh.p.k.

Se dyti, rezulton se referuar Nenit 83 te Ligjit Nr.9920, date 19 .05 .2008 "Per procedurat tatimore ne

Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, inspektorët e grupit të kontrollit nuk i kanë komunikuar raportin e kontrollit palet paditese, në lidhje me të cilin ata kanë detyrimin e hartimit.

Se treti, rezulton se gjatë procedurave të lartpërmendura është shkëlur Neni 84 i ligjit të lartpërmendur, i cili parashikon se grupi i kontrollit shqyrton kundërshtimin tatimpaguesit, arsyetohet për provat dhe argumentat e paraqitura dhe harton raportin përfundimtar të kontrollit në rastin konkret, shoqëria tregtare Sh.p.k ka marrë vetëm Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore Nr.yyyy/1 Prot., datë 20.10.2014 dhe Aktin e Denimit Nr.yyyy Prot., të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, dhe nuk ka marrë raportin përfundimtar të kontrollit përkatës.

Duke patur parasysh të gjitha faktet e mësipërme, në rastin konkret është e qartë se palet e paditura nuk kanë zbatuar procedurën për nxjerrjen e akteve administrative të lartpërmendura, e cila është kushti i vetëm dhe i mjaftueshëm për pavlefshmerinë absolute të akteve administrative të lartpërmendura (objekt gjykimi), në bazë të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky është qëndrimi që mbanjurisprudenca shqiptare, e me konkretisht Neni 116 i Kodit të Procedurave Administrative, në të cilin gjejmë të percaktuar se Aktet Administrative janë absolutisht të pavlefshme në rastet kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga Ligji.

Në lidhje me shkeljet materiale të ligjit të kryera nga ana e administratës tatimore, në rastin konkret duhet të theksojmë se sic rezulton në bazë të të gjitha provave që i janë bashkëlidhur kësaj kerkese - padie, shtetasit nuk janë punonjës të shoqërisë tregtare " Sh.p.k, dhe për këtë arsye, është krejtësisht absurde që kjo shoqëri tregtare të ngarkohet me një sanksion në lidhje me mosdeklarimin e dy shtetasve, të cilët nuk janë dhe nuk kanë qenë në asnjë rast dhe asnjë moment kohor punonjës të kësaj shoqërie.

Është e rëndësishme të përsëritim se në bazë të Listës të Punonjësve të deklaruar nga pala paditese në organet kompetente tatimore për muajin Shtator 2014 (bashkëlidhur si prove shprehëse ndaj kësaj kerkese padie) rezulton se personi juridik ka të punësuar shtetasit, ndërkohë që dy shtetasit e lartpërmendur, nuk janë punonjës të shoqërisë tregtare Sh.p.k.

Për më tepër, rezulton mjaft i habitshëm fakti se në datën e kryerjes të kontrollit përkatës (09.09.2014), asnjë nga personat e punësuar dhe të deklaruar të shoqërisë tregtare Sh.p.k nuk ndodhej në asnjërin prej galerive të minierës, por aty gjendeshin dy persona, në lidhje me të cilët inspektorët kanë konstatuar në mënyrë të pavarur dhe pa patur asnjë lloj prove se janë punonjës të shoqërisë Sh.p.k. pavarësisht se në të njëjtën minierë '7onin aktivitetin e tyre dhe tre shoqëri të tjera tregtare, dhe pavarësisht faktit se njëri nga punonjësit e shoqërisë Sh.p.k nuk ndodhej në minierë, për arsye se është e administruar nga ana e kësaj shoqërie (pra galeria Nr.1) kishte qëndruar e mbyllur për gjithë javën përkatëse.

Gjithashtu, rezulton se Akti Administrativ "Vendim"Nr.xxx/4 Prot, datë 23.01.2015 i Drejtorisë të Apelit Tatimor pranë Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve është një akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me ligjin, duke qenë se bazohet në aktet administrative të lartpërmendura, të cilat janë absolutisht të pavlefshme, dhe për pasojë ky akt administrativ është relativisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 18.1 të Kodit të Procedurave Administrative.

Për të gjitha këto arsye, bazuar në sa më lart, në ushtrim të së drejtës sone kushtetuese, si dhe në referencë të Neneve 44 e vijues të Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", në si pale paditese përfundimisht përpara kësaj Gjykate të Nderuar kërkojmë:

Ndryshimin e Vendimit, datë 23.04.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në mbështetje të Nenit 50(c) të Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative" dhe pranimin e kerkese - padisë të paraqitur nga ana e shoqërisë tregtare Sh.p.k.

Gjykata Administrative Apelit;

Si u njoh me relatimin e gjyqtares, shqyrtoi aktet e dosjes dhe analizoi ceshtjen ne teresi;"

VEREN

Rrethanat e ceshties:

Pala paditese shoqeria sh.p.k eshte person juridik, regjistruar me date 13.05.20 ne QKR paditese ushtron veprimtarine tregtare ne fushen e ndertimit te, prodhimit te energjise elektrike 10 deri 25 mega vat, si dhe punimeve minerale te kromit.

Pala paditese ushtron aktivitet ne adresen dytesore prane Ish-Burgut, ne nxjerrjen e mineralit te kromit ne minieren e fshatit. Ne kete minier, kjo shoqeri e ushtron aktivitetin e saj ne galerine.

Referuar aktit te konstatimit Nr. date 09.09.2014 rezulton nga ana e inspektoreve te Drejtorise Rajonale Tatimore Diber, Sektori i Verifikimit ne Terren, ne zbatim te urdhrat te punes nr. prot. date 09.09.2014 eshte ushtruar kontroll ne aktivitetin e pales paditese ne minieren e fshatit. Ne akt konstatimi permbahet se "grupi i punes ushtroi kontroll ne vend biznesin e subjektit "Teodori" shpk,, adrese dytesore ne fshatin Ternove, ish burgu ne oren 15:20 ku konstatoi se: ne vend biznes u gjeten te punesuari. Me shkresen nr. prot. date 26.09.2014 ky akt konstatimi i eshte derguar per verifikim e ndjekje Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane si organi prane te cilit eshte regjistruar si tatimpagues pala paditese. Nga te dhenat e shoqerise te deklaruar prane organeve tatimore rezulton e provuar se shtetasit dhe nuk jane punonjes te deklaruar prane organeve tatimore. Me Njoftim-Vleresimi Detyrimi Tatimor nr. /1 prot., date 20/10/2014 pales paditese i eshte njoftuar detyrimi tatimor per periudhen shtator 2009, "Gjobe" ne masen leke. Shkak i vendosjes se kesaj gjobe eshte mosdeklarimi i punonjesve.

Mbi pretendimin se shtetasit nukjane punonjes te saj, pala padites, ka ankimuar Njoftim Vleresimin per Detyrimin Tatimor prot., date 20/10/2014 me kerkesen ankimore protokolluar prane Drejtorise se Apelimit Tatimor me nr date 03.11.2014. Pala paditese ka deklaruar se punonjes te saj jane shtetasit, keta te fundit te rezultuar ne sistemin tatimor, formulari E -sig 027.

Me shkresen e dates 06.01.2015 pala paditese ne mbeshtetje te ankimit i ka derguar Drejtorise se Apelimit Tatimor nje deklarate noteriale te shtetasit sipas se ciles ky i fundit deklaroi se nuk eshte punonjes i shoqerise ne minieren e kromit te fshatit por se ai banon ne Durres, dhe punon ne kete qytet si dhe ne Greqi. Ne kete deklarate citohet se, ai ka vizituar fshatin qe eshte vendlindja e tij dhe ka shkuar te takojte vellane e tij, shtetasin qe punon si roje e nje objekti te nje shoqerie tjeter minerare, eshte gjetur rastesisht aty ku eshte pyetur nga nje person i panjohur per emrin e tij, te cilin nuk ia ka treguar. Edhe ne lidhje me personin tjeter, pala paditese ka pretenduar ne materialin me shkrim derguar Drejtorise se Apelimit Tatimor se nuk eshte punonjes i saj, e se ky person nuk ekziston ne regjistrat e gjendjes civile te Qarkut Diber e nuk eshte banor i Bashkise , pretendim per te cilin pala paditese referon ne vertetimin nr. 78 prot. date 20.01.2015.

Rezulton se, Drejtoria e Apelimit Tatimor i ka derguar pales paditese shkresen Nr. Prot, date 19.01.2015, ku e ka informuar kete shoqeri se ka te drejten te paraqitet ne takim ne daten 22.01.2015, ora 13.00 per te dhene argumente dhe sqarime. Ne vijim, kjo shoqeri ka marre pjese ne kete takim ku ka parashtruar pretendimet si me siper si dhe ka pretenduar se procedura eshte kryer ne shkelje te dispozitave te ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise"

te ndryshuar lidhur me ushtrimin e kontrollit tatimor.

Persa me siper, pala paditese ka referuar para Drejtorise se Apelimit Tatimor pretendimet e parashtruara dhe ne shkresen e dates 16.01.2015, se, nuk i eshte derguar nga ana e administrates tatimore asnje njoftim per u shtrim kontrolli duke percaktuar objektin e tij, daten dhe vendin e kontrollit

Ne mungese te ketij lajmerimi asnje perfaqesues I shoqerise nuk ndodhej ne ditën e kryerjes se kontrollit ne vendin e ushtrimit te aktivitetit, kjo dhe per faktin se aktiviteti ishte nderprere disa jave me pare. Pala paditese ka vijuar ne pretendimin se, jane gjetur njerez te rastit dhe eshte plotesuar akt konstatimi pa u nenshkruar nga personat e pretenduar si punonjes te saj. Ky akt konstatimi nuk eshte mbajtur ne vendin e ushtrimit te kontrollit ne vendbiznesin e saj.

Pala paditese ka pretenduar gjithashtu se ne akt konstatimi citohet ushtrimi i kontrollit bazuar ne urdhrin e punes nr. 5863 date 09.09.2014, porky urdher pune i hartuar dhe zbatuar ne te njejten dite, nuk i eshte njoftuar asaj e per me teper qe selia e shoqerise eshte ne Tirane ndersa aktiviteti i punes eshte ne fshatin Ternove, Bulqize. Pra ka pretenduar pala paditese, nuk i eshte njoftuar asnje program kontrolli apo urdher pune. Ne vijim jane shkelur percaktimet e ligjit Nr.9920/2008 te ndryshuar per njoftimin e raportit te kontrollit me qellim dhenien e mundesise per paraqitjen e kundershtimeve, ne vijim, njoftimi i raportit perfundimtar te kontrollit. Edhe kjo procedure ligjore nuk eshte zbatuar ne rastin konkret.

Nga ana e pales se paditur, Drejtoria e Apelimit Tatimor kerkesa ankimore e pales paditese nuk eshte marre ne konsiderate e per rrjedhoje me vendimin e saj Nr. xxx/4 prot., date 23/01/2015 eshte vendosur "Lenia ne fuqi e aktit administrativ, Njoftim Vleresimi per Detyrimin Tatimor nr. 71184/1 prot., date 20/10/2014 te leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane. Ne keto rrethana e mbi pretendimet si me siper parashtruar ne ankimin administrativ, pala paditese, shoqeria "" shpk i eshte drejtuar Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane duke kerkuar. 1)Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Aktit Administrativ "Akt- Konstatimi" Nr.abcd, date 09.09.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Diber. 2) Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Aktit Administrativ "Akt- Denimi" Nr. yyyy Prot., pa date te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane. 3)Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Aktit Administrativ "Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore" Nr. yyyy/1 Prot., date 20.10.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane. 4)Konstatimin e pavlefshmerise relative te Aktit Administrativ "Vendim" Nr.xxx/4 Prot., date 23.01.2015 te Drejtorise te ApelimitTatimor prane Drejtorise te Pergjithshme te Tatimeve, dhe shfuqizimin e plate te ketij akti.

Se bashku me kerkimet si me siper pala paditese ka kerkuar dhe pezullimin e ekzekutimit te Akteve te mesiperme. Kjo kerkese per sigurimin e padise eshte refuzuar nga Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane me vendimin e dates 10.03.2015. Rezulton gjithashtu se pala paditese me shkresen nr. 86120 date 26.11.2014 "Njoftim dhe kerkese per t'u paguar" eshte njoftuar per pagimin e kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore ne shumen prej 1039530 leke, perllogaritur per personat si me siper per te cilat eshte penalizuar me gjobe per shkeljen "mosdeklarim punonjesi".

Vleresimi i Gjykates se Shkalles se Pare:

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr. , date 23.04.2015 ka vendosur rrezimin e padise site pabazuar ne prova dhe ne ligj.

Gjykata e shkalles se pare ka vleresuar kerkimet e pales paditese per kundershkrimin si akte administrative te aktit te konstatimit Nr. abcd, date 09.09.2014 te mbajtur nga inspektoret tatimore te

Drejtorise Rajonale Tatimore Diber si dhe te akt denimit Nr. yyyy Prot., pa date te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane jane te pabazuara ne ligj. Keto akte nuk perbejne akte administrative te kundershueshme si te tilla ne gjykate, pasi "nje nga elementet qe duhet te kete nje akt per tu klasifikuar per shkak te ligjit ne akt administrativ eshte fakti qe akti duhet te krijoje, ndryshoje ose shuaje nje marredhenie juridike konkrete ... Akt konstatimi ne vetvete eshte nje akt ashtu dhe si emertohet thjesht konstaton shkeljen dhe nuk eshte akt qe mbarte nje detyrim perfundimtar per palen paditese dhe nuke merr emeratesen se eshte akt administrativ. Gjithashtu edhe akt denimi nuk eshte akt qe ligji per procedural tatimore e lidh drejteperdrejte me pasojen juridike. "

Gjykata ka cilesuar se "eshte pikerisht njoftim vleresimi detyrimi tatimor dhe Vendimi i Drejtorisee se Apelimit Tatimor aktet qe ligji ne kuader edhe te vetkontrollit te brendshem administrativ dhe hierarkise administrative i lidh me pasoje perfundimtare dhe te ekzekutueshme per paditesin. Per rrjedhoje vetem keto dy akt marrin stadin dhe quhen akte administrative dhe mund te kundershohen gjyqesisht nga pala paditese. "

Ne vijim te arsyetimit, gjykata e shkalles se pare evidendon se pala paditese referon dhe kerkon pavlefshmeri absolute te akteve ne nje kohe qe kerkon te provoje edhe rrethana faktike te cilat tentojne te provojne se shkelia ne fakt nuk ka ndodhur, por thekson se, ne nje padi qe kerkohet pavlefshmeri absolute e aktit administrativ gjykata si rrjedhoje perqendrohet vetem ne kuader te verifikimit te pavlefshmerise se aktit qe kundershohet nga pala paditese brenda kufijve te pavlefshmerise absolute. Pra ne kete lloj pavlefshmeria gjykata i referohet aktit administrativ ne keto drejtime kryesore: -organi administrativ qe ka nxjerre aktin - kompetenca e tij si dhe forma dhe procedura e ndjekur nga pala e paditur ne nxjerrjen e ketij akti.

Ne analize te pretendimeve te pales paditese gjykata e shkalles se pare ka arritur ne perfundimin se, "ne kuader te verifikimit te procedures se nxjerrjes se njoftim vleresimi dhe vendimit te drejtorise se pergjithshme te tatimeve nuk rezulton ne asnje moment se ka shkelje flagrante te procedures se nxjerrjes se aktit. "Pala paditese ne cdo rast i referohet nje procedure kontrolli tatimor ku per rrjedhoje kerkon ekzistencen e raport kontrollit apo raport kontrollit perfundimtar, por ne rastin konkret ndaj pales paditese eshte ushtruar verifikimi ne vend si nje forme e kontrollit tatimor dhe jo ajo e kontrollit tatimor te plote ne vend, apo vizite fiskale. Verifikimi ne vend si lloj kontrolli nuk eshte i lidhur me permbushjen e pretendimeve te ngritura nga pala paditese pasi kjo bie ndesh me llojin e kontrollit qe ushtrohet. Si rrjedhoje pala paditese nuk mund te pretendoje njoftim paraprak te kontrollit apo raport kontrolli kur jane mbajtur akt konstatimi, akt denimi dhe pales.i .eshte .komunikuar dhenjoftim vleresimi per- detyrimin respektiv.

Gjykata e shkalles se pare cileson se, pretendimet e pales paditese se, shtetasit nuk jane punonjes te saj, apo nuk jane gjetur ne ambientet e ushtrimit te aktivitetit jane pretendime fakti te cilat duhet te kontestohen ne gjykate brenda 30 diteve ne kuader te kundershimit te aktit per pavlefshmeri relative.

Gjykata ka vleresuar se: "Te gjitha pretendimet e ngritura nga pala paditese per te kundershuar ekzistencen e faktit ne raport me rrethanat e ndodhura ne to Jane pretendime qe nuk gjejne mbeshtetje dhe mbrojtje nga pavlefshmeria absolute e aktit. Akti i konstatimit i cili kundershohet nga pala paditese se nuk pasqyron gjendjen e faktit me vertetesi, eshte nje akt zyrtar me fuqi te plate provuese i cili provon dhe shkeljen e konstatuar, Pala paditese lidhur me kete moment nuk arriti te ngrinte pretendimi ashtu si ligji e kerkon dhe nuk paraqiti asnje prove ne mbeshtetje te kesaj rrethane dhe te padise te saj ku provimi i se ciles do te sillte lindjen e te drejtave per te. Per me teper rezultoi se pikerisht te 2 emerat e punonjesve te konstatuar si te padeklaruar ne organet tatimore Jane gjetur ne

ambJentet e punes ne oraret e punes se pales se paditur par nuk Jane punonjes te saj. Pala paditese nuk mund te provoje keti: fakt me deklarime te personave pasi "Igo nuk sjell ne bindjen e gjykates asgje tefaktit te konstatuar. Duke patur parasysh: -Llojin e padise; -aktet qe kundershohen; -pretendimet e pales paditese dhe kuadrin e provave gjykata konkludon se padia e pales paditese nuk eshte e mbështetur ne ligj dhe prova. Si rrjedhoje gjykata konkludon se kerkese padia e pales paditese duhet te rrezohet si e pambështetur ne ligj dhe ne prova".

Vleresimi i Gjykates Administrative te Apelit

Kolegji Administrativ i Apelit, ne analize te fakteve dhe rrethanave rezultuar ne lidhje me kete rnosmarreveshje si dhe pretendimeve te pales paditese, shoqeria shpk cmon se vendimi Nr. date 23.04.2015 i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane eshte rrjedhoje e zbatimit te drejte te ligjit material e procedural e si i tille duhet lenë ne fuqi.

Provohet nga aktet e gjykimit ne shkalle te pare se mosmarreveshja objekt gjykimi ka per objekt kundërshtimet e pales paditese tatimpaguese shoqeria shpk te denimit te saj me gjobe ne shumen 1.000.000 leke per shkeljen administrative "mosdeklarim punonjesi", Shkelja eshte cilesuar e kryer nga pala paditese bazuar ne aktin e konstatimit Nr. abcd, date 09.09.2014 te mbajtur nga inspektorët e Sektorit te Verifikimit ne Terren te pales se paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Diber ne zbatim te urdhrët te punes nr. prot. date 09.09.2014.

Ne akt konstatimi pershkruhet se "grupi i puniis ushtroi kontroll ne vend biznesin e subjektit shpk,, adrese dytesore ne fshatin Ternove, ish burgu ne oren 15:20 ku konstatoi se: nii vend biznes u gjeten te punesuaritNe vijim te procedures derguar per kompetence Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane, prane te cilit ndodhet dosja e pales paditese si tatimpagues me seli ne Tirane, ka rezultuar nga verifikimet ne sistem TAX CRM se personat si me siper nuk rezultojne te jene deklaruar nga pala paditese ne listepagesat e dorezuara ne DRT Tirane.

Sanksioni me gjobe eshte vendosur sipas Neni 119 i Ligjit nr. 9920 date 19.07.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar (me Ligjin Nr.124/2012, date 20.12.2012, botuar ne Fl.z. nr. 177, dt. 09.01.2013). Kjo dispozite percakton se:

"Nese nga verifikimi dhe kontrolli nii vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar ne organin tatimor cdo te punesuar rishtazi, tii pakten njii dite kalendarike perpara fillimit te punes, pervec detyrimit per pagimin e shumes se detyrimeve tatimore dhe kontributeve tii sigurimeve shoqiirore e shendetesore, te llogaritura nga data e konstatimit, denohet me gjobe per cdo punonjiis tii padeklaruar si me poshtii:

- a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobe pre} 500 000 (peseqind mije) lekesh;
- b) tatimpaguesit e tjere, me gjobe pre} 250 000 (dyqind e pesedhjetë mije) lekesh."

Ky sanksion permbahet ne aktin administrativ, Njoftim Vleresimi Tatimor nr. ccccc/1 prot., date 20/10/2014 te leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane. Rezulton se krahas ketij sanksioni, referuar dhe percaktimit te mesiperm te ligjit, me shkresen nr. xxx date 26.11.2014 "Njoftim dhe kerkese per t'u paguar" pales paditese I njoftohen per pagim kontributet e detyrimeve shoqerore dhe shendetesore te shmangura ne shumen prej 1039530 leke

Konstatohet nga materialet e gjykimit ne shkalle te pare se pala paditese ka pretenduar edhe ne gjykim per penalizim te padrejte nga ana e administrates tatimore dhe vendosjen e tij ne rrethanat e shkeljes se procedures se detyrueshme qe duhet ndjekur ndaj saj si tatimpagues. Permes ankimit pala paditese

ka kerkuar qe pretendimet e saj jane vleresuar ne kundershtim me ligjin nga gjykata e shkalles se pare dhe se ne te kundert, duhej pranuar padia per kerkimet "1)Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Aktit Administrativ "Akt- Konstatimi" Nr.abcd, date 09.09.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Diber. 2) Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Aktit Administrativ "Akt- Denimi" Nr. yyyy Prot., pa date te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane. 3)Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Aktit Administrativ "Njofim Vleresimi per Detyrimet Tatimore" Nr. yyyy/1 Prot.,date 20.10.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane. 4)Konstatimin e pavlefshmerise relative te Aktit Administrativ "Vendim" Nr.xxx/4 Prot., date 23.01.2015 te Drejtorise te Apelimit Tatimor prane Drejtorise te Pergjithshme te Tatimeve, dhe shfuqizimin e plate te ketij akti."

Kolegji Administrativ i Gjykates se Apelit vlereson se gjykata e shkalles se pare ka cilesuar kerkimet e pales paditese dhe objektin e mosmarreveshjes ne perputhje me percaktimet e ligjit. Ne pergjigje te ketyre pretendimeve te pales paditese parashtuar dhe ne ankim, ky Kolegj thekson se gjykata e shkalles se pare ka cmuar drejt se nuk gjejne mbeshtetje ligjore kerkimet e pales paditese per kundershtimin si akte administrative te pavlefshme te aktit te konstatimit Nr. abcd, date 09.09.2014 te mbajtur nga inspektorët tatimore te Drejtorise Rajonale Tatimore Diber si dhe te akt denimit Nr. yyyy Prot., pa date te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane.

Ligji i posacem nr. 9920/2008 i ndryshuar normon ne nenin 106, pika 1 e tij se "1. Tatimpaguesi mund te ankimoje kunder cdo njoftim vleresimi, cdo vendimi qe ndikon ne detyrimin e tij tatimor, cdo kerkese per rimbursim ose lehtesim tatimor, ose cdo akti ekzekutiv te posacem tatimor". Sipas nenit 2, pika 2 e ligjit Nr. 49/2012 perkufizohet se "Akt administrativ individual" eshte cdo vullnet i shprehur nga organi publik, ne ushtrim te funksionit te tij publik, ndaj nje ose disa subjekteve individualisht te percaktuara te se drejtes, qe krijon, ndryshon ose shuan nje marredhenie juridike konkrete. "

Ne analize te ketyre dispozitave ne fuqi e qe gjejne zbatim per zgjidhjen e kesaj mosmareveshje, Kolegji Administrativ i Apelit cmon se me te drejte ka evidentuar gjykata e shkalles se pare se keto akte, te mbajtura nga inspektorët tatimore per dokumentimin e veprimeve ne kuader te verifikimit te gjendjes ne veprimtarine e subjektit tatimpagues, nuk jane akte administrative ne kuptimin qe jep neni 2, pika 2 e ligjit 49/2012. Ne haze te percaktimeve te ligjit te posacem Nr.

9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" te ndryshuar, keto akte nuk jane te kundershtueshme ne gjykate sipas nenit 17, pika 1, germa "a" e ligjit 49/2012. • Kjo per arsyen se ato nuk plotesojne elementin juridik qe karakterizon aktin administrativ si shprehje e vullnetit te organit te administrates publike me pasoje krijimin, ndryshimin ose shuarjen e nje rnarredhenie juridike konkrete.

Ne lidhje me arsyet e kundershtimit nga pala paditese te aktit administrativ, Njoftim Vleresimi Tatimor nr.71184/1 prot., date 20/10/2014 te leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane si dhe vendimit te Drejtorise se Apelimit Tatimor Nr. xxx/4 prot., date 23/01/2015 per lenien e tij ne fuqi, Kolegji Administrativ i Apelit vlereson se veprimtaria e pales se paditur DRT Tirane eshte rrjedhoje e ndjekjes se procedurave ne perputhje me ligjin Nr. 9920 date 19.07.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar dhe ne ushtrim te pergjegjesive te saj ligjore.

Ky Kolegj gjen te bazuara ne ligj perfundimet e arritura nga gjykata e shkalles se pare se nuk ekzistojne asnje nga rrethanat e parapara nga ligji i posacem qe bejne te cenuseshem veprimtarine e ushtuar nga administrata tatimore ne vendosjen e penalitetit ne shumen 1.000.000 leke ndaj pales paditese per shkeljen "mosdeklarim punonjesi", njoftuar me Njoftim Vleresimi Tatimor Nr. 71184/1 prot., date 20/10/2014.

Ne nenin 80 te ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 dhe piken 80.3 te Udhhezimit nr. 24 date 02.09.2008 nxjerre ne zbatim te tij detajohet "verifikimi ne vend" si forme e kontrollit tatimor. Ne udhezim percaktohet menyra e ushtrimit te verifikimit ne vend per efekt te ligjshmerise se tij me permbajtjen se : "80.3.c) Verifikimet ne vend. Keto verifikime te shkurtra synojne zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me regjistrimin e personave te tatueshem (identifikimin e personave te paregjistruar), me perdorimin e pajisjeve fiskale, me perdorimin e pullave fiskale ne mallrat e akcizes, me dokumentimin e mallrave ne ruajtje, perdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe leshimin faturave tatimore, etj.

Keto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak te personave te tatueshem, por vetem nepermiet prezantimit ne momentin e verifikimit, te dokumentit personal te verifikuesit dhe urdhrin e dites. Pretendimet e pales paditese per pavlefshmeri absolute te njoftim vleresimit tatimor Nr. 71184/1 prot., date 20/10/2014 me pretendimet se nuk i eshte njoftuar ushtrimi i kontrollit dhe programit te kontrollit, nuk ka qene present asnje perfaqesues i saj ne vendin e ushtrimit te kontrollit, nuk i eshte njoftuar raporti i kontrollit duke i cenuar te drejten e kundershtimeve dhe paraqitjes se observacioneve ndaj raport kontrollit, jane te papranueshme.

Sikurse me siper cituar verifikimi ne vend nuk mund te pengohet nga prania e perfaqesuesit te subjektit tatimpagues. Kjo forme kontrolli kryhet pa njoftim paraprak ne vendin e ushtrimit te aktivitetit dhe si e tille eshte e ndryshme nga ajo e kontrollit tatimor rregulluar sipas nenit 81 e vijues te ligjit. Ndaj edhe pretendimet e pales paditese per mosnjoftim paraprak dhe dergim te raport kontrollit me qellim paraqitjen e observacioneve brenda 5 diteve, jane rregullime tej kesaj fonde kontrolli, verifikim ne vend e si te tilla pa baze ligjore. Sa me siper jane analizuar ne menyre te plote e ligjore nga..gjkata e shkalles se pare ne vendimin objekt ankimit, ndaj pretendimet e pales paditese parashtruar dhe ne ankim, nuk gjejne mbeshtetje ligjore.

Ne vijim, sikurse referohet dhe ne spjegimet e pales paditese, nuk rezulton asnje rrethane qe te vleresohet nga gjykata per pavlefshmeri absolute te Vendimit Nr. prot., date 23/01/2015 te Drejtorise se Apelit Tatimor, nxjerre pas degjimit dhe shqyrtimit te pretendimeve te pales paditese ne kete procedure ankimit.

Edhe ne lidhje me pretendimet e pales paditese per kundershkrimin ne themel te arsyeve te nxjerrjes se aktit, pra se nuk ka kryer shkeljen administrative "mosdeklarim punonjesi" Kolegji Administrativ i Apelit vlereson se nuk ka shkaqe qe bejne te cenueshem perfundimin e arritur nga Drejtoria e Apelit Tatimor, gjendur i drejte nga gjykata e shkalles se pare.

Ne analize te pretendimeve ne ankimin administrativ si dhe ne padi e gjate gjykimit, Kolegji vlereson se pala paditese nuk kundershkon ne thelb gjendjen e faktit te konstatuar nga ana e inspektoreve tatimore, duke pranuar keshtu se dy shtetasit ne castin e kontrollit gjendeshin ne minieren e kromit. Pala paditese referon ne shpjegimet e saj se punonjesi gjendej rastesisht aty, ne nje ambient tjetër jo ne administrimin e shoqerise dhe nuk pranon faktin se personat te jene punonjes te saj. Lidhur me keto pretendime pala paditese referon deklaratat e leshuara nga personi si dhe vertetimin e leshuar nga Bashkia se nuk ka te regjistruar ne regjistrat e saj te gjendjes civile person me emrin , ky i fundit nuk eshte banor i Bashkise

Kolegji vlereson se keto pretendime te pales paditese jane analizuar nga gjykata e shkalles se pare ne perputhje me vleren e proves se akteve te administruara ne proces dhe barren e proves ne gjykimin

administrativ. Kolegji i vlereson teresisht te vlefshme e ligjore veprimet e kryera nga inspektorët tatimore, ato rezultojnë te kryera në ushtrim të detyrave të tyre funksionale, në zbatim të urdhrave të punës nr. 5863 prot. datë 09.09.2014, i cilesuar në akt konstatimi dhe dokumentuar veprimet në përputhje me ligjin. Ky akt pasqyron në mënyrë të plotë dhe të saktë të gjitha elementet që bëjnë të vlefshëm e ligjor përmbajtjen e tij, të dhënat e grupit të punës, subjektin e kontrolluar, orën dhe vendin e ushtrimit të kontrollit si dhe gjendjen e konstatuar. Pretendimet e palës paditëse për kundërshtimin e përmbajtjes së tij janë të papranueshme dhe nuk arrijnë të çojnë vlerën provuese të këtij akti zyrtar.

Për sa më sipër, duke vlerësuar të pabazuara shkaqet e ngritura në ankirnë, Kolegji Administrativ i Apelit konkludon se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet të lihet në fuqi pasi vjen si rezultat i çmuarjes së drejtë të provave në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

PER KETO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur në nenin 50, germa "b" të ligjit nr. 49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative",

VENDOSI

1. Lenien në fuqi të vendimit Nr., datë 23.04.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

2. Kunder këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmeja e njoftimit të tij.

.....

6.1.3 Vendimi nr.3 datë 22.11.2017

PADITËS: Shoqëria , me seli në Rrugën "" , Tiranë.

Të PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj.
Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit

ORJEKTI: Konstatimi i pavlefshmërisë absolute i njoftim vlerësimit tatimor, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj. Shfuqizimin e vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor. Përzullimin e zbatimit të aktit administrativ njoftim vlerësimi tatimor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj.

BAZA LIGJORE: Neni 7, 11 dhe 15/a, 17/c/ç i ligjit nr.49/2012 "Për Organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative"; neni 106, i 116 i ligjit nr.9920/2008 "Për procedurat tatimore në RSH"; neni 2/ 2 i ligjit nr. 9975,

date 20.07.2008 "Për taksat kombëtare": neni 116 i Kodit të Procedurave Administrative; neni 2,109 i ligjit nr. 162/2012 "Per akcizat ne RSH".

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane me vendimin nr.xxx, date 21.12.2016 ka vendosur:

Te refuzoje kerkesen e paditesit shoqeria për marrjen e masës për sigurimin e padisë "Pezullimin e zbatimit të aktit administrativ Njoftim Vleresimi Tatimor nr.xxxxxx/14, date 31.12.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Medhenj" si e pabazuar në ligj dhe në provë.

Kunder këtij vendimi lejohet ankimi i vecantë në Gjykatën Administrative të Apelit Tirane, brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmeja e shpalljes.

Kunder këtij vendimi në datë 27.12.2016 (derguar me postë me dt 23.12.2016) ka paraqitur ankimi shoqeria shë, duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesës së paditesit: Pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, njoftim vleresimi tatimor nr.xxxxxx/14, date 31.12.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Medhenj:

Paditesja, shoqëri me shkresën nr.xxxxxx, date 06.02.2014, nr.xxxxxx/3, date 01.04.2014 dhe nr.yyy, date 06.11.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Medhenj ka qenë subjekt i një kontrollit të plotë tatimor, ku sipas programit të miratuar objekt i këtij kontrolli kanë qenë tvsh-ja, tatim fitimi, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe taksat kombëtare, në përfundim të të cilit kjo e fundit ka dalë me raportin përfundimtar dhe me shkresën nr.xxxxxx/14, date 31.12.2015 "Njoftim vleresimi tatimor" është njoftuar për detyrimet tatimore të vleresuara nga kontrolli për tatim fitimit, tvsh-ne, taksat kombëtare, akcizë dhe tatim në burim në shumën 16.115.047,964 leke. Në datë 15.02.2016 pranë paditesës është depozituar edhe njoftim vleresimi tatimor nr.xxccc, date 15.02.2016 i DRTM me të cilin i janë njoftuar kamatëvonesat dhe gjërat nga sistemi tatimor në Shumën 1.080.638.414 leke kamatëvonesë dhe 713.487.110 leke gjëra. Paditesja duke mos qenë dakort me këto detyrime, brenda afatit ligjor 30 ditë i është drejtuar me ankim administrativ Drejtorisë së Apelit Tatimor, duke kërkuar shfuqizimin e aktit si absolutisht të pavlefshëm. Kjo e fundit me vendimin nr.xcxxx/1, date 03.03.2016 ka vendosur refuzimin e ankimit për shkak të mospagimit të plotë të detyrimit tatimor të vlerësuar dhe mosvendosjes së garancisë bankare.

bazuar në dispozitat e ligjit nr.9920/2008 "Për procedurat tatimore në RSH", paditesja ka detyrimin ligjor të paguajë detyrimin principal dhe kamatëvonesat të vleresuara nga kontrolli me qëllim që të hapet rruga për të ankimuar vleresimin në rrugë administrative dhe gjyqësore dhe për të pezulluar zbatimin e masave shtrenguese nga i padituri. Kështu bazuar në detyrimet e nxjerra në njoftim vleresimin tatimor nr.xxxxxx/14, date 31 12 2015 detyrimi principal i vlerësuar për të paguar nga paditesja është në shumën 6,548.814.122 leke, ndërsa kamatëvonesat e vleresuara në këtë njoftim vleresimi janë në shumën 1.096.398.834 leke dhe kamatëvonesat e vleresuara në njoftim vleresimin tjetër tatimor me nr.cccc, date 11.02.2016 janë në shumën 1.080.638.414 leke. Në total shuma e detyruar për të paguar është në vlerën 8.725.851.370 leke.

Ne

kushtet kur paditesja nuk ka mundesi pagimin e ketij detyrimi te vleresuar dhe ne kushtet kur nga i padituri kerkohet mbledhja me force e detyrimit, paditesja i kerkoi me kerkese gjykates per sigurimin e padise pezullimin e zbatimit te aktit administrative (mbledhjen e detyrimit tatimor), den ne perfundim te ketij gjykimi.

Gjithashtu ka shpjeguar perpara saj, se nga shuma e detyrimit te vleresuar ne njoftim vleresimin tatimor nr.xxxxxx/14, date 31.12.2016 (pa njoftim vleresimin tatimor nr.1976, date 11.02.2016 ku jane logaritur edhe kamatevonesat te tjera), vleren prej 10,811,585,631 leke e ze akciza, e cila eshte vleresuar nga i padituri ne kundershkrim flagrant me ligjin, me proceduren ligjore, me vendimet gjyqesore te formes se prere dhe ne kapercim te kompetencave ligjore. Pasi sikurse konstatohet qarte, nisur qe nga data e njoftimit te lajmerimit te kontrollit dhe programit te tij, se pad akciza nuk ka qene objekt i ketij kontrolli dhe sa kohe ajo nuk i eshte njoftuar paditeses per kontroll sipas nenit 81 te ligjit nr.9920/2008, atehere i padituri nuk mund te vleresonte kete detyrim. Edhe nese do t'i ishte njoftuar paditeses ne programin e kontrollit do te ishte kundershkruar prej paditeses, sa kohe qe ka nje vendim gjyqesor te formes se prere qe e perjashton paditesen nga pagimi i akcizes mbi lendet djegese te perdorura prej tij ne procesin teknologjik te prodhimit dhe sa kohe kompetenca per te kontrolluar dhe mbledhur akcizen me ligjin nr.61/2012 ka kaluar prane organit doganor. Ligji nr.61/2012 "Per akcizat ne RSH" ka hyre ne fuqi ne 01.10.2012 dhe me dispozitat kalimtare dhe me VKM nr.612, date 05.09.2012 eshte percaktuar se si do te rregullohej kompetenca e ketyre dy organeve (tatimore dhe doganore) gjate periudhes se ligji i vjeter ishte shfuqizuar dhe ligji i ri akoma nuk kishte hyre ne fuqi. Pra rregullohej periudha maj-tetor 2012. Ndersa pas kesaj periudhe kompetenca per kontroll dhe administrimin e ketij detyrimi eshte e organit doganor. Pra te gjitha keto fakte qe u vertetuan ne gjykate pasi ligji lexohet dhe eshte i qarte, dokumentacioni i kryerjes se kontrollit u depozitua ne gjykate ne cilesine e proves, ku provohet qarte datat e kryerjes se kontrollit, duke rezultuar i qarte se ky detyrim i vleresuar per akcizen i cili ze gati 80% te detyrimit te pergjithshem vleresuar eshte absolutisht i pavlefshem eshte nul dhe asnje veprim i mevonshem i organit tatimor nuk mund ta bej ate te vlefshem. Dhe ne kushtet kur vleresimi eshte nul dhe i nje shume tej mase te madhe nga paditesja eshte e pamundur pagimi i tij, qe te pengonte te paditurin me masat shtrenguese. Ne keto kushte i padituri ka zbatuar te gjitha masat shtrenguese duke sjell bllokimin total te veprimtarise se shoqerise prej gati 8 muajsh. Paditesi prej dhjetorit te vitit 2015 nuk funksionon, nuk paguan asnje punonjes i saj numri i te cileve eshte shume i madh. Te gjitha fakte tregojne se ekzistojne kushtet e percaktuara ne nenin 28 dhe 29 te ligjit nr.49/2012 qe Gjykata te merrte masen e sigurimit e padise duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ njoftim vleresimit tatimor.

a) Ekziston dyshimi i arsyeshem, i bazuar ne shkresa, per mundesine e shkaktimit te nje demi te rende, te pakthyeshem dhe te atecastshern per paditesin; Referuar fakteve te sipercituara paditesja eshte demtuar rende ne interesat e saj nga ky akt i paligjshem, i nxjerre nga ana e paditur. Faktet dhe dokumentet qe vertetojne shkaktimin e demit shume te madh jane vete
detyrimet
tatimore

shume te medha, jashte cdo kapaciteti ekonomik te nje shocerie tregtare dhe jashte cdo mundesie reale per te paguar. Nga zbatimi i masave shtrenguese bllokimi i llogarive bankare dhe cdo aset i shoqerise eshte bere e pamundur zhvillimi i aktivitetit te shoqerise. Ajo prej kesaj periudhe nuk ka kryer asnje lloj aktiviteti tregtar duke pezulluar edhe pagesen e pagave te punonjesve te saj ne te treja vendet e zhvillimit te aktivitetit ne. Dhe kjo gjendje nuk ka qene vetem e atecastshme por eshte e vazhdueshme dhe me pasoja per shoqerine. Asnje veprim i mevonshem nuk do ta rekuperonte dot humbjen e pesuar ngashoqeria per kete periudhe te bllokuar. Gjykata ne vendimin e saj arsyeton se paditesja nuk vertetoi gjendjen ne to cilen ndodhet dhe demin qe i eshte shkaktuar. Ky arsyetim eshte i gabuar dhe ne kundershim me faktet, pasi kemi shpjeguar perpara Gjykates se me zbatimin e masave shtrenguese paditesja nuk mund to kryeje asnje veprimtari tregtare, pasi eshte e pamundur to zhvillohet nje veprimtari tregtare ne kushtet kur to gjitha llogarite bankare dhe asetet me to cilat e zhvillon kete veprimtari jane te bllokuara nga i padituri. Vete bllokimi i tyre verteton faktin qe paditesja ka gati nje vit qe nuk funksionin dhe nga mosfunksionimi i saj vijne te gjitha pasojat. Paditesja nuk ka se si te vertetonte perpara Gjykates mosveprimin e saj. Por kete fakt, gjykata mund te konfirmonte nepermjet pales se paditur, i cila administron te gjitha informacionin lidhur me kete shtate te paditeses. Pra i padituri ka dijeni te plote se nga paditesja nuk eshte zhvilluar asnje aktivitet tregtar gjate kesaj periudhe per rrjedhoje prane tij nuk eshte here asnje deklarim tatimor dhe asnje pagese si ne buxhetin e shtetit ashtu dhe per punonjesit, apo per to trete. Pra ka nje pezullim total te aktivitetit te shoqerise, e cila ka sjelle nje dem shume te madh dhe te pakthyeshem per to.

Nuk cenohet rende interesi publik: Nga pezullimi i zbatimit te aktit administrativ njoftim vleresimit tatimor nr.xxxxxx/14, date 31.12.2015 i DRTM, nuk cenohet asnje interes publik. Perkundrazi, marrja e kesaj mase do te evitoje nje faliment te shoqerise dhe shoqeria do te vazhdoj te derdhe ne buxhetin e shtetit detyrime tatimore, tatim fitimi, tvsh, si dhe ka nje perfitim edhe social pasi ne aktivitetin e saj tregtar, shoqeria ka te punesuar nje numer te konsiderueshem punonjesish per te cilet shoqeria derdh kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, duke ndihmuar edhe ne uljen e papunesise dhe rritjen e mireqenies ekonomike te popullsis. Buxhetit te Shtetit dhe politikave te tij nuk i intereson nje rritje papunesie, keshtu qe zhvillimi i aktivitetit te shoqerise nuk sjell asnje pasoje per shtetin, perkundrazi ajo sjell nje pasoje te madhe me efekt negativ per paditesin dhe per vete shtetin. Por ne fakt buxheti i shtetit eshte cenuar nga mosfunksionimi i shoqerise pasi te ardhurat e perfituara prej saj si per shkak te detyrimeve tatimore qe paguante shoqeria, ashtu edhe per ato te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore kane qene shume te medha dhe ne kohen qe ajo nuk ka funksionuar shteti nuk i ka vjelur dot keto te ardhura. Po keshtu eshte rritur numri i papunesise. Te gjitha punonjesit e shoqerise prej nje viti jane te papune.

Nga ana tjeter, kete detyrim te vleresuar, te cilen e konsiderojne te munguar ne buxhetin e shtetit, Shteti ne cdo rast ka mundesite ligjore per ta mbledhur, ne rast se ne perfundim te gjykimit akti do te rezultonte i drejte nga gjykata. Pra ekzistojne te gjitha mjetet ligjore qe detyrimi tatimor i vleresuar nga i padituri te mblidhet nga organi tatimor. Gjithashtu ekzistojne

mjetet ligjore edhe te shperblimit te demit te shkaktuar buxhetit te shtetit nga vonesa ne pagese e detyrimit tatimor, nepermjet llogaritjes se kamatvonesave ligjore.

Nga ana tjeter vendosja e pezullimit te zbatimit te aktit administrativ, objekt ankimi nuk sjell asnje zvarritje te procesit gjyqesor pasi vete natyra e procesit administrativ dhe vete ligji parashikon garte qe ato zhvillohen brenda nje kohe relativisht te shkurter.

Nese shihet e nevojshme nga gjykata, paditesi jep garanci ne llojin dhe masen e caktuar per demin qe mund t'i shkaktohet te paditurit nga sigurimi i padise. Lidhur me kete kerkese te dispozitave ligjore te ligjit nr.49/2012, paditesi ne cdo moment jep garanci ne llojin dhe masen qe do t'i caktohet per demin qe mund t'i shkaktohet pales se paditur. Garancia per ekzekutimin Jane asetet e shogerise te cilat kane nje vlere te konsiderueshme sikurse jane, te cilat ne cdo nuk eshte paguar dhe nuk eshte vene garanci bankare per detyrimin e plote tatimor te percaktuar ne njoftim vleresimin e animuar". Pala e paditur i ka kerkuar paditesit te beje pagesen e plote te detyrimeve me ane te shkreses se dates 15.02.2016 e nr.xxxxxx/17 prot., e ndjekur nga shkresa e dates 29.03.2016 e nr.385/6 prot me lende: "Njoftim per vendosje te barres siguruese" per shkak te mospermbushjes se detyrimit tatimor si dhe njoftim per vendosjen e barres hipotekore. Ky njoftim eshte ndjekur me tej nga njoftim i pergjithshem per vendosjen e barres siguruese dhe hipotekore te pales se paditur bere me dijeni paditesit me shkresen respektive te dates 08.04.2016 e nr.4805 prot. Pala e paditur ne respektim te ligjit, pikerisht marreveshjes se bashkepunimit mes DPT dhe DPD te dates 04.02.2015 "Mbi informimin reciprok per pezullimin e operatoreve ekonomike deri ne permbushjen e plote te detyrimeve ka kerkuar kesaj te fundit pezullimin e aktivitetit te subjektit "XXX"sha, per shkak se ndaj tij kane filluar procedurat per mbledhjen me force te detyrimeve tatimore te vetedeklaruara. Eshte bare kerkesa per vendosjen e mases se sigurimit te detyrimit tatimor me shkresen e dates 28.04.2016 e nr.xxx prot drejtuar QKB-se, urdhrin per bllokim te llogarive bankare me shkresen e dates 26.02.2016 e nr.vcvvcv prot.

Pala paditese i eshte drejtuar gjykates me padi me objekt konstatimi i pavlefshmerise absolute i njoftim vleresimit tatimor nr.xxxxxx/14, date 31.12.2015 i DRT Tatimpaguesve te Medhenj Tirane. Shfuqizimin e vendimit nr.2566/1 date 03.03.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor,duke kerkuar njeheresh marrjen e mases se sigurimit te padise: pezullimin e zbatimit te ketyre akteve administrative duke pretenduar se Vendimi i Drejtorise se Apelimit Tatimor nr.2566/1 date 03.03.2016 do ishte i justifikuar nese akti i cili ankimohej nuk do ishte absolutisht i pavlefshem. Drejtoria e Apelimit Tatimor duhej te merrte paraprakisht ne shqyrtim kerkesen dhe vetem pasi te sigurohej qe nuk ka te be me nje akt absolutisht te pavlefshem mund ta rrezonte ate per faktin se nuk ishte paguar vlere e plate e detyrimit tatimor. Ne kushtet kur paditesi nuk ka mundesi pagimin te ketij detyrimi te vleresuar dhe ne kushtet kur nga i padituri kerkohet mbledhja me force e ketij detyrimi, paditesi i drejtohet me kete kerkese gjykates per sigurimin e padise pezullimin e zbatimit te aktit administrativ (mbledhjen e detyrimit tatimor) deri ne perfundim te ketij gjykimi. Kerkimi per sigurimin e padise bazohet ne nenin 28 dhe 29 te ligjit nr.49/2012, pasi plotesohen kushtet e percaktuara ne kete ligj si me

poshte shpjeguar:

- Ekziston dyshimi i arsyeshem, i bazuar ne shkresa, per mundesine e shkaktimit te nje demi te rende, te pakthyeshem dhe te atecastshem per paditesin. Ajo cka eshte shume e rendesishme te theksojme eshte fakti se pala paditese eshte demtuar rende ne interesat e saj nga ky akt paligjshem, i nxjerre nga ana e paditur, pasi: Nese do shihet shumen e detyrimit tatimor te vleresuar te njoftim vleresimit tatimor nr.xxxxxx/14, date 31.12.2015 pa kamatevonesat, te cilat llogariten nga sistemi tatimor ajo eshte nje shume shume shume e madhe 16.115.047,964 leke jashte cdo kapaciteti ekonomik te nje shoqerie tregtare dhe jashte cdo mundesie reale per ta paguar ate. Nga zbatimi i masave shtrenguese te ndermarra nga i padituri per detyrimin tatimor te vleresuar, i cili eshte absolutisht i pavlefshem pasi eshte marre ne kapercim te kompetencave ligjore dhe pa u bazuar ne nje akt ligjor, paditesi eshte bllokuar total isht ne ushtimin e aktivitetit te tij tregtar dhe nuk do t'i ngelej asnje mundesi tjeter pervec falimentit te tij. Shpallja e falimentit nga ana e paditesit nuk do te mund te rikuperohej nga nje vendim i mevonshem qe mund te jete ne favor te paditesit. Me fillimin e ekzekutimit te detyrimit te percaktuar ne njoftim vleresimin objekt ankimi per paditesin eshte here shume e veshtire permbushja e detyrimeve te marra persiper si ne raport me klientet furnitoret, institucionet bankare ashtu edhe punetoret e shoqerise. Pra, mosmarrja e mases se sigurimit te padise do ta bente te pakuptimte procesin gjyqesor dhe do t'i sillte paditesit nje dem te pazevendesueshem. Nuk cenohet rende interesi publik: Nga pezullimi i zbatimit te aktit administrativ njoftim vleresimit tatimor nr.xxxxxx/14, date 31.12.2015 i DRTM, nuk cenohet asnje interes publik. Perkundrazi, marrja e kesaj mase do te evitoje nje faliment te shoqerise dhe shoqeria do te vazhdoje te derdhe ne buxhetin e shtetit detyrime tatimore, tatim fitimi, tvsh, si dhe ka nje perfitim edhe social pasi ne aktivitetin e saj tregtar, shoqeria ka te punesuar nje numer te konsiderueshem punonjesish per te cilet shoqeria derdh kontributet e sigurimeve shocierore dhe shendetesore, duke ndihmuar edhe ne uljen e papunesise dhe rritjen e mireqenies, ekonomike te popullsisë. Buxhetit te Shtetit dhe politikave te tij nuk i intereson nje rritje papunesie, keshtu qe zhvillimi i aktivitetit te shocierise nuk sjell asnje pasoje per shtetin, perkundrazi ajo sjell nje pasoje te madhe me efekt negativ per paditesin dhe per vete shtetin. Shteti ne cdo rast ka mundesite ligjore per ta mbledhur detyrimin ne rast se ne perfundim te gjykimit akti do te rezultonte i drejte nga gjykata. Pra, ekzistojne te gjitha mjetet ligjore qe detyrimi tatimor i vleresuar nga i padituri te mblidhet nga organ i tatimor. Gjithashtu, ekzistojne mjetet ligjore edhe te shperblimit te demit te shkaktuar buxhetit te shtetit nga vonesa ne pagese e detyrimit tatimor, nepermjet llogaritjes se kamatevonesave ligjore. Nga ana tjeter vendosja e pezullimit te zbatimit to aktit administrativ, objekt ankimi nuk sjell asnje zvarritje te procesit gjyqesor pasi vete natyra e procesit administrativ dhe vete ligji parashikon qarte qe ato zhvillohen brenda nje kohe relativisht te shkurter. Nese shihet e nevojshme nga gjykata, paditesi jep garanci ne llojin dhe masen e caktuar per demin, qe mund t'i shkaktohet te paditurit nga sigurimi i padise. Lidhur me kete kerkese te dispozitave ligjore te ligjit nr.49/2012, sqarojme gjykatën se paditesi, ne cdo moment jep garanci ne llojin dhe masen qe do ti caktohet per demin qe mund t'i shkaktohet pales se paditur. Garancia per ekzekutimin jane asetet e shoqerise te cilat kane nje vlere te konsiderueshme sikurse jane, te cilat ne cdo moment mund

te jen pjese e masave shtrenguese nepermjet vendosjes se barrave hipotekore ne zyrat e regjistrimit te pasurive te paluajtshme dhe sekuestros qe mund te vendose vete i padituri dhe vazhdimi te metejshe te procedurave najents se tyre ne ankand nga shitja e te cilave mund te mbledh detyrimin tatimor te vleresuar Palet e paditura (DRT Njesia e Tatimpaguesve te Medhenj dhe DAT) si dhe Avokatia e Shtetit kane prapesuar se nga ana e DRTTM-s jane respektuar te gjitha procedurat ligjore ne nxjerrjen e njoftim vleresimit tatimor. Kriter dhe kusht i domosdoshem qe Gjykata te pranoje masen e sigurimit te padise eshte moscenimi i rende i interesit publik nga nje mase e title sigurimi. Tatimet dhe taksat jane pjese e sistemit financiar te Shtetit. Buxheti i shtetit krijohet nga te ardhurat e mbledhura prej taksave, tatimeve dhe detyrimeve te tjera financiare, si dhe prej te ardhurave te tjera te ligjshme (neni 157 i Kushtetutes). Qellimi i sistemit tatimor eshte mireqenia e pergjithshme, qe do te thote e individeve dhe e komunitetit ne pergjithesi, si dhe permbushja e objektivave social te shtetit. Dispozitat e neneve 155 dhe 157 te Kushtetutes, te cilat konsolidojne sistemin buxhetor dhe percaktojne burimet e krijimit te ardhurave te buxhetit te shtetit, sanksionojne detyrimin kushtetues per te paguar detyrimet tatimore. Taksat dhe tatimet nuk jane detyrime te negociueshme dhe mblidhen nga organet tatimore, me menytrat e percaktuara me ligj. Marredheniet tatim-taksave jane marredhenie ligjore detyrimi ndermjet shtetit dhe tatimpaguesve dhe si te tilla ato mund te percaktohen vetem me ligj. Pezullimi do te thote pengim i administrates tatimore ne zbatimin e detyrave ligjore qe ligji i ka caktuar nderkohe qe paditesja ka te gjitha mundesite te ndjek rruget e duhura ligjore per te ankuar per ceshtjet e lidhura me te. Paditesi ne kerkesen e tij duhet te plotesoje edhe kushtin e trete, garancine ne llojin dhe masen e caktuar per demin qe mund t'i shkaktoliet shtetit nga sigurimi i padise, qe ne vetvete perben nje fare detyrimi per pagimin e detyrimit tatimor.

Paditesi edhe pse ka kerkuar sigurimin e padise nuk ka paraqitur asnje argument pse duhet te merret ajo bazuar ne nenin 29 te ligjit 49/2012, pra te vertetoj tre kushtet qe duhet te plotesohen qe kjo mase te merret nga gjykata. Nese organet shtetore jane ne zbatim te gabuar te ligjit, vete ligji ka parashikuar rrugen e ankimit administrativ. Nuk plotesohen kushtet e nenit 28 te ligjit 49/2012 per marrjen e mases per sigurim padie

II. Vleresimi i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane:

Gjykata ka rrezuar kerkesen me kete arsyetim ligjor: (gjykata ne arsyetimin e saj eshte bazuar ne nenin 28, 29 e 30 te ligjit 49/2012)

Se pari, nga pretendimet e parashtruara deri ne kete moment nga paditesi nuk provohet ekzistenca e kushteve te parashikuara ne nenin 29 te ligjit nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykateve administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative", per marrjen e nje mase sigurimi padie. Me konkretisht paditesi kerkoi si mase pezullimin e zbatimit te aktit administrativ NjoftimVleresimi per Detyrimet Tatimore nr. xxxxxx/14, date 31.12.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore te Tatimpaguesve te Medhenj. Nga shpjegimet e dhena dhe ne mungese te parashtrimit te provave, Gjykata pion se nuk ka nje haze te

mjaftueshme per te mbeshtetur dyshimet e paditeses, se asaj do ti vije nje dem i rende, i atecatshem e mbi te gjitha i pariparueshem. Keto tre kushte te demit jane kumulative dhe dyshimi per mundesine e ardhjes se ketij lloj demi duhet te bazohet ne prova me shkrese. Ne rastin konkret, pala paditese nuk paraqiti prova konkrete me shkrese mbi natyren e demit qe i shkaktohet dhe per me teper nuk provoi se behet fjale per dem te rende, te ateherastshem dhe mbi to gjitha te pariparueshem. Perfaqesuesit e pales paditese u shprehen ne gjykim se demi qe i shkaktohet shoqerise nga ekzekutimi i ketij akti eshte fakt i njohur boterisht. Nje argument i tille nuk qendron. Gjendja reale e shoqerise, demi qe i shkaktohet saj ne raport me punonjesit e saj dhe me te trete mund te provohet vetem nga ana e shoqerise dhe ne kuptim te ligjit vetem me prova me shkrese.

Se dyti, ne bindjen e gjykates, ndryshe nga sa pretendohet nga pala paditese marrja e nje mase te tille do te cenonte interesin publik. Pagimi i taksave dhe tatimeve eshte detyrim kushtetues dhe ligjor dhe mospagimi i tyre demton buxhetin e shtetit, duke ndikuar ne plotesimin e nevojave te publikut qe mbulohen nga ky buxhet.

Se treti, marrja e nje mase te tille do te paragjykonte gjykimin dhe vendimin perfundimtar qe do te jap gjykata ne lidhje me kerkimin tjeter objekt padie. Gjykata i referohet ne kete rast vendimit unifikuese nr.10, date 24.03.2004 te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte. Vlen te theksohet se nje nga argumentat e parashtruara nga paditesit ne mbeshtetje te kerkimit per marrjen e mases per pezullimin e zbatimit te aktit eshte se akti objekt gjykimi eshte nje akt absolutisht i pavlefshem dhe ai nuk duhet lejuar te prodhoje efekte juridike. Per sa kohe qe pavlefshmeria absolute e aktit eshte pretendim i themelit te ceshtjes, kundrejt te cilit palet e paditura kane te drejte te parashtrojne prapesime mbi themelin dhe bazueshmerine ne ligj dhe prova to tij, do te jete hetimi gjyqesor i plote dhe i gjithanshem i ceshtjes ne themel, perfshi ketu njohja dhe analizimi i pretendimeve, prapesimeve dhe provave te paleve ne proces, ne raport dhe me parashikimet ligjore, te cilat ne teresine e tyre do ta ndihmojne gjykatën ne arritjen e nje konkluzioni te sakte ne lidhje me vlefshmerine e aktit objekt gjykimi dhe rrjedhimisht bazueshmerine e pasojave te pretenduara nga paditesi. Pra, ne kete moment per Gjykatën eshte objektivisht e pamundur te vere kete pretendim ne teme te nje vendimmarrje per pezullimin e zbatimit te aktit objekt gjykimi. Kjo pasi, pavaresisht se objektiviteti e karakterizon dhe duhet ta karakterizoj Gjykatën ne cdo vendimmarrje te saj, ne cdo faze te procesit, ne rastin konkret ky qendrim eshte dhe ne funksion te shmangies te cdo lloj perceptimi sipas te cilit, Gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen ne themel te ceshtjes. Ne perfundim, duke pasur: parasysh gjithe sa me siper u citua, gjykata cmon se ky kerkimi i paditesit shoqeria eshte i pabazuar ne ligj dhe ne prova, e si i tille duhet refuzuar.

III. Vleresimi i Gjykates Administrative te Apelit:

Gjykata kryesisht konstatoi se ceshtja perben lende juridiksioni gjyqesor dhe se ajo ka kompetencen lendore dhe funksionale te gjykimit te saj bazuar ne nenet 7 dhe 10 te ligjit nr.49/2012 Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative i

ndryshuar dhe duke iu referuar per zbatim Vendimit Njehsues Administrativ te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Lane me nr.3, date 06 12 2013. Ne lidhje me kushtet e pranueshmerise se ankimit, sikurse ka vleresuar drejt edhe Gjykata Administrative e Shkalles se Pare, Gjykata e Apelit konstaton se ankimi eshte paraqitur konform kerkesave ligjore te neneve 44, 45 dhe 46 te ligjit nr. 49/2012 Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative, i ndryshuar brenda afatit ligjor, ne respektim te formes dhe permbajtjes se kerkuar nga neni 454 i Kodit te Procedures Civile, para gjykates kompetente, nga subjekti i legjitimuar ne te drejten e ankimit, jashte kushteve ndaluese te nenit 45 to ligjit nr.49/2012 (vendimet e paankimueshme).Ne analize te shkaqjeve te ngritura ne ankimin e pales paditese, Gjykata Administrative e Apelit vlereson se vendimi i gjykates administrative te shkalles se pare Tirane objekt ankimi eshte rrjedhoje e nje procesi te rregullt gjyqesor to zhvilluar ne respektim te dispozitave procedurale te zbatuara drejt ne raport me faktet objekt gjykimi dhe provat e marra ne shqyrtim gjyqesor dhe si i tille duhet lene ne fuqi per keto arsye:

Gjykatat veren se sipas nenit 155 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombetare e vendore, lehtesimi ose perjashtimi prej tyre i kategorive te caktuara te paguesve, si dhe menyra e mbledhjes se tyre caktohen me ligj. Ne referim te nenit 157 te Kushtetutes, buxheti i shtetit krijohet nga te ardhurat e mbledhura prej taksave, tatimeve dhe detyrimeve te tjera financiare, si dhe prej to ardhurave te tjera to ligjshme. Dispozitat e neneve 155 dhe 157 te Kushtetutes, te cilat konsolidojne sistemin buxhetor dhe percaktojne burimet e krijimit te te ardhurave te buxhetit te shtetit, sanksionojne detyrimin kushtetues per te paguar detyrimet tatimore. Qellimi i sistemit tatimor eshte mireqenia e pergjithshme, qe do te thote e individeve dhe e komunitetit ne pergjithesi, si dhe permbushja e objektivave sociale te shtetit. Prandaj taksat dhe tatimet nuk jane detyrime te negociueshme dhe mblidhen nga organet) nese shihet e nevojshme nga gjykata, paditesi jep garanci, ne llojin dhe masen e caktuar per demin, qe mund t'i shkaktohet te paditurit nga sigurimi i padise".Ne analize te ketyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit vlereson se masat e sigurimit te padise kane per qellim qe t'i lejojne gjykates administrative qe te ndermarre masat e nevojshme dhe qe jane te justifikuara me ekzistencen e nje suate emergjente, te ngutshme, me gellim parandalimin ardhjes ose parandalimin e rendimit te nje demi. Ajo eshte ne funksion te padise pasi siguron situaten faktike dhe juridike, e cila te mund te ndihmoje me pas zhvillimin e gjykimit si dhe mundeson eventualisht qe te mos demtohen interesat e asnjeres pale, derisa konflikti ne themel te zgjidhet duke garantuar zbatimin e vendimit te saj perfundimtar. Per keto arsye ligji kerkon qe ne vleresimin e rrethanave per mbajtjen e nje suate te ngrire te ekzistoje ne standard provueshmerie nga paditesi mundesia e shkaktimit te nje demi, i cili me qellim qe te justifikojte sipas parimit te proporcionalitetit gjendjen e ngrire te kerkuar, permes pezullimit te veprimit administrativ, duhet te deshmohet me shkresa se eshte i rende, i pakthyeshem dhe i atecastshem. Keto rrethana duhet te provohen pasi si te tilla ato reflektojne frymen dhe qellim e ligjit per pergjigjen e arsyeshme te nevojës se balancimit te asaj mase qe konsiderohet e presupozohet cenim i veprimit te autoritetit shteteror. Gjykata duhet te marre parasysh pasojat e mundshme te masave te perkohshme per te gjitha interesat qe ka te ngjare te cenohen dhe mund te vendose per te mos dhene masa te tilla edhe kur pasojat e tyre negative jane me te

medha se perfitimet, situatë e cila duhet të konsiderojë interesin publik. Në këtë drejtim ligji 49/2012 është i qartë se barren e proves e ka paditësi duke qenë se veprimtaria e administratës publike është shprehje e autoritetit të shtetit në arritjen e një interesi publik, realizimin e të mirës së përgjithshme. Në këtë kuptim, pala kerkuese duhet të provojë shkaqe serioze dhe dem serioz që është i vështirë të riparohet. Referuar rastit në gjykim, rezultoi se pala paditëse nuk i ka provuar gjykatës kushtet ligjore të marrjes së masë së sigurimit të padisë. Pala paditëse si në gjykimin shkallë të parë ashtu edhe në ankim nuk i ka argumentuar gjykatës se dem që mund t'i vijë është i pariparueshem. Perkundrazi nga marrja e kësaj masë cenohet interesi publik i mbrojtur dhe i garantuar me Kushtetutë dhe Ligj. Gjykata Administrative e Apelit nuk gjen shkaqe ligjore për të cenuar vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë dhe për këtë arsye bazuar në nenin 50, shkronja "b" të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative i ndryshuar, përfundimisht vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet lene në fuqi.

PER KETO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50, shkronja "b" e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", i ndryshuar

VENDOSI :

- Lenien në fuqi të vendimit datë 21.12.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Kunder këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve, afat që fillon nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit.

5.2. PAVLEFSHMËRI RELATIVE

5.2.1. ÇËSHTJE TË KONTROLLIT TATIMOR

5.2.1.1. Vendimi nr.1 datë 07.11.2017

PADITESE: Shoqëri a "XX sh.p.k, m administrator në NUIS XXXXXXXXXXXX me adresë rruga Tiranë perfaqësuar.

TE PADITUR : Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me...-Adresë; Rruga "Jordan Misja", Tiranë, Shqipëri, perfaqësuar në gjykim nga juristja Enekelida NAsi e pajisur me autorizimin nr. prot datë 27.06.2017 të leshuar nga Drejtori Rajonal. Drejtoria e Apelit Tatimor prapë Ministrisë së Financave perfaqësuar në gjykim nga juristja e DRT-Tiranë, sipas tagreve të autorizimit cielegues

urdehrit nr 45 date 19.05.2017 te Mlnistrit te Financave dhe autirizimit nr te leshuar nga Drejtori i Pergjithshem i Tatimeve.
Ne prani te Avokatures se Shtetit, perfaqesuar nga znj.

OBJEKTI Shfuqizimin e pjesshem te Njoftim vleresimit nr xxxx/3 prot date 30.08.2016 te Drejtorise RAjonale Tatimore Tirane.

Shfuqizimin e pjesshem te vendimit nr xxxx/1 prot date 09.05.2017 te Drejtorise se Apelimit TAtimore I cili ka lene ne fuqi njoftim vleresimin nr xxxx/3 prot date 30.08.2016 te Drejtorise RAjonale TAtimore Tirane, veprimin administrative RAport perfundimatr kontrolli me nr xxxx prot date 14.08.2015 dhe interest e gjobat e sistemit informatik tatimor te cilat kan engarkuar paditesin me :

- Detyrim pagese dale per periudhen 2014 detyrim 275 419 leke dhe gjobe 66 263 leke.
- Detyrim pagese TVSH per periudhen 2015 detyrim 139 539 leke dhe gjobe 69 770 leke.
- Detyrim pagese TVSH per periudhen 2016 detyrim 5 109 452 leke dhe gjobe 5 109 452 leke.
- Ulje humbje tatim fitimi per priudhen 2014 ne vleren 3 495 783 leke
- Ulje humbje tatim fitimi per periudhen 2015 ne vleren 697 697 leke.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te ceshtjes ne konkluzionet perfundimtare perfaqesuesit e paleve ndergjyqese pretenduan:

- Perfagesuesja e pales paditese shoqerise Shoqeria "XX " sh.p.k: Pranimin e kerkese — padise sipas objektit.
- Perfagesuesja e Avokatures se Shtetit znj xxx : Rrezimin e kerkese padise sit e pabazuar ne prova dhe ne ligj
- Gjykata pasi degjoi pretendimet e perfaqesuesve te paleve ndergjyqese, shqyrtoi provat shkresore qe,ndodhen ne dosje s'i dhe pasi e diskutoi ceshtjen ne teresi.

VEREN

Se pala paditese shoqeria "XX " sh.p.k rezulton qe me date 04.06.2015 t'i jete drejtuar me kerkese - padi Gjykates administrative te shkalles se pare Tirane, duke kerkuar : Shfuqizimin e pjesshem te vendimit nr xxxx/1 prot date 09.05.2017 te Drejtorise se Apelimit Tatimore I cili ka lene ne fuqi njoftim vleresimin nr xxxx/3 prot date 30.08.2016 te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane,veprimin administrative Raport perfundimatr kontrolli me nr xxxx prot date 14.08.2015 dhe interest e gjobat e sistemit informatik tatimor te cilat kane ngarkuar paditesin me :

- Detyrim pagese TVSH per periudhen 2014 detyrim 275 419 leke dhe gjobe 66 263 leke.
- Detyrim pagese TVSH per periudhen 2015 detyrim 139 539 leke dhe gjobe 69 770 leke.
- Detyrim pagese TVSH per periudhen 2016 detyrim 5 109 452 leke dhe gjobe 5 109 452 leke.
- Ulje humbje tatim fitimi per priudhen 2014 ne vleren 3 495 783 leke.
- Ulje humbje tatim fitimi per periudhen 2015 ne vleren 697 697 leke.

Gjykata, bazuar ne nenin 36 te Kodit te Procedures Civile, konstatoi kryesisht se kjo ceshtje ben pjese ne juridiksionin gjyqesor dhe bazuar ne nenet 7, 10/1 dhe 11/2 te ligjit nr. 49/ 2012 ' Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative',

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane eshte kompetente nga pikepamja lendore, funksionale dhe tokesore per shqyrtimin gjyqesor te saj.

Bazuar ne parashikimet e nenit 12/1 te ligjit nr. 49/ 2012 Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative ceshtja u more ne shqyrtim nga trup gjykues i perbere nga nje gjyqtar. Bazuar ne parashikimet e nenit 79/a te K.Pr.Civile, kerkese padia dhe aktet ju njoftuan dhe Avoktures se Shtetit Zyra Vendore Tirane, e cila u perpagesua ne kete gjykim nga znj

Perafqesuesja e pales paditese kerkoi ne baze te nenit 185 te k.pr.civile ndryshimin e objektit te padise duke kerkuar : Shfuqizimin e pjesshem te Njoftim vleresimit nr xxxx/3 prot date 30.08.2016 te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane. Shfuqizimin e pjesshem te vendimit nr xxxx/1 prot date 09.05.2017 te Drejtorise se Apelimit Tatimore i cili ka lene ne fuqi njoftim vleresimin nr xxxx/3 prot date 30.08.2016 te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane, veprimin administrative Raport perfundimatr kontrolli me nr xxxx prot date. 14.08.2015 dhe interest e gjobat e sistemit informatik tatimor te cilat kan engarkuar paditesin me :

- Detyrim pagese TVSH per periudhen 2014 detyrim 275 419 leke dhe gjobe 66 263 leke.
- Detyrim pagese TVSH per periudhen 2015 detyrim 139 539 leke dhe gjobe 69 770 leke.
- Detyrim pagese TVSH per periudhen 2016 detyrim 5 109 452 leke dhe gjobe 5 109 452 leke.
- Ulje humbje tatim fitimi per priudhen 2014 ne vleren 3 495 783 leke.
- Ulje humbje tatim fitimi per periudhen 2015 ne vleren 697 697 leke.

Gjykata pasi mori mendimin e perfaqesues se paleve te paditura dhe perfaqesueses se Avokatures se Shtetit vendosi te pranoje kerkesen e pales paditese per shtimin e objektit te padise pasi eshte e drejte e paditesit te disponoje mbi objektin e padise.Me pas gjykimi vazhdoi dhe u mbyll me objekt te percaktuar ne pjesen hyrese te ketij vendimi.

Rrethanat e faktit:

Shoqeria " "shpk, eshte e rregjistruar me NIPT xxxxxxxx me objekt te veprimtarise se saj ne fushen e tregtimit te karburanteve me pakice nepermjet administrimit te disa stacioneve karburanti te shperndara ne territorin e shqiperise.

Kjo shoqeri eshte ne juridiksion te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane, ka gene subjekt i nje kontrolli tatimor mbeshetur me objekt kontroll te vetedeklarimeve dhe llogaritjes e derdhjes se detyrimeve nga tatimpaguesi.Zbatimi i kerkesave te legjislacionit fiskal.

Ne perfundim te kontrollit nga ana e inspektoreve tatimore eshte pergatitur Raporti Kontrollit. Ne baze edhe te perfundimeve te dala nga raport kontrolli nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane eshte nxjerre Njoftim Vleresimi Per Detyrimet nr. xxxx/3 prot., date 30.08.2016.

Kunder Njoftim Vleresimit shoqeri a ka ushtruar ankim administrativ ne Drejtorine e Apelimit Tatimor e cila me vendimin nr. xxxx/1 prot., date 09.05.2017 ka vendosur : "Lenien ne fuqi te aktit administrativ njoftim vleresirnit nr. xxxx/3 prot., date 30.08.2016 per detyrimet

Duke mos gene dakord me njoftim vleresimin tatimor nr. xxxx/3 prot date 30.08.2016 dhe me vendimin e DAT, nr. xxxx/1 date 09.05.2017 te Drejtorise se Apelimit TAtimor prane Ministrise se Financave.

Pretendimet e paleve ndergjyqese:

Sipas pretendimeve te perfaqesueses e te pales paditese sh.p.k te parashtuara gjate gjykimit te ceshtjes, shkaqet per te cilat nga ana e gjykates duhet te vendosej pranimi kerkese padise dhe shfuqizimi i akteve objekt gjykimi ishin :

Persa I perket detyrimit pe rpagese TVSH per periudhen 2014 detyrim ne Shumen 275 410 leke dhe gjobe ne Shumen 66 263 leke. Ne njoftim vleresimi sipas raport kontrollit per kete vlere detyrimi jane bashkuar vlerat per konstatimin e dy shkeljeve vlere detyrimi prej 267 794 leke dhe vlere gjobe ne shumen 58 467 leke vlere detyrimi ne shumen 7 616 leke dhe gjobe ne Shumen 7 616 leke. Ne raport kontrolli kjo vlere detyrimi eshte vendosur pasi pretendohet se shkelja qe eshte konstatuar se subjekti ka kryer blerje komisioni nga shoqeria Yy sh.a per te cilen kryen shitie me pakice si agjent sherbimi. Ne vijim shprehemi se blerja e komisionit eshte ne kundersizim me piken 9.4 te udhezimit te Ministrise te Financave nr 17 date 13.05.2008 "PER TVSH" pasi pala paditese nuk ka vepruar si shites me pakice por ne te kundert ka vepruar si shites me shumice duke I shitur me shumice karburant shoqeri se YYsh.a.Per sa me siper shprehet ne kete pike raporti se subjekti ka kredituar TVSH ne kundersizim me ligjin nr 7923 date 27.04.1995 Per TVSH dhe ka llogaritur detyrim duke I shtuar dhe gjobe. Pala paditese ka vepruar si shites me shumice dhe ka kredituar TVSH ne pepruthje me ligjij. Ky konstatim eshte bere edhe nga vete inspektori ne raport kontroll.

Se dyti detyrimi ne Shumen 7 616 dhe gjobe ne Shumen 7616 leke eshte vendosur, se, eshte konstatuar, nje difference prek 38 079 leke te ardhura nga shitja, sipas bilancit dhe te ardhurave te deklaruar nga shitjet ne FDP.Kjo vlere I perket ndryshimeve ne inventar, pra ndryshimeve te deklaruar kontabilisht nga vete shoqeria.

Kjo vlere nenkupton qe nje sasi karburanti te kete rezultuar me teper ne krahasim me gjendjen kontabel te karburantit ne pika te ndryshme karburanti. Ne kete shtate eshte kryer nje sistemim nga ana e shoqerise duke qene se behej fjale per nje sasi ne disponim te saj me qellim rakordimin e sakte te sasive dhe jo me qellim fshehjen apo aq me teper shitjen pa fature sic eshte konsideruar pasi e kemi reflektuar ne bilanc.Per me teper ne rast se kjo sasi dhe vlere korresponduese do te duhej te fshihej ateher shoqeria nuk do ta reflektonte ne bilancin kontabel ashtu sic realisht ka vepruar. Pra ne ratsin konkret nuk permbushet elementi faj I kundravajtjes administrative ne zbatim te nenit 4 te ligjit nr 10279 date 20.05.2010 "Per kundravajtjen administrative".

Persa I takon detyrimit per pagese TVSH per periudhen 2015 rezulton se siaps raport kontrollit eshte verifikuar faturimi I komisioneve per furnizimet e kryar nga muaji maj 2014 deri me hyrjen ne fuqi

te ligjit nr 92/2014 Per TVSH" Verifikimi eshte kryer duke u bazuar ne ligjin nr 7923 date 27.04.1995. Sipas raport kontrollit pala paditese ka shitur karburant me cmime me te vogla se cmimet e blerjes nderkohe qe shitja duhej te kryhej me cmimin e blerjes te percaktuar nga shoqeria furnizuese sh.a perkatese. Referuar tabelas qe permban raport kontrolli vihet re se sasite dhe vlerat perkatese i perkasin veprimeve per sasi te furnizuara gjate janarit 2015. Ne kete rast eshte bere nje percaktim i gabuar i legjislacionit ne fuqi pasi duke u nisur nga janar 2015 ehste shfuqizuar udhezimi i Ministrit te financave nr 17 date 13.05.2008 "Per TVSH" I cili ne piken 9.4 parashikon pozicionin e shoqerive te pakices ne rolin e agentit te shoqerive te shumices dhe per pasoje cmimi I shitjes se karburantit perfundimtar percaktohej nga shiteist e shumices kundrejt pageses se nje komisioni ne favor te shitesit te pakices. Me hyrjen ne fyqi te udhezimit nr 6 date 30.01.2015 ne nenin 83 te tij parashikon se duke filluar nga data 1 janar 2015 e ka eliminuar totalisht konceptim e shoqerive te furnizimit me pakice te karburanteve ne rolin e agentit te shoqerive te shumices dhe pagesen e komisionit duke u bazuar ne fiksimin e cmimit perfundimtar te furnizuesit me shumice. Nga data 1 janar 2015 marredhenia midis shoqerise se shumices dhe asaj te pakices eshte nje marredhenie furnizues -klient dhe duke qene e tille nuk ekziston me kushtezimin e nje cmimi te fiksuar shitja nenvlere e te cilit do te konsiderohej shkelje.

Persa I perket detyrimit per pagese TVSH per priudhen 2016 detyrim ne Shumen 5 109 452 leke dhe gjobe ne Shumen 5 109 452 leke. Ne raport kontrolli kjo vlere detyrimi eshte bashkuar cka do te thote se jane bashkuar vlerat per konstatimin e dy shkeljeve vlere detyrimi prej 21 400 leke dhe gjobe 21 400 leke vlere detyrimi prej 5 088 052 leke dhe vlere gjobe 5 088 052 leke. Ne raport kontrolli vlere e detyrimit prej 21 400 leke dhe gjobe 21 400 leke eshte vendosur pasi eshte konstatuar nje difference materiale e karburantit prej 856 litra me cmim 125 leke. Keto diferenca jane konsideruar nga ana e inspektorit si shitje malli pa fature. Ne kete perfundim eshte arritur pasi jane verifikuar tre periudha :levizja e artikujve per periudhen 01.05.2014-31.12.2014 per te cilen inspektori shprehet se nuk ka diferenca materiale, levizja e artikujve per periudhen 01.01.2015-31.12.2015 per te cilen inspektori eshte shprehur se nuk ka diferenca materiale, levizja e artikujve per periudhen 01.01.2016-29.02.2016. Edhe pse eshte pretenduar se levizjet e materialeve te kontrolluara i perkasin periudhes janar -fund shkurti 2016 te dhenat ne table shtrihen per levizjet e materialeve per nje periudhe me shume se pese mujore. Per me teper qe inspektori ka kapercyer dhe afatet e akorduara per kryerjen e kontrollit tatimor ne lidhje me TVSH afati i akorduar per te cili kishte limit muajin janar 2016.

Ne lidhje me detyrimin e dyte rezulton se nje pjese e raport kontrollit reflekton nje situare te ndryshme ne dare paraqitet ne realitet. Ne raportit shprehet se verifikimi I kryer nga ana e kontrollit dhe nga deklarata e shoqerise date 7.05.2016 rezultoi se shoqeria nuk ka gjendje materialesh per agazinim nderkohe qe shoqeria ka gjendje ne inventarin kontabel te dates 31.12.2015 aktive afatgjata me vlerat perkatese. Ne momentin e kontrollit shoqeria ka pasur vetem 4 adresa sekondare ne te cilat kryente aktivitet dy adresa ne Elbasan nje ne Levan dhe nje ne Korce. Adresat e tjera tete ne numer jane mbyllur gjate viteve 2014-2016. Nderkohe ne nje stacion karburanti te ndodhur ne Plug Lushnje u nenshkrua kontrata me pronarin e ketij objekti I porositen dhe blene materiale te nevojshme per operimin e stacionit por kjo adrese nuk u hap asnjehere dhe shoqeria nuk kreu asnje dite aktivitet nsaj dhe nuk eshte kryer rregjistrimi ne QKR. Ne te gjitha keto stacione jane vendosur pompa kasa fiskale

materiela elektrike elektronike panele etj. te cilat ne momentin e nderprejes se aktivitet jane terhequr nga keto adresa dhe jane vendosur ne ruajtje ne ambiente te tjera pra jane magazinuar. Keto materiale jane magazinuar ne Shkozet Durres prane ambienteve te shoqerise Xxshpk ne nje hapësire disponimi te subjektit aaaa shpk ne baze te nje marreveshje te paleve. Keto materiale nuk jane hequr nga inventari pasi keto jane ne disponim te shoqerise dhe te tilla kane qene ne momentin e kryerjes se kontrollit e ne vijim.

Sa I takon detyrimeve te percaktuara ne nr 3 dhe 5 te Njoftim vleresimit keto jane te paligjshme dhe vlerat perkatese pasi keto detyrime vijne si pasoje e konstatimeve te gabuara ne raport kontroll te cilat shtojne fitimin e shoqerise bazuar ne detyrimet e tjera te percaktuara ne njoftim vleresim

Ne perfundim te sa me siper, pala paditese kerkoi para gjykates pranimin e padise, sipas objektit te saj. Sipas pretendimeve te parashtruara nga ana e perfaqesueses se pales se paditur Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane dhe perfaqesueses te Auokaiures se Shtetit kerkese - padia e paraqitur nga ana e pales paditese sh.p.k, duhet te rrezohet per arsye se:

Se pari: Nga inventari i kryer ne magazinat e shoqerise ka rezultuar nje difference inventari karburanti prej 856 litrash me cmim 125 leke dhe duke dhene nje detyrim per tvsh ne vleren 21.400 leke konsideruar si shitje malli pa fature.

Gjithashtu nga verifikimi i kryer nga ana e kontrollit dhe nga deklarata e shoqerise date 17.05.2016 kane rezultuar diferenca ne materjalet e tjera (Pervec karburantit) sa me poshte:

- Lende te para ne vleren 5.913.095 leke
- Vlera nga mallra per rishitje 1.516.817 leke
- Vlera e mbetur makineri e paisje 16.125.047 leke
- Ulje e vleres se mbetur te aktiveve afatgjata materjale 1.885.302 leke
- Keto diferenca konsiderohen shitje malli pa fature dhe bazuar ne ligjin 92/2014 "Per TVSH" neni 48 shoqerise i lind detyrimi per tvsh-ne ne vleren 5.088.052 leke ($25440261 \cdot 20\%$) si dhe bazuar ne ligjin 9920/2008 neni 124 shoqeria denohet me gjobe 100% te detyrimit ne vleren 5.109.452 leke ($21.400 + 5.088.052$).

Lidhur me sa shoqeria kundërshton vleresimin e kryer sqarojme se: Nga kontrolli ne shoqeri ka rezultuar diferenca inventari te cilat jane te vleresushme bazuar ne Ligjin nr. 9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", neni 68, pika 4 dhe 5, ku citojme "4. Nese administrata tatimore ueren se detyrimi tatimor, i dhene ne deklaraten tatimore, eshte i pasakte ose tatimpaguesi nuk lea dorezuar deklarate tatimore apo nuk lea paguar detyrimin tatimor, administrata tatimore ben oleresimin tatimor. 5. Administrata tatimore olereson detyrimin tatimor te tatimpaguesit, ne perputhje me dispozitat e legjislacionit perkates. Vleresimi bazohet ne:

- a) informacionin, qe permban deklaraten tatimore e tatimpaguesit;
- b) rezultate e nje kontrolli, ne perputhje me kreun X te ketij ligji;
- c) menurat alternative te vleresimit, te parashikuara ne nenin 72 te ketij ligji".

Vleresimi tatirnor i kryer mbeshtetet ne "Raport Kontrollin" e mbajtur me date 29.08.2016. Mungesa e mallrave gjate kryerjes se bilancit material ose inventarizirnit te tyre, konsiderohet si shitje pa leshuar faturen tatirnore, per te cilat kryhen vleresirnet tatirnore dhe aplikohet denimi i percaktuar ne Ligjin nr. 9920, dt. 19.05.2008 "Per Procedurat Tatirnore ne RSH", neni 124, ku citojme mosleshimi i faturave tatimore apo i fatures tatimore me TVSH denohet me gjobe te burabarte me 100 per qind i detyrimit tatimor, te padeklaruar ose te papaguar, si rezultat i mosleshimit ie fatures, pervec detyrimeve tatimore dhe interesave, qe llogariten dhe paguhen ne perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe te ligjeve specifike tatimore”.

Paditesi pretendon por nuk ka nje kundershiti mbi baza dokumentare dhe as arsyetuese, por kundershiti konsiston ne pretendimin se materjalet jane gjendje ne magazinat e nje shoqerie mete cilat ka pasur nje akt marrveshje.

Por shoqeria ka leshuar me pare nje deklarate date 17.05.2016 ne te cilen shprehet se "...ne pikat e shitjes se kompanise (Niptet sekondare) pervec depozitave qe mbajne karburant per shitje nuk ka materjale te tjera per magazinim".

Pretendimi shoqerise per gjendje te ketyre mallrave e materjaleve ne ambiente te cilat nuk jane me NIPT sekondar, nuk jane deklaruar ne intervisten e dhene me fillimin e kontrollit tatimor, dhe me te drejte inspektori tatimor i ka quajtur shitje pa leshuar fature, vleresim qe eshte lene ne fuqi nga Drejtoria Apelimt Tatimor per detyrimin 5.109.452 leke e gjoba 5.109.452 leke.

Se dyti : lidhur me blerje komisioni nga shoqeria xxx pasi shoqeria abcd ka shitur sasi karburanti me cmim perfundimtar ne vleren e tatushme 1.338.970 leke dhe tvsh 267.794 leke ne kundershiti me udhezimin nr 17 date 13.05.2008 pika 9.4 pasi shoqeria sha kryen shitje me shumice shoqerise "xxx" dhe kjo shoqeri operon si agjent sherbimi duke kryer sherbim per sha si shites me pakice dhe jo e kunderta qe shoqeria "xxx" ti shese sh.a. me shumice.

Nuk qendron kundershiti i shoqerise pasi bazuar ne Udhezimin nr 17 date 13.08.2008 "Per TVSH" ku eshte percaktuar se:

b) Detyrim te paleve

Midis agentit dhe kryesorit duhet te ekzistojte nje marreveshje e lidhur me faktin e realizimit te furnizimit.

Konkretisht kerkohet qe:

Te jete e percaktuar qarte roli i agentit, ne menyre qe te kuptohet qe agjenti po kryen nje

Furnizim te sherbimit per llogari te kryesorit dhe jo per llogari te veprimtarise se tij ekonomike;

te jete percaktuar qarte qe agjenti nuk eshte ekonomikisht zoieruesi i mallit, per rastin konkret kurburuntit, te cilin e ka furnizuar per llogari te kryesorit;

agjenti nuk mund te furnizojte ne nje vendndodhje biznesi, mallra te se njejtës nature(p.sh.karburant te llojit DI) te furnizuar nga kryesore te ndryshem;

- te jete percaktuar qarte qe agjenti nuk mund te ndryshojte cmimin e furnizimit te mallit qe i eshte faturuar prej kryesorit;

- konsiderohei shkelje cdo ndryshim nga agjenti i cmimit fillestar me pakice te faiuruar nga kryesori. Pervec pletesimit te detyrimit tatimor, zbatohet edhe gjobe sipas nenit 116 te ligjit nr.9920, date 19.5.2008 "Per procedurai tatimore ne Republiken e Shqiperise". Shoqeria nuk ka vepruar ne perputhje me kete Udhezim sa me siper vleresimi i kryer eshte i sakte dhe i mbeshetur ne ligj.

Se treti: Nga kontrolli ka rezultuar diferenca prej 38.079 leke vlere inventari te cilat shoqeria i ka deklaruar si te ardhura por nuk ka leshuar fature tatimore. Bazuar ne Ligjin 7938/1995 "Per TVSH-ne" i ndryshuar neni 30 ndryshuar me ligjin 92/2014 shcqerise i ka lindur detyrimi per TVSH ne vleren 7616 leke. $(38079 \times 20\%)$, dhe ne mbeshetjet e ligjit 9920/2008 neni 124 eshte denuar me gjobe 100% ose 7.616 leke.

Lidhur mesa kundershkon shoqeria sqarojme se: se mungesa e mallrave gjate kryerjes se bilancit material ose inventarizimit te tyre, konsiderohet si shitje pa leshuar faturen tatimore, per te cilat kryhen vleresimet tatimore dhe aplikohet denimi i percaktuar ne Ligjin nr. 9920, dt. 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", neni 124, ku citojme "mosleshimi i faiures tatimore apo i faiures tatimore me TVSH denohei me gjobe ie barabarte me 100 per qind te detyrimit tatimor, te padeklaruar ose ie papaguar, si rezuliai i mosleshimit te fatures, pervec detyrimeve tatimore dhe interesave, qe llogariten dhe paguhen ne perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe te ligjeve specifike tatimore".

Per sa me siper detyrimi per tvsh ne vleren 7.616 leke dhe gjobe ne vleren 7.616 leke eshte i drejte e i mbeshetur ne ligj.

Se katerti sqarojme se me hyrjen ne fuqi te ligjit 92/2014 "Per TVSH-ne" ka rezultuar se gjendja ne vlere e faturuar me komision ne 31.01.2015 ka qene 12.036.806 leke dhe sasi 84.842 litra dhe kjo sasi duhej te shitej me cmimin e blerjes se percaktuar nga shoqeria sh.a. Por shoqeria i ka shitur me cmime me te vogla duke reflektuar nje difference ne shitje mete vogel ne vleren 697.697 leke. Bazuar ne ligjin 92/2014 "Per TVSH-ne" neni 9, 38, 39 dhe 48 shoqerise i lind detyrim per tvsh ne vleren 139.539 leke $(697.697 \times 20\%)$ dhe ne zbatim te Ligjit nr 9920/2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.SH" neni 128 dhe Udhezimit nr 24 ne zbatim te tij shoqeria denohet me 50% te detyrimit ose 69.770 leke $(139539 \times 50\%)$.

Nuk qendrojne pretendimet e shoqerise pasi: Shoqeria per sasite e blera gjate kohes qe ishte ne fuqi Udhezimi nr 17/2008 "Per TVSH-ne" dhe te cilat ishin gjendje nemomentin e hyrjes ne fuqi te Udhezimit nr 6/2014 duhej te shiten me cmimet e percaktuar ne faturen e blerjes. Kjo pasi per kete sasi shoqeria ka kredituar TVSH ne blerje me cmim table dhe me kctecmim duhej shitur.

Sa me siper vleresimi i kryer nga administrata tatimore eshte i drejte e i mbeshetur ne ligj e ne prova. Bazuar ne argumentat e mesiper nga ana e perfaqesueses se pales se paditur dhe perfaqesueses se avokatures se Shtetit u kerkua rrezimi I kerkese padise

Vleresimi i Gjykates

GJYKATA, ne analize te pretendimeve dhe prapesimeve, provave te paraqituranga pala paditese, ligjit material dhe procedural, cmon se padia e shoqerise paditese ""sh.p.k eshte e bazuar ne ligj e prova dhe arsyeton si me poshte vijon:

Se pari: Nga inventari i kryer ne magazinat e shoqerise ka rezultuar nje difference inventari karburanti prej 856 litrash me crnim 125 leke dhe duke dhene nje detyrim per tvsh ne vleren 21.400 leke konsideruar si shitje malli pa fature.

Gjithashtu nga verifikimi i kryer nga ana e kontrollit dhe nga deklarata e shoqerise date 17.05.2016 kane rezultuar diferenca ne materjalet e tjera (Pervec karburantit) sa me poshte:

Lende te para ne vleren	5.913.095 leke.
Vlera nga mallra per rishitje	1.516.817 leke
Vlera e mbetur makineri e paisje	16.125.047 leke
Ulje e vleres se mbetur te aktiveve afatgjata materjale	1.885.302 leke

Cdo gjendje kontabile e mallrave dhe pajisjeve duhet te dokumentohet edhe me gjendjen fizike te tyre ne ambientet perkatese te deklaruarat prej subjektit, per cdo kontroll, ruajtje dhe administrim te tyre. Cdo difference fizike me kontabile te aktiveve te shoqerise, ne cdo moment kontrolli fizik te tyre nga ana kontabile duhet te sistemohet sipas gjendjeve fizike te tyre, por nga ana fiskale konsiderohet shitje pa fature tatimore.

Gjykata cmon se keto diferenca konsiderohen shitje malli pa fature dhe bazuar ne ligjin 92/2014 "Per TVSH" neni 48, shoqerise i lind detyrimi per tvsh-ne ne vleren 5.088.052 leke ($25440261 \cdot 20\%$) si dhe bazuar ne ligjin 9920/2008 neni 124 shoqeria denohet me gjobe 100% te detyrimit ne vleren 5.109.452 leke ($2 \cdot 1.400 + 5.088.052$).

Lidhur me sa shoqeria kundershton vleresimin e kryer gjykata cmon se : Nga kontrolli ne shoqeri ka rezultuar diferenca inventari te cilat jane te vleresushme bazuar ne Ligjin nr. 9920, date 19.05:2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", neni 68, pika 4 dhe 5, te cilet parashikojne "4. Nese administrata tatimore veren se detyrimi tatimor, i dhene ne deklaraten tatimore, eshte i pasakte ose tatimpaguesi nuk ka dorezuar deklarate tatimore apo nuk ka paguar detyrimin tatimor, administrata tatimore ben vleresimin tatimor.

5. Administrata tatimore vlereson detyrimin tatimor te tatimpaguesit, ne perputhje me dispozitat e legjislacionit perkates. Vleresimi bazohet ne:

- a) informacionin, qe permban deklarata tatimore e tatimpaguesit;
- b) rezultatet e nje kontrolli, ne perputhje me kreun X te ketij ligji;
- c) menytrat alternative te vleresimit, te parashikuara ne nenin 72 te ketij ligji ".

Vleresimi tatimor i kryer mbeshetet ne "Raport Kontrollin" e mbajtur me date 29.08.2016. Mungesa e mallrave gjate kryerjes se bilancit material ose inventarizimit te tyre, konsiderohet si shitje pa

leshuar faturen tatimore, per te cilat kryhen vleresimet tatimore dhe aplikohet denimi i percaktuar ne Ligjin nr. 9920, dt. 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", neni 124, ku citojme "Mosleshimi ifatures tatimore apo ifatures tatimore me TVSH denohet me gjobe te barabarte me 100 per qind te detyrimit tatimor, te padekluar ose te papaguar, si rezultat i mosleshimit te fatures, pervec detyrimeve tatimore dhe interesave, qe llogariten dhe paguhen ne perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe te ligjeve specifike tatimore".

Paditesi pretendon, por, nuk ka nje kundersiztim mbi baza dokumentare dhe as arsyetuese, por kundersiztimi konsiston ne pretendimin se, materialet jane gjendje ne magazinat e nje shoqerie me te cilat ka pasur nje akt marrveshje. Por shoqeria ka leshuar me pare nje deklarate date 17.05.2016 ne te cilen shprehet se".. ne pikat e shitjes se kompanise (Niptet sekondare) pervec depozitave qe mbajne karburant per shitje nuk ka materjale te tjera per magazinim". Pretendimi shoqerise per gjendje te ketyre mallrave e materjaleve ne ambjente te cilat nuk jane me NIPT sekondar, nuk jane deklaruar ne intervisten e dhene me fillimin e kontrollit tatimor, dhe me te drejte inspektori tatimor i ka quajtur shitje pa leshuar fature tatimore, vleresim qe eshte lene ne fuqi nga Drejtoria Apelimat Tatimor per detyrimin 5.109.452 leke e gjoba 5.109.452 leke.

e dyti : lidhur me blerje komisioni nga shoqeria A.K. Trade Internacional pasi shoqeria Unified Secure Standarts Albania ka shitur sasi karburanti me cmim perfundimtar ne vleren e tatushme 1.338.970 leke dhe tvsh 267.794 leke ne kundersiztim me udhezimin nr 17 date 13. 05. 2008 pika 9. 4 pasi shoqeria sha kryen shitje me shumice shoqerise "" dhe kjo shoqeri operon si agjent sherbimi duke kryer sherbim per sha si shites me pakice dhe jo e kunderta qe shoqeria "Unified Secure Standarts Albania" ti shese sh.a. me shumice.

Nuk qendron kundersiztimi i shoqerise pasi : bazuar ne Udhezimin nr 17 date 13.08.2008 "Per TVSH" ku eshte percaktuar se:

b) Detyrime te paleve.

Midis agjentit dhe kryesorit duhet te ekzistojte nje marreveshje lidhur me faktin e realizimit te furnizimit.

Konkretisht kerkohet qe:

- te jete e percaktuar qarte roli i agjentit, ne menyre qe te kuptohet qe agjenti po kryen nje furnizim te sherbimit per llogari te kryesorit dhe Jo per llogari te veprimtarise se ti} ekonomike;
- te jete percaktuar qarte qe agjenti nuk eshte ekonomikisht zoteruesi i mallit, per rastin konkret
- karburantit, te cilin e ka furnizuar per llogari te kryesorit;
- agjenti nuk mund te furnizojte ne nje vendndodhje biznesi, mallra te se njejtes natyre
- (p.sh. karburant te llojit D)1) te furnizuar nga kryesore te ndryshem;
- te jete percaktuar qarte qe agjenti nuk mund te ndryshojte cmimin e furnizimit te mallit qe i eshte faturuar pre} kryesorit;
- konsiderohet shkelje cdo ndryshim nga agjenti i cmimit jillestar me pakice te faturuar nga kryesori.

Pervec vleresimit te detyrimit tatimor, zbatohet edhe gjobe sipas nenit 116 te ligjit nr.9920, date 19.5.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise".

“...9.4. Furnizimi i karburanteve

a) Regjimi fiskal

Importuesit e prodhuesit vendas te karburanteve (shoqeri anonime) Jane furnizues te nivelit te pare dhe furnizojne me shumice klientet e tyre (shoqerite me pergjegjesi te kufizuar), le cilet me pas.furnizojne me te njejtin mall klientet, qe normalisht Jane konsumatore finale...”

Fatura e leshuar nga kryesori per llogari te agentit te tij permban te gjitha te dhenat qe duhet te permbaje nje fature tatimore sipas nenit 36 te ligjit. Cmimi i vendosur ne te, eshte ai i shitjes me pakice dhe mbi vleren e tatueshme te cdo furnizimi, aplikohet TVSH ne shkallen tatimore 20%. Ajo deklarohet si TVSH e mbledhshme nga personi qe luan rolin e kryesorit dhe konsiderohet si TVSH e zbritshme per bleresin brenda percaktimeve le nenit 33 le ligjit.

Nga ana tjeter per kete ndermjetesim qe kryhet per llogari te kryesorit, agjenti i faturon atij nje situme qi! konsiderohet si vlere e tatueshme e keti] sherbimi (ndryshe komision), e barabarte me vleren e nderhyrjes se tij ni! treg. Mbi ti! zbatohet shkalla tatimore e TVSH-si! prej 20%, e ci/a deklarohet si TVSH e mbledhshme nga agjenti. Njekohesisht kjo shume konsiderohet si TVSH e zbritshme per personin kryesor, si dhe esht« e kreditueshme pre) tij brenda percaktimeve te nenit 33 te ligjit.

Shoqeria nuk ka vepruar ne perputhje me kete Udhezim, pra eshte shoqeria paditese ajo qe duhet te fatureje komisione dhe TVSH perkatese te tyre per AK Trade Intern sha qe eshte kryesori, dhe jo e kunderta sic ka ndodhur, sa me siper vleresimi i kryer eshte i sakte dhe i mbeshtetur ne ligj. Blerjet e sipercituara te shoqerise te komisioneve nga shumica, I perkasin periudhes Maj - dhjetor 2014 fq 7 e Raportit te kontrollit dhe jo ndryshimeve te ligjit ne janar 2015, sa pretendohet nga paditesi.

Se treti: Nga kontrolli ka rezultuar diferenca prej 38.079 leke vlere inventari te cilat shoqeria i ka deklaruar si te ardhura por nuk ka leshuar fature tatimore. Bazuar ne Ligjin 7938/1995 "Per TVSH-ne" i ndryshuar neni 30 ndryshuar me ligjin 92/2014 shoqerise i ka lindur detyrimi per TVSH ne vleren 7616 leke. $(38079 \times 20\%)$, dhe ne mbeshtetje te ligjit 9920/2008 neni 124 eshte denuar me gjobe 100% ose 7.616 leke.

Gjykata cmon se: shoqeria, nje sasi karburanti te rezultuar me teper ne krahasim me gjendjen kontabel te karburantit ne pika te ndryshme karburanti ka kryer nje sistemim nga ana e saj, duke qene se behej fjale per nje sasi ne disponim te saj me qellim rakordimin e sakte te sasive,sa deklaruar sipas Pasqyres Financiare te te te Ardhurave dhe shpenzimeve, viti 2014, fq 24 e Rap kontrollit, pra shoqeria,ka vetdeklaruar ne te Ardhura sipas Bilancit i Ndryshimet ne inventar ne vleren perkatese 38. 079 leke, kete vlere inventari, per rrjedhoje eshte tatuar per kete te ardhur si tatim fitimi sipas PF 2014, por nuk ka kryer deklarime te TVSH perkatese per kete vlere inventari. Paditesi nuk provoi me dokumenta perkatese, qe kjo vlere te ardhurash te jete vetdeklaruar ne librat e shitjes se shoqerise I Formulari Pageses se TVSH ne periudhen perkatese, per rrjedhoje detyrimi per tvsh ne vleren 7.616 leke dhe gjobe ne vleren 7.616 leke eshte i drejte e i mbeshtetur ne ligj.

Se katerti: Gjykata cmon se me hyrjen ne fuqi te ligjit 92/2014 "Per TVSH-ne" ka rezultuar se gjendja ne vlere e faturuar me komision ne 31.01.2015 ka qene 12.036.806 leke dhe sasi 84.842 litra dhe kjo sasi duhej te shitej me cmirnin e blerjes se percaktuar nga shoqeria sh.a. Por shoqeria i ka shitur me cmime mete vogla duke reflektuar nje difference ne shitje mete vogel ne vleren 697.697 leke. Bazuar ne ligjin 92/2014 "Per TVSH-ne" neni 9, 38, 39 dhe 48 te tij shoqerise i lind detyrim per tvsh ne vleren 139.539 leke ($697.697 \cdot 20\%$). Ne zbatim te Ligjit nr 9920/2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.SH" neni 128 dhe Udhhezimit nr. 24 ne zbatim te tij shoqeria denohet me 50% te detyrimit ose 69.770 leke ($139.539 \cdot 50\%$).

Nuk qendrojne pretendimet e Paditesit pasi: Shoqeria per sasite e blera gjate kohes qe ishte ne fuqi Udhhezimi nr 17/2008 "Per TVSH-ne" pika 9.4 e tij.... b) Detyrime te paleve. Midis agentit dhe kryesorit duhet te ekzistojte nje marreveshje lidhur me faktin e realizimit te furnizimit.

Konkretisht kerkohet qe:

- te jete e percaktuar qarte roli i agentit, ne menyre qe te kuptohet qe agjenti po kryen nje furnizim te sherbimit per llogari te kryesorit dhe Jo per llogari te veprimtarise se tij ekonomike;
- te jete percaktuar qarte qe agjenti nuk eshte ekonomikisht zoteruesi i mallit, per rastin konkret
- karburantit, te cilin e ka furnizuar per llogari te kryesorit;
- agjenti nuk mund te furnizojte ne nje vendndodhje biznesi, mallra te se njejtës natyre
- (p.sh. karburant te llojit D1) te furnizuar nga kryesore te ndryshem;
- te jete percaktuar qarte qe agjenti nuk mund te ndryshojte cmimin e furnizimit te mallit qe i eshte faturuar prej kryesorit;
- konsiderohet shkelje cdo ndryshim nga agjenti i cmimit jillestar me pakice te faturuar nga kryesori.

Ne faqe 14 Raportit te kontrolli furnizimi i karburanteve u verifikua, faturimi i komisioneve te sherbimeve per te gjitha furnizimet e karburanteve te kryera per periudhen Maj 2014 deri ne ltyrjen ne fuqi te ligjit nr 92/2014 "per TVSH ne RSH"... pra ne janar 2015, kjo sasi malli e furnizuar nga kryesori, ka qene gjendje ne momentin e hyrjes ne fuqi te Udhhezimit nr 6/2014 kur kane ndodhur ndryshimet ligjore, per rrjedhoje, duhej te shitej me cmimet e blerjes se percaktuar nga shoqeria SHA I kryesori, por shoqeria e ka shitur me cmim mete ulet se cmimi blerjes sipas tabelës faqe 14 Rap Kontrolli. Kjo pasi, per kete sasi, shoqeria ka kredituar TVSH ne blerje me cmim blerje, dhe me kete cmirn duhej shitur, me qellim tvsh ne shitje te pakten te jete e njejte me Tvsh ne blerje.

Sa me siper vleresimi i kryer nga administrata tatimore eshte i drejte e i mbeshtetur ne ligj e ne prova. Ne perfundim e analize te sa me siper trajtuar, Gjykata cmon se kerkimet e pales paditese gjenden te pabazuara ne ligj e prova, ndaj dhe vendos te rrezojte padine e shoqerise "Inofies Secure Standart Albania shpk si te pabazuar ne prova e ne ligj dhe vlereson se aktet objekt gjykirni, njoftim vleresimi tatirnor dhe vendirni i Drejtorise se Apelirnit per pjesen e kontestuar ne gjykate duhet te lihen ne fuqi, si te drejta dhe mbeshtetura ne ligj e prova.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne zbatim te nenit 40 te ligjit nr 49/2012 "per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", ne zbatim te neneve 68 pikat 4, 5, te ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise". ne zbatim te nenit 18 pikat 3 dhe 4 te ligjit nr. 7928, date 27.04.1995 "Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar", si dhe ne zbatim te pikes 7.2 te Udhezimit te Ministrit te Financave nr. 17, date 13.05.2008 "Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar".

PER KETO ARSYE :

Bazuar ne nenet 40, 41 dhe 65 te ligjit nr. 49/ 2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative".

VENDOSI

- Rrezirnin e kerkese padise se pales paditese shoqeria "" shpk
- Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales paditese.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankimi ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane brenda 15 diteve nga dita e nerserme e shpalljes se vendimit.Per palet ne mungese ky afat fillon nga e neserme e komunikimit te vendimit.
- U shpall sot ne Tirane me date 07.11.2017

.....

5.2.2. ÇËSHTJE TË HETIMIT TATIMOR

5.2.2.1. Vendimi nr.2, "Për mosdeklarim punonjësish"

PADITESE: Shoqeria me adrese Lagjia Gjirokaster, me numer unik identifikimi

TE PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokaster.
Drejtoria e Apelit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme teTatimeve.

OBJEKTI Shfuqizimin (Anullimin) e aktit administrativ, Njoftim Vleresimi Tatimor nr. Drejtorise Rajonale Tatimore, Gjirokaster. Shfuqizimin (Anullimin) e aktit administrativ, Vendim Drejtorise se Apelit Tatimor nr.. Rregullimin e pasojave juridike, kthimin e paleve ne gjendjen e meparshme, pagimin e shpenzimeve gjyqesore dhe avokatore.

BAZA LIGJORE: K.Pr.Civile nenet 31 e vijues, 154 e vijues, K.Pr.A nenet 115 e vijues, Ligji nr. 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", Udhezimi nr. 24 date 02.09.2008 i ndryshuar "Perprocedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise".

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare me vendimin, ka vendosur:
Pranimin e kerkese padise.

Shfuqizimin e aktit administrativ, "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" per te Drejtorise

Rajonale Tatimore Gjirokaster lene ne fuqi me Vendim date 02.04.2015 te Drejtorise Apelimit Tatimor.

Rregullimin e pasojave juridike, kthimin e paleve ne gjendjen e meparshme. Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen te pales se paditur DRT Gjirokaster.

Kunder vendimit lejohet ankim brenda 15 diteve ne Gjykaten Administrative te Apelit Tirane

Kunder vendimit, te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare, kane paraqitur ankim pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokaster, qe kerkon ndryshimin e vendimit dhe rrezimin e kerkese padise, duke parashtuar keto shkaqe:

Ka pranuar dhe shlyrtuar nje kerkese padi te pabazuar ne ligj dhe ne prova duke pretenduar se gjykata ka zbatuar keq dispozitat ligjore ne dhenien e ketij vendimi. Kerkesepadia bie ndesh me dispozitat ligjore ne fuqi, ndaj dhe gjykata duhet te vendose rrezimin e kerkesepadise ne teresi si te pabazuar ne ligj dhe prova. Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Gjirokaster nuk mori parasysh se paditesi ne kerkesepadine e tij, nuk citon asnje baze ligjore te Ligjit me Nr. 49/2012, me te cilin kerkohet qe Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Gjirokaster, te inicioje dhe te gjykoje kete ceshtje administrative.

Me shkresen Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore, Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokaster, ka njoftuar paditesin, per detyrimet qe i kane lindur ndaj administrates tatimore si rezultat i penalizimit me gjobe ne shumen 500.000 leke per mosdeklarim punonjesi. Kjo shkrese i eshte komunikuar tatimpaguesit per tu njohur me kete detyrim, sipas procedures ligjore perkatese te neneve 32, 69 e ne vijim te Ligjit nr. 9920 date "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, duke i parashtruar ne te edhe te drejten e ankimit ndaj saj. Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr. Prot. date 18.12.2014, eshte nje akt administrative i hartuar, ne zbatim te Akt Konstatimit me nr, akt qe ka rezultuar nga kontrolli i ushtruar nga grupi i inspektoreve te Sektorit te Verifikimit ne Terren, ne Drejtorine e Kontrollit Tatimor prane Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane. Ne daten 18.07.2014, ne Tirane ne zbatim te Urdherit te Punes me nr.date 18.07.2014, grupi i kontrollit i perbere nga kater inspektore te Sektorit te Verifikimit ne Terren, ka ushtruar kontroll ne automjetin me targa qe drejtohej nga z. me mjet identifikimi patente. Grupi i kontrollit te Sektorit te Verifikimit ne Terren, ka mbajtur ne vend Akt Konstatimin me nr. Date 18.07.2014, per ndjekje te metejshme. Ky kontroll eshte ushtruar ne zbatim te ligjit dhe konkretisht, pika 80.3, germa c) e Udhezimit te Ministrit te Financave me nr.24 date 02.09.2008. Pra procedura e ndjekur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane ne kryerjen e ketij kontrolli, eshte bere ne perputhje me ligjin dbe aktet nenligjore ne fuqi e ne asnje moment, nuk kemi shkelje te ligjit si arsyeton Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Gjirokaster,ne vendimin e saj.

Sipas procedures per ndjekje te metejshme Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane, ka percjelle shkreserisht Akt Konstatimin me nr. date 18.07.2014, prane Drejtorise Rajonale Tatimore Gjirokaster ne menyre qe nga Drejtoria e Vleresimit te te Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit ketu, te kryheshin verifikimet e metejshme ne listepagesat e deklaruar nga vete subjekti. Pas verifikimeve te kryera nga kjo drejtori ne Sistemin Informatik Tatimor C@.TS te drejtorise sone, ka rezultuar se personi i gjetur ne momentin e ushtrimit te kontrollit, nga grupi i inspektoreve te Sektorit te Verifikimit ne Terren, z. FN, nuk rezulton i deklaruar si punonjes prane subjektit " me nr. NIPTI .

Kjo vertetohet nga Deklarata numer E-SIG 025 Listepagesa e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi, periudha tatimore viti 2014, muaji Korrik e deklaruar nga vete subjekti ku pasqyrohet se ka trembedhjet te punesuar por asnjerin me kete emer. Nga verifikim i kryer dhe nga dokumentacioni qe vete paditesi na ka vene ne dispozicion rezulton se, personi FN qe drejtonte automjetin ne momentin e ushtrimit te kontrollit ne daten 18.07.2014, nuk ka qene i deklaruar ne organin tatimor te pakten nje dite kalendarike perpara fillimit te punes si i punesuar prane subjektit " me nr. NIPTI, ne zbatim neni 119 pika 1 te ligjit i ndryshuar. Gjithashtu nga po ky dokumentacion dhe nga verifikimi i tij rezulton

se, personi, qe drejtonte automjetin ne momentin e ushtrimit te kontrollit ne daten 18.07.2014, ka qene i deklaruar si i punesuar (Punetor i prodhimit te gelqeres) ne organin tatimor prane subjektit ""sh.p.k. me nr. NIPTI L , perfaqesuar nga znj. ne cilesine e perfaqesuesit ligjor, sic provohet nga Deklarata numer E-SIG 025 Listepagesa e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi periudha tatimore viti 2014, muaji Korrik. Pra rezulton e provuar se deklarimi i ketij punonjesi prane organit tatimor nuk eshte kryer, te pakten nje dite kalendarike perpara fillimit te punes nga ana e paditesit sic e parashikon neni 119 i Ligjit nr. 9920 date 19.05.2008, por ky punonjes eshte deklaruar si i punesuar prane subjektit., qe nuk ka lidhje me subjektin "", pasijo vetem qe kane nr. NIPTI te ndryshem, kane edhe perfaqesues ligjore te ndryshem madje edhe adresa te ndryshme te ushtrimit te aktivitetit. Pra eshte mese evidente se perballe dispozitave ligjore dhe ne zbatimin e tyre keto dy shoqeri jane dy persona juridik teresisht te ndryshem qe nuk kane asnje lidhje midis tyre, kete ka pasur parasysh edhe administrata tatimore ne momentin qe ka vendosur penalizimin me gjobe ne shumen 500.000 leke te shoqrise"" per mosdeklarim punonjesi.

Pra ne permbledhje te sa me siper rezulton se, drejtuesi i automjeti me targa FJ, ishte deklaruar si i punesuar prane subjektit sh.p.k. dhe ne momentin e ushtrimit te kontrollit, po transportonte mallra per llogari te subjektit "", me nje automjet ne pronesi te subjektit . Pra ne kushtet kur drejtuesi i automjetit me targa transportonte mallra te shoqeruara me Faturen Tatimore Shitje me nr. Serie, qe sherben si dokument justifikues i detyrueshem per shoqerimin e mallit, por ky person nuk figuron si punonjes i deklaruar ne asnjerin prej dy subjekteve qe pasqyrohen ne Fature Tatimore Shitje, pra as ne subjektin shires dhe as ne subjektin transportues te mallit., prandaj me te drejte dhe ne zbatim korrekt te ligjit, Drejtoria e Vleresimit te te Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit prane drejtorise sone pasi ka kryer verifikimet ne sisternin informatik tatimor, lidhur me deklarimet e kryera nga vete paditesi ka kryer kontabilizimin e gjobes, duke nxjerre Njoftim Vleresimin per Detyrimet Tatimore me , per detyrimin tatimor gjobe ne shumen 500.000 leke per mosdeklarim te nje punonjesi. Pra ne kushtet kur drejtuesi i automjetit me targa me date 18.07.2014, po transportonte mallra dhe nuk ka qene i deklaruar ne organin tatimor te pakten nje dite kalendarike perpara fillimit te punes si i punesuar minimalisht as prane subjektit qe po transportonte mallin ne momentin e kontrollit dhe as prane subjektit shires te mallit ", ky person konsiderohet si punonjes i padeklaruar ne organin tatimor dhe detyrimisht subjekti duhej te penalizohej me gjobe per sb.kelje te dispozites ligjore qe sanksionon detyrimin per deklarim. Megjithese gjate shqyrtimit gjyqesor perfaqesuesi i paditesit pretendoi se shoferi i shoqerise nuk mund te shoqeronte mallin ate dite pasi i ndodhi nje problem shendetesor i papritur me femijene tij

dhe dokumentacioni ishte bere gati dhe malli duhej te transportohej per te bleresi po ate dite. Por gjate gjykimitjo vetem qe kjo thenie mbeti e pa provur me asnje dokument shkresor nga ana e tij, por as nuk u sqarua saktesisht arsyeja se pse ate dite malli nuk u transportua, nga njeri prej dymbëdhjete punonjësve të tjerë të shoqërisë "" të cilët rezultojnë të deklaruar sipas Deklaratës mimer E-SIG 025 Listepagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punesimi periudha tatimore viti 2014, muaji Korrik të depozituar pranë gjykatës.

Pretendimet e paditesit nuk qendrojnë pasi ligji tatimor udhezimi dhe aktet e tjera ligjore e nenligjore në zbatim të tij, nuk njohin "konceptin. e administrimit familjar të biznesit", megjithatë administratorët e disa bizneseve mund të kenë lidhje familjare ose farefisnore, ndërmjet tyre nuk mundet kurrësesi të përdorin punonjësit e njeri tjetrit për të kryer shërbime të ndryshme dhe të pretendojnë se i kanë të deklaruar këte punonjës pranë organit tatimor në një nga subjektet që kanë në administrim. Përham; ligji i cdo subjekti i pajisur me një nr. NIPTI, me një përfaqësues ligjor që e administron atë dhe adresë të deklaruar në organin tatimor është një subjekt i vetëm juridik, që detyruesisht duhet të deklarojë cdo të punësuar dhe të paguajë detyrimet tatimore sipas llojit të tij për llogari të organit tatimor.

Kjo tregon qartë se nga ana e subjektit është vepruar me qëllim në mënyrë abuzive, për t'ju shmangur këtij detyrimi që ligji e parashikon për të qenë korrekt në zbatimin e tij. Këte arsyetim ka pasur parasysh edhe Drejtoria e Apelit Tatimor, kur ka vendosur me Vendimin nr. Prot. date 02.04.2015. Nga Sektori i Verifikimit në Terren, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, është mbajtur një Akt - Konstatimi që është një akt administrativ pasojë e kontrollit të ushtruar. Ky akt është nxjerrë nga një strukturë që ka kompetencën për ta hartuar dhe është nënshkruar nga grupi i inspektorëve që kanë ushtruar kontrollin po atë elitë në vendin ku ka ndodhur ngjarja. Megjithatë përveç kësaj dispozite që në këtë rast është respektuar nga ana e jone, përseri e theksojmë se në rastin konkret ligji i zbatueshëm është Ligji me nr. 9920 date 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe jo Ligji me nr. 10 279, date 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative", që citon Gjykata Administrative e Shkalles së Parë Gjirokastrë.

Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr, 8897 Prot. date 18.12.2014, është nxjerrë në respektim të Ligjit nr. 9920 date 19.05.2008, dhe Udhezimit të nxjerrë në zbatim të tij, dhe nuk ka shkelur asnjë dispozitë ligjore. Provohet qartë se Gjykata Administrative e Shkalles së Parë Gjirokastrë, i jep një interpretim të gabuar ligjit të zbatueshëm. Gjykata Administrative e Shkalles së Parë Gjirokastrë arsyeton se Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë duhej të kishte degjuar palën paditese, mbi verifikimet e kryera nga ana e saj dhe pas këtij veprimi administrativ, duhej të kishte marrë aktin administrativ atë të denimit me gjobë. Një argument i tillë nuk qëndron pasi nuk gjen mbështetje ligjore në asnjë dispozitë të Ligjit nr. 9920 date 19.05.2008. Referuar nënvepër 106, 108 të Ligjit nr. 9920 /2008 dhe Udhezimit nr, 24 date 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar pika 106 e 108, përcaktohet qartë se Drejtoria e Apelit Tatimor është i vetmi organ që ka kompetencë të plotë për shqyrtimin e cdo njoftimi vlerësimi, cdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, cdo kërkesë për rimbursim ose lehtësim tatimor, ose cdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor, në lidhje me tatimpaguesin. Madje në nenin 108 pika 4 të ligjit, parashikohet edhe

e drejta e cdo tatimpaguesi per tu degjuar nga administrata tatimore lidhur me pretendimet e tij. Pra ligji ja njeh shprehimisht vetem Drejtorise se Apelimit Tatimor, te drejten per te degjuar pretendimet e tatimpaguesve dhe jo Drejtorive Rajonale Tatimore, sis: argumenton Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Gjirokaster ne vendimin e saj. Po ashtu kjo gjykate arsyeton se Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokaster, ka denuar paditesin ne kundershtrim me nenin 37 te Ligjit nr. 9920 /2008.

Ne rastin konkret nuk jemi perpara marrjes se vendimit administrativ per tatimpaguesin apo pasurine e tij. Akti administrativ, Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr.,eshte nxjerre pas verifikimit ne vend nga grupi i kontrollit.

Ndryshe nga sa argumenton Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Gjirokaster ne vendimin e saj, Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokaster nuk ka vepruar ne kundershtrim me dispoziten ligjore te nenit 108 te Kodit te Procedurave Administrative, pasi ky nen nuk detyron Drejtorine Rajonale Tatimore Gjirokaster por detyron shprehimisht Drejtorine e Apelnit Tatimor sic parashikohet ne nenin 108, pika 5, te Ligjit nr. 9920/2008. Te gjitha provat e vena ne dispozicion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokaster, gjate ketij gjykimi

dhe baza ligjore e perdorur ne gjobitjen e ketij subjekti, nuk u moren parasysh nga kjo gjykate, duke cuar ne dhenien e nje vendimi ne kundershtrim me ligjin dhe provat e paraqitura ne kete gjykim. Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Gjirokaster nuk mori parasysh se paditesi ne kerkesepadine e tij, nuk citon asnje baze ligjore te Ligjit me Nr. 49 I 2012, me te cilin kerkohet qe Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Gjirokaster, te inicioje dhe te gjykoje kete ceshtje administrative.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi degjoi relatimin e gjyqtarit ne dhome keshillimi:

VEREN

Rrethanat e faktit :

Drejtoria Rajonale Tatimore ne funksion te inspektim kontrollit ne date 18.07.2014, ka rnbajtur akt konstatimin me, ndaj tatimpaguesit. Ne Akt Konstatimin percaktohet se: "Bazuar ne Urdherin e Punes nr. date 16.07.2014. ne automjetin me targe u ushtrua kontroll, nga ku rezultoi si me poshte: Automjeti me shte i pajisur me fature tatimore shitje me nr.. Automjeti drejtohej nga Z me mjet identifikues patente. Mbahet ky akt per ndjekje te metejshme",

Pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokaster, nepennjet shkreses date 18.12.2014 ka bere njoftim vleresimi per detyrimet tatimore, drejtuar nepermjet te cilit tregohet se DRT Gjirokaster, mbeshtetur ne te dhenat qe ndodhen ne DRT, pala paditese detyrohet te paguaje gjobe ne shumen 500 000 !eke per mosdeklarim te nje punonjesi sipas akt konstatirnit.

Pala paditese ka ushtruar ankim kunder Njoftim Vleresimit Tatimor date 18.12.2014. Me vendim nr. date 02.04.2015, pala e paditur, Drejtoria e Apelimit Tatimor i ka kthyer pergjigje paditesit, ku eshte lene ne fuqi gjoba ne vleren 500 000 leke. Paditesi me njohjen e vendimit te mesiperm i eshte d.rejtuar

Gjykates, me kerkese padine me objekt dhe pale si me siper cituar.

Pretendimet e pales paditese

Pala paditese ka pretenduar se, shtetasi eshte i deklaruar si i punesuar ne organin tatimor prane subjektit " Shpk. Shtetasi nuk ishte nje person i papune dhe i padeklaruar, por punonjes i subjektit "" Shpk, si dhe automjeti qe drejtonte eshte ne pronesi te subjektit.

Pala paditese ka pretenduar se, te tre perfaqesuesit ligjor te 3 subjekteve te permendura me siper jane ne lidhje te ngushte familjare me njeri-tjetrin, provuar ne gjykim nga permbajtja e certifikatave familjare. Per shkak te lidhjes se ngushte familjare qe kane perfaqesuesit ligjor te tre subjekteve te mesiperme dhe te natyres se ngjashme te aktivitetit bashkepunojne edhe si subjekte me njeri-tjetrin. Pala paditese ka pretenduar se, ne date 18.07.2014 shtetasi i punesuar te shoqeria ka shkuar per te ndihmuar te subjekti Shpk per nje rast urgjent pasi per arsye shendetesore te femijes mungonte drejtuesi i mjetit dhe ka shkuar te drejtoje mjetin shtetasi ate dite. Kjo ndodhi per shkak te lidhjes familjare midis perfaqesuesve ligjore te 3 subjekteve, bashkeshortet

Pala paditese ka pretenduar se, nuk ka asnje arsye perse duhet te penalizohet me gjobe per mosdeklarim punonjesi, sepse shtetasi eshte i deklaruar i punesuar, per ate periudhe prane subjektit, pra nuk eshte nje person i papune, gjithashtu lidhur me pretendirnin e pales se paditur se, po shiste mallra per llogari te subjektit Shpk, me nje automjet ne pronesi te subjektit Shpk, nuk eshte I vertete pasi nuk po shiste mallra por thjesht po behej transport per subjektin Shpk.

Pala paditese ka pretenduar se, eshte nje subjekt i rregullt tatimpagues, penalizimi me gjobe per rastin e mesiperm eshte i padrejte dhe duhet te shfuqizohen.

Pretendimet e pales se paditur

Pala e paditur ka pretenduar se, se akt konstatimi i mbajtur me date 18.07.2014 eshte percjelle per veprime te metejshme ne DRT Gjirokaster, meqenese shoqeria Shpk, ka seline ne lagjen "Zingjira Gjirokaster", si rrjedhoje eshte tatimpagues i regjistruar prane DRT Gjirokaster, dhe te gjitha deklarimet ne sistemin iuformatik on-line dhe pagesat ne nivelin e dyte, i kryen ne adrese dhe per llogari te DRT Gjirokaster, ku ndodhet e administruar dosja e ketij subjekt.

Pala e paditur ka pretenduar se, pas verifikimeve te kryera nga kjo drejtori ne sistemin informatik tatimor te DRT Gjirokaster ka rezultuar se, personi i gjetur ne momentin e ushtrimit te kontrollit, nga grupi i inspektoreve te sektorit te verifikimit ne terren, nuk rezulton i deklaruar si punonjesi prane subjektit Shpk. Personi nuk ka qene i deklaruar prane shoqerise te pakten 1 dite perpara puosimit, per rrjedhoje pala e paditur ka zbatuar dispoziten ligjore neni 119/1 te Ligjit 9920/2008 "Per procedurat Tatimore ne RSH".

Vleresimi i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Gjirokaster :

Gjykata ka cmuar se, kerkimet e pales paditese jane te bazuara ne prova dhe ne ligj, per rrjedhoje ka vendosur pranimin e kerkese padise.

Gjykata ka vleresuar se, palet e paditura nuk provuan perpara gjykates se ndaj paditesit eshte marre ne vend gjoba. Ne seance gjyqesore u provua se "Bazuar ne urdherin e punes 46428, date 16.07.2014 se subjekti same siper ne automjetin me targe u ushtrua kontroll nga ku rezultoi si me poshte: Automjeti me targe ishte i paisur me fature tatimore shitje me nr. Serie date 18.07.2014. Automjeti Drejtohej nga Z. me mjet identifikues patent. Mbahet ky akt konstatimi per ndjekje te metejshme ". Gjykata ka cmuar se, ne akt konstatimin nuk tregohet se paditesi ka kryer kundravajtjen administrative, nuk tregohet se paditesi eshte ndeshkuar ose do te ndeshkohet me gjobe per kryerjen e kundravajtjes administrative te parashikuar nga neni 119 te Ligjit nr. 9920/2008. Ne akt konstatim nuk tregohet se, eshte pyetur I punesuari, nese ishte i deklaruar si i punesuar apo jo, nese nga pala paditese ishte kryer kundravajtje administrative ose jo. Gjykata ka konstatuar se, pala paditese eshte njohur vetem me njoftim vleresimin tatimor, pa njohje paraprake te meparshme sic urdherojne dispozitat urdheruese neni 37 i Ligjit 9920/2008 dhe neni 16 i Ligjit Nr. 10279 date 20.05.2010 "Per kundervajtjet administrative". Palet e paditura nuk provuan se nga ana e tyre eshte shqyrtuar kundravajtja administrative per te cilen ka nxjerre si detyrim gjobe shumen prej 500000 leke. Gjykata ka cmuar se, dispozita ligjore neni 16 i Ligjit per kundravajtjet administrative, detyron organin administrativ re shqyrtoj kundravajtjen administrative ne prani te kundervajtesit. U provua se pala e paditur nuk ka shqyrtuar kundravajtje administrative si te kryer nga paditesi dhe jo mete kete layer ate ne prani te tij. Gjykata ka cmuar se, pala e paditur pa disponuar aktin administrativ, vendimin per kundravajtje administrative te marre ne respektim te dispozites ligjore neni 13 e vijues te Ligjit nr. 10279/2010, e ka vendosur ne njoftim vleresimin tatimor. Neni 119 i Ligjit 9920/2008 parashikon masen administrative denimin me gjobe te subjektit i

cili nuk deklaroi personat e punesuar. Pra dispozita ligjore parashikon aktin administrativ, vendimin e denimit me gjobe, vendim i cili duhet te merret ne zbatim te dispozitave ligjore mbi inspektimin ne Republiken e Shqiperise dhe dispozitave te Ligjit mbi Kundravajtjet Administrative.

Gjykata ka cmuar se, DRT Gjirokaster ne kundersizim me dispoziten ligjore neni 108 te K.Pr.Administrative ka marre aktin administrative Njoftim Vleresimi Tatimor. Neni 108 i K.Pr.Administrative e detyron organin administrativ, DRT Gjirokaster te arsyetoje aktin administrativ vendimin e denimit me gjobe, akt i cili prek te drejta dhe interesa te ligjshem te paditesit. Gjykata ka cmuar se, bazuar ne faktin se pala paditese eshte ndeshkuar per nje punonjes qe ka qene i punesuar, pra i deklaruar ne organin tatimor si i punesuar, ne faktin se shoqerite per te cilen eshte konstatuar, shtetasi si i punesuar dhe ne momentin e kontrollit eshte gjetur duke punuar per llogari te nje subjekti tjeter, ne faktin se administratorer e shoqerise kane lidhje te ngushte familjare, bashkeshorte e vella e meter, faktin se ne momentin qe po pergatitej automjeti per transport, eshte ngarkuar dhe prere fatura e shoqerimit te mallit shoferit qe ka qene i punesuar dhe siguruar prane Shpk, I ka dale nje problem familjar, dhe meqenese nuk kishin shofer tjeter, shtetasi eshte derguar per te bere transportin e mallit me farure date 18.07.2014, si dhe ne faktin se pala paditese nuk paraqiti prova qe te provoje se paditesi eshte i punesuar prane pale paditese, krijon bindje se akti administrativ, njoftim vleresimi tatimor eshte i pavlefshem dhe duhet te shfuqizohet. Gjykata ka cmuar se, nuk u provua ekzistenca e marreveshjes, ndermjet punernarresit dhe punedhenesit" Shpk, qe rregullon marredheniet e punes dhe permban te drejtat dhe detyrimet e paleve. Gjithashtu nuk u provua se shtetasi ka marre persiper te kryje sherbimin e transportit kundrejt pageses qe pala paditese duhej t'ia paguante. Gjykata ka cmuar se, akt konstatimi date 18.07.2014, nuk tregon se eshte pyetur shtetasi mbi punesimin e tij, ku ai ishte

i punesuar. Akt konstatimi nuk ka deklarime te dhena nga shtetasi se ai ka qene i punesuar prane pales paditese ne menyre qe ndaj tij te vendosej sanksioni i parashikuar nga neni 119 i Ligjit 9920/2008. Referuar same siper gjykata ka krijuar bindje se, kerkesepadia e paditesit eshte e bazuar ne ligj dhe prova dhe per kete ajo duhet te pranohet.

Vleresimi i ceshtjes nga Gjykata Administrative e Apelit:

Se pari, gjykata vlereson te evidentoje kompetencen e saj per shqyrtimin e ankimit objekt i ketij gjykimi. Ne referim te nenit 7, nenit 10 dhe nenit 44 te Ligjit Nr. 49/2012, kjo gjykate ka kompetencen lendore dhe funksionale per gjykimin e kesaj ceshtjeje.

Se dyti, vlereson te marre ne shqyrtim kushtet e pranueshmerise se ankimit. Sikurse eshte referuar edhe me siper ne kete vendim, rezulton qe vendimi te jete shpallur ne daten 03.06.2015. Sipas procesverbalit te dates 03.06.2015, vendimi eshte shpallur ne prezence te pales paditese dhe pales se paditur. Ankimi nga pala e paditur eshte paraqitur ne daten 19.06.2015, nisur me sherbimin postar ne date 18.06.2015, pra brenda afatit, te percaktuar ne nenet 443 paragrafi i pare dhe 444 paragrafi i pare te K.Pr.Civile. Po keshtu, nuk rezulton te ekzistojne kriteret penguese te parashikuara ne nenin 45 te Ligjit Nr. 49/2012 qe e bejne vendimin te paankimueshem. Ankimi rezulton te jete i plote edhe ne elementet e tjere, si ne elementet e fonnes edhe te pennbajtjes, lidhur me nenshkrimin nga pala qe e ka paraqitur, tregimin e paleve ndergjyqese, vendimin kunder te cilit eshte paraqitur ank.im, apo kerkimet per te cilat ai eshte paraqitur. Per te gjitha sa me siper, gjykata cmon se, ankimi i paraqitur kunder vendimit Nr., date 03.06.2015 te Gjykates Administrative te Sbkalles se Pare Gjirokaster, objekt gjykimi, duhet te pranohet per shqyrtim.

Se treti, procedura e zhvillimit te ketij gjykimi rezulton te jete ne perputhje te plote me dispozitat e Kodit te Procedures Civile. Nuk konstatohen shkelje si ne proceduren e zhvillimit te gjykimit edhe ne proceduren e marrjes se vendimit nga gjykata e shkalles se pare.

Gjykata Administrative e Apelit cmon se, Vendimi i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Gjirokaster eshte marre ne zbatim te gabuar te ligjit dhe si i tille do te ndryshohet, per arsyet e meposhtme:

Referuar kerkesepadise, pala paditese ka kerkuar shfuqizimin e akteve administrative Njoftim Vleresimi Tatimore nr. date 18.12.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Gjirokaster dhe vendimit nr. date 02.04.2015 te Drejtorise se Apeliti. Tatimor. Ne nenin 118 te K'Pr.Administrative parashikohet se:

"Aktet administrative do te quhen relativisht te pavlefshme, ne kuptim te ketij Kodi, kur ato jane nxjerre ne kundershkim me ligjin, por megjithate nuk jane absolutisht te pavlefshme."

Gjykata cmon se, referuar aktit te konstatimit date 18.07.2014, nga ana inspektoreve te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Tirane, eshte ushtruar kontroll, verifikim ne vend, percaktohet se:

"Bazuar ne Urdherin e Punes nr. date 16.07.2014, ne automjetin me large u ushtrua kontroll, nga ku rezultoi se me poshte: Automjeti me targe ishte i pdjisur me fature tatimore shitje me nr. Serie date

18.07.2014. Automjeti drejtohej nga Z. me mjet identifikues patente. Mbahet ky akt per ndjekje te metejshme". Pra rezulton se mjeti drejtohej nga ana e Z. _____.

Gjykata konstaton se, me pas Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokaster, bazuar ne Akt konstatimin e sipercituar te mbajtur nga inspektoret e Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane, kane bere verifikimet perkatese ku kane konstatuar se, Z._____ nuk eshte i deklaruar si punonjes ne Shoqerine Shpk. Referuar sa me siper, pala e paditur ka vendosur te penalizojte palen paditese ne shumen 500 000 leke, dhe per te cilen ka dale njoftim vleresimi per detyrimet tatimore me nr. date 18.12.2014.

Gjykata konstaton se, pala paditese ka kryer proceduren e ankimit administrativ lidhur me Njoftim Vleresimin per Detyrimet Tatimore date 18.12.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Gjirokaster, prane Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane dhe kjo e fundit me vendimin e saj me Prot. date 04.04.2015, ka lene ne fuqi Njoftim vleresimi per detyrimet date 18.12.2014.

Gjykata cmon se, lidhur me gjoben e vendosur ndaj paditesit, per mosdeklarim te punonjesve, akti i konstatimit i mbajtur nga punonjesit e administrates tatimore eshte mbajtur ne formen e kerkuar nga ligji, dhe akti ka fuqi te plote provuese.

Gjykata konstaton se, akti konstatimit, ka te percaktuar daten dhe muajin ne te cilin eshte mbajtur akti, shkeljen konkrete, gjithashtu ka percaktuar emrat e punonjesve te cilet jane gjetur gjate kontrollit te mjetit te cilet kane qene te shoqeruar dhe me Faturen Tatimore te Shitjes me nr. Serie date 18.07.2014, fature e cila mban te shenuar se transportues eshte gje e cila nuk eshte mohuar nga pala paditese.

Gjykata e gjen te bazuar pretendimin e pales se paditur se akti i konstatimit eshte mbajtur ne perputhje me Ligjin nr. 10279 date 20.05.2010, pasi ne nenin 13 te tij percaktohet se:

"I. Per kundervajtjen administrative parashikohet:

a) marrja e gjobes ne vend, ne rastet kur kjo parashikohet nga ligji i vecante;

b) mbajtja e aktit administrativ qe konstaton shkeljen apo e nje dokumenti tjeter te barasvlershem me te nga personal e ngarkuar me ligj ose me akte te organeve te pushtetit vendor, ne rastet kur konstatimi i shkeljes eshte i lidhur me vendin lat ndodh ngjarja;

c) nxjerrja dhe njoftimi i vendimit te organit tii ngarkuar nga ligji, kur konstatimi i ngjarjes lidhet me shqyrtimin e dokumentacionit apo te te dhenave te tjera.

2. Ne rastin e parashikuar ne shkronien "b" te pikes 1 te ketij neni akti administrativ qe konstaton shkeljen apo dokumenti tjeter i parashikuar nga ligji i posacem si i barasvlershem me te e qe nuk eshte procesverbal giobe i bashkelidhet vendimit per kundervajtjen administrative qe vendos denimin me giobe.

3. Ne rastet kut denimi me gjobe eshte pjese e nje akti administrativ me te gjere, qe trajton edhe ceshtje te tjera, pjesa qe percakton denimin me gjobe trajtohet ne perputhje me dispozitat e ketij ligji, sipas organit qe e ka nxjerre ate. Referuar dispozites se sipercituar Gjykata cmon se, akt konstatirni i cili ka konstatuar shkeljen, eshte ne perputhje me piken 2 te nenit 13, te Ligjit m. 10279/2010. Gjykata cmon se, bazuar ne procedurat e percaktuara qarte ne Ligjin per Procedurat Tatimore, ne baze te akt konstatimit eshte bere verifikimi perkates nga Inspektoret Tatimore, nga ku ka rezultuar se punonjesi, rezulton i punesuar prane organeve tatimore, por jo prane pales paditese, por prane Shoqerise Shpk.

Gjykata cmon se, rezulton se, provuar se Dy shoqerite, jane dy subjekte te ndryshme me vende te ndryshme aktiviteti dhe me aktivitete te ndryshme, dhe Z. eshte i punesuar prane Shoqerise, ndersa nuk rezulton si i deklaruar ne organin tatimor per sherbimin e kryer si drejtues i mjetit per transport malli prane Shoqerise Shpk, subjekt i cili i eshte nenshtruar kontrollit nga pala e paditur. Referuar sa me siper, Gjykata cmon se akti i konstatimit eshte i vlefshem dhe se gjoba bazuar ne kete akt konstatimi njoftuar me Njoftim Vleresimin Tatimor me nr. date 18.12.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Gjrokaster eshte e vlefshme, pasi eshte mbajtur ne formen e kerkuar nga ligji. Ne nenin 119, Mosdeklarimi ipunonjesve, te Ligjit nr. 9920, date 19.05.2008, "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, parashikohet se :

"1. Nese nga verifikimi dhe kontrolli ne vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar ne organin tatimor cdo tii punesuar rishtazi, tii pakten nje dite kalendarike perpara fillimit tii punes, pervec detyrimit per pagimin e shumes se detyrimeve tatimore dhe kontributeve tii sigurimeve shoqerore e shendetesore, tii llogaritura nga data e konstatimit, denohet me gjobe per cdo punonjes tij padeklaruar si me poshte:

a) tatimpaguesit e regjistruar si sub;ekte tii tatimit mbi vleriin e shtuar dhe tatimit mbi (i.timin. gjobe prei 500 000 (veseqind miii) lekiish:

b) tatimpaguesit e tjere, gjobe prej 250 000 (dyqind e pesedhjetë mijë) lekesh.

2. Per rastet e konstatuara nga zyra tii shkeljes se afatit te deklarimit te punonjesve, sipas pikes 1 tii ketij neni, tatimpaguesi denohet me gjobe 10 000 (dhjetë mijë) leke per cdo deklarate te padorezuar apo tii dorezuar jashte afatit.

3. Tatimpaguesi duhet tii deklarojii ne organin tatimor tii larguarit nga puna brenda 10 diteve nga data e largimit. Per shkeljen e ketij afati, detyrimet vleresohen deri ne daten e deklarimit tii tyre ne organet tatiinore."

Ne nenin 108 pika 5 te Ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, eshte parashikuar se: "Barra e proves, per te vertetuar se nje vleresim tatimor ose vendim eshte i pasakte, bie mbi tatimpaguesin.

Gjykata konstaton se, referuarankimit te here nga pala paditese, drejtuar Drejtorise Apelimit ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve, pala paditese ka pranuar se Z ka qene punonjes i shoqerise Shpk dhe jo i shoqerise Shpk, pale paditese ne kete gjykim, per njedhoje gjykata cmon se pala paditese ka pranuar ne menyre te plote se Z. nuk rezulton si i deklaruar ne organin tatimor per sherbimin e kryer si drejtues i mjetit , per transport malli prane Shoqerise Shpk, per njedhoje drejte eshte vleresuar nga pala e paditur se, pala paditese ka pasur detyriminligjor per te deklaruar punonjesit prane organeve tatimore sipas dispozitave te percaktuara ne Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008, dhe se mosdeklarimii te punesuarve perben shkelje tatimore administrative.

Referuar same siper clhe provave ne dosje gjykata cmon se, rezulton e provuar se vendimi i pales se paditur, lidhur me gjoben per shkeljen e pretenduar ndaj paditesit, per mosdeklarim te punonjesve, eshte i mbeshtetur ne ligj dhe ne prova.

Duke u bazuar ne same siper, Gjykata Administrative e Apelit, bazuar ne nenin 50 germa "c" te Ligjit Nr. 49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", perfundimisht cmon se vendimi i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Gjrokaster, eshte i

pabazuar ne ligj dhe si i tille duhet te ndryshohet dhe te rrezohet padia e paditesit.

Lidhur me te drejten per te paraqitur rekurs kunder ketij Vendimi, ne Gjykatën e Lartë, Kolegji Administrativ, Gjykata cmon se: Objekt i padise ne gjykim eshte shfuqizimi i aktit administrativ, Njoftim Vleresimi Tatimor nr. Prot date 18.12.2014 i Drejtorise Rajonale Tatimore, Gjyrokaster qe permban detyrim ne te holla ne shumen 500 000 leke. Ne nenin 56 te Ligjit 49/2012 parashikohet se: "Nuk lejohet rekurs ndaj vendimeve perfundimtare te Gjykates Administrative te Apelit per padi me objekt:

b) kundërshtimin e aktit administrativ qe permban detyrim ne te ho/la, me vlere me te vogel se dyzetfishi i pages minimale, ne shkalle vendi;

Ne rastin ne shqyrtim akti administrativ, Njoftim Vleresimi Tatimor nr. Prot date 18.12.2014 i Drejtorise Rajonale Tatimore, Gjyrokaster eshte akt qe permban detyrim ne te holla ne masen 500.000 leke. Pra kjo ssume eshte me e vogel se 40 fishi i pages minimale ne shkalle vendi, cka do te thote se ndaj Vendimit te Gjykates Administrative te Apelit, nuk mund te behet rekurs ne Gjykatën e Lartë.

PER KETO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar ne nenet 49 e 50, germa "b", dhe 56 te Ligjit nr.49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative".

VENDOSI

Ndryshimin e Vendimit te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Gjyrokster nr., date 03.06.2015, ne kete menyre: Rrezimin e padise se paditesit Shoqeria Tregtare Shpk, si te pabazuar ne ligj dhe ne prova. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te paditesit.

Kunder ketij vendimi nuk lejohet e drejta e rekursit ne Kolegjin Administrativ te Gjykates e Lartë.

.....

5.2.2.2. Vendimi nr.3, "Për moslëshim kuponi tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve"

PADITESE: Shoqeria tregtare sh.p.k.

TE PADITUR: Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve.
Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Elbasan.

OBJEKTI: Anullimin e aktit administrativ, Njoftim Vleresimi Prot Dt.26.03.2014 lëshuar nga Drejtoria e Tatim-Taksave Elbasan, ne shumen 280.000 leke.

BAZA LIGJORE: Nenet 32, 106, 107, 108, 109, 153, 154, 154/a, 156, 185 te K.Pr.Civile, Ligji Nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", Ligji Nr.9920 Dt.19.05.2008 "Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise".

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Dures, me Vendimin Dt.24.12.2014, ka vendosur:

1. Rrezimin e kerkese-padise.
2. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales paditese.
3. Kunder ketij vendimi lejohet ankimi ne Gjykatën e Apelit Administrativ Tirane brenda 15 diteve duke jilluar ky afat nga dita e neserme e shpalljes se ketij vendimi. Per palet ne mungese ky afatfillon nga dita e neserme e komunikimit".

Padiesi sh.p.k, ka ushtruar kunder ketij vendimi, te drejten e ankimit ne Gjykatën e Apelit Administrativ, duke kerkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kerkespadise, sipas objektit, per keto shkaqe:

"Gjykata nuk ka zhvilluar nje proces te rregullt ligjor.

Per faktin se Gjykata thote: se i dha fund hetimit gjyqesor dhe fton palet ndergjyqese te parashetrojne pretendimet , palet ndergjyqese nuk kane marre pjese ne gjykim, pala paditese eshte theritur perpara gjykates tre here, pala e paditur nuk ka marre pjese asnje here dhe gjykata me date 24.12.2014, jo vetem i padituri Tatim-Taksa, nuk jane paraqitur, por edhe paditesi ka qene ne mungese, pra gjykata nuk ka bere hetim gjyqesor, nuk ka ftuar palet te bejne parashtrimet e te shprehim pretendimet, sepse ishin ne mungese, pra gjykataformalisht ne parim hodhi nje sy kerkese-padise dhe e rrezoi ate pa e argumentuar dhe pa hetim gjyqesor.

Parashtrimi i fakteve dhe provave:

Ne fshatin te komunes Gjocaj te rrethit Peqin, paditesi ka ne pronesin e tij nje pike karburanti vertetuar me aktin e pronesise date 18.01.2013. Ka filluar aktivitetin nefund te muajit Janar, fillon ligjerisht aktivitetin duke qene i regjistruar perpara organit tatimor me nr nipti.

Me dt 07. 03.2014, vijne per kontroll ne subjekt 2 inspektore te hetimit-tatimor dhe konstatojne se subjekti ka te instaluar, nje disiburtor (Pompe) me 6 pistoleta, ku 4 pistoleta ishin ne pune dhe 2 te bllokuara me numurat perkates, si dhe subjekti ka te instaluar nje kase fiskale, e cila nuk eshte ne gjendje pune.

Kjo gje eshte e vertete ashtu sikunder e kemi pranuar se kasa nuk ishte ne gjendje pune, per shkak te c'rregullimeve te energjise elektrike, po keshtu nga ana e inspektoreve, eshte konstatuar mungesa e deftesave tatimore, te cilat perdoren ne rastet kur nuk punon kasa elektronike, ne lidhje me kete kontroll dhe konstatim subjekti tregetar nuk e kundërshton sepse eshtefakt.

Me prishjen kases elektronike, ne si subjekt njoftuam menjehere ne telefon servisin kompetent dhe i relatuam avarine dhe gjendjen aktuale te kases, por nga neglizhenca jone dhe duke menduar qe kasa eZektronike do te rregullohesh, nuk kishim deftesa dhe nuk nxituam te terhiqnim deftesa tatimore qe zevendesoshin kuponat e kases elektronike, dhe kjo neglizhence ku ne si subjekt i terhoqem nga Tatimet deftesat tatimore me date 13.02.2014, pra nga data 07.03.2014 deri me date 12.03.2014, subJekti tregetar ka punuar realisht, pa deftesa tatimore dhe me kase elektronike jo ne gjendje pune.

Inspektoriati i hetimit tatimore, referuar ligjit nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise ", neni 122, pika 1, germa b. l dhe germa a, duke e penalizuar me dy gjoba perkatesisht me 80. 000 leke (per kasen) dhe 200. 000, leke per mungesen e deftesave tatimore meqense nuk punon kasa fiskale. Gjobat e vene nga inspektoriati hetimor tatimor, nuk jane ne respekt te ligjes dhe konkretisht referuar nenit 122, pika b dhe g, te ketij ligji, sepse:

1. nuk mund te penaZizohet subJekti ne rastin konkret me dy gjoba per te njejten shkelje apo parregullsi e cila eshte neglizhence dhe mos pasje dijeni, meqense eshte dhe aktiviteti i ri qe ka jilluar ne Janar te ketij viti dhe ku ishte rasti i pare qe pati c'rregullime kasa jiskaze sic i dhame shpjegime me lart, Jo vetem qe nuk ka fshehJe apo mos deklarim te shitjeve per periudhen 07. 03.2014 deri 12. 03.2014, por i kemi plotesuar shitjet me fatura tatimore.

2. inspektoriati i hetimit tatimore, ne venien e gjobave, ka gabuar duke e per/shire penalitetit si periudhe Mars-2014, ku do te thote sipas mendimit te inspektoreve se muaji Mars 2014, penalizohet si i tere i per/shire ne parregullsi me kase te prishur dhe pa fature tatimore, kjo eshte gabim dhe duhet anulohet per arsye se, parregullsia dhe shitja pa fature tatimore i perket vetem datave 07.03.2014 deri me date 12.03.2014, pra gjashte dite te cilat referuar nenit 124, te ligjit 9920, date 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne R.SH", ku shprehet: Neni 124 Kundravajtjet ne leshimin e faturave tatimore "Mosleshimi i fatures tatimore apo i fatures tatimore me TVSH, denohet me Gjobe te barabarte me 100% te detyrimit tatimore, te padeklaruar ose te pa paguar, si rezultat I mosleshimit te fatures, pervec detyrimeve tatimore dhe interesave, qe llogariten dhe paguhen ne perputhje me dispozitat e ketii ligji dhe te ligjeve specifike".

Se pari kjo gjobe vjen ne kundershtim edhe me vete dizpoziten pra me ligjin me nr.9920 dt.15.06.2008 neni 122 pika 1. Perfundimish subjekti tregetar ", ka patur parregullsi ne kasen fiskale e cila nuk ishte ne gjendje pune ne momentin e kontrollit per shkaqe te arsyeshme (c'rregullime te kases, nga luhatje te energjise elektrike, si dhe per momentin dhe neglizhencen tone qe eshte fakt dhe te pranuar nga ana jone se nuk kishim deftesa tatimore, te cilat perdoren ne rastet kur nuk punon kasa elektrokine, dhe kjo parregullsi zgjati vetem 6-dite, megjithse edhe keto gjashte dite ne i kemi dokumentuar dhe deklaruar te gjitha shitjet me fature TVSH-je, c'ka do te thote se nuk kemi fshehur, mosdeklaruar, apo shmangur detyrimet tatimore, ne e pranojme kundravajtjen dhe jemi dakort qe sipas nenit 124, te ligjes te paguajme ne ormen e gjobes detyrimit 100%, te javes 07.03.2014 deri 12.03.2014, e cila ne llogaritje detyrimi (i cili ligjerishte eshte dekaluar dhe paguar), por ne pranojme sic e thame me lart ne formen e gjobes e cila eshte e barabarte me 35. 000 leke te reja TVSH =detyrim ".

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Dures, me Vendimin Dt.24.02.2015, pas shqyrtimit paraprakisht te elementeve formale te ankimit, ka vendosur ne perfundim pranimin e tij.

GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV

pasi degjoi relatimin e ceshtjes nga gjyqtari kryesues, referuar akteve bashkengjitur dosjes:

VEREN

Nga aktet bashkengjitur dosjes qe i perket vendimit objekt ankimi, konkretisht Ekstraktit te Regjistrimit Dt.09.12.2013 leshuar nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, rezulton se paditesi " sh.p.k., ushtron prej vitit 2013, aktivitet tregtar ne fushen e hidrokarbureve.

Ne funksion te ketij aktiviteti, shoqeria administron nje pike furnizimi me karburant, me vendndodhje ne fshatin Bardhas, Elbasan. Inspektoret e Drejtorise Rajonale Tatimore Elbasan, gjate kontrollit te ushtruar me date 07.03.2014 ne ambientet e ushtrimit te aktivitetit te pales paditese, kane konstatuar mosperdorimin e kases fiskale dhe mosleshim kuponi tatimor, fakte keto te pasqyruara ne Akt• Konstatimin Nr. serie Dt.07.03.2014, nenshkruar rregullisht nga paditesi. Mbi bazen e ketyre fakteve, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan rezulton te kete disponuar Njoftim Vleresimin Prot Dt.26.03.2014, qe konsistori ne gjoba, ne shumen e pergjithshme 280.000 leke. Mbi rekursin administrativ te tatimpaguesit/paditesit, Drejtoria e Apelimit Tatimor rezulton te kete disponuar Vendimin Nr. Prot Dt.24.07.2014, qe konsiston ne lenien ne fuqi te njoftim vleresimit mete dhenat e sipercituara.

Duke mos qene dakort mesa me siper, tatimpaguesi sh.p.k. e ka bere ceshtjen konflikt gjyqesor, duke kerkuar nepermjet kerkespadise se tij, anullimin e Njoftim Vleresimit. Gjate gjykimit ne shkalle te pare, paditesi ka pretenduar te njejtat fakte, te konfirmuara edhe ne ankimin kunder vendimit te gjykates se shkalles se pare, pasqyruar ne pjesen hyrese te vendimit tone.

Gjate gjykimit ne shkalle te pare, te zhvilluar ne mungese te paleve te paditura, i padituri DRT Elbasan, nepermjet parashtimeve me shkrim te dorezuara ne k/sekretari, ka prapesuar se:

"Shoqeria" sh.p.k. eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe ushtron aktivitet ne fushen e tregetise se karburanteve me pakice. Nga ana Jone eshte mbajtur nje akt administrativ, objekt gjykimi ku eshte penalizuar shoqeria me detyrimin 280.000 Leke gjobe per mosmbatje ne gjendje pune te kases fiskale dhe mosleshim kuponi tatimor.

Duke mos qene dakort me kete detyrim eshte ankimuar ne Drejtorine e Apelimit Tatimor ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve Tirane brenda afatit ligjor 30 ditor, po ky detyrim ka mbetur ne fuqi, dhe ne keto kushte ankimi administrativ konsiderohet I ezauruar, ne kuptim te shterimit te rruges administrative, ne mbeshtetje te ligjit 49/2012 "Per organizimin e Gjykates Administrative ...".

Ne lidhje me pretendimet e pales paditese per theme/in e padise, kemi bindjen se nga ana e inspektoreve te D.R. T Elbasan jane zbatuar me perpikmeri te gjitha hapat ligjore dhe proceduriale per konstatimin dhe penalizimin e shoqerise.

Ne substance, pasi eshte ushtruar kontroll prane pales paditese, eshte konstatuar se nje nga pompat e karburantit nuk ishte lidhur me kasen fiskale e cila ishte jashte pune. Kjo perben shkelje le nenit 122

te ligjit 99 20 dt.19. 05. 2008 "Per procedurat tatimore ne R.Shqiperise" dhe eshte gjobitur ne masen 800. 000 leke. Gjithashtu eshte konstatuar se ky tatimpagues nuk leshonte kupon tatimor dhe per kete shkak eshte penalizuar me gjobe ne vleren 200. 000 Zeke, ne mbeshtetje le nenit 122 te ligjit 9920 dt.19. 05.2008 "Per procedural tatimore ne R.Shqiperise ".

Ne lidhje me pretendimet e ngritura nga pala paditese, i kundershtojme si ne forme dhe nepermbajtje, per shkak se nga ana formale e gjithe procedura e ndjekur nga D.R.T Elbasan eshte e mbeshtur ne procedural tatimore, me urdher kontrolli, akt, konstatimi, akt vleresimi dhe njoftim vleresimi tatimor dhe ne permbajtje ekziston shkelja e konstatuar.

Persa i takon provave dhe dokumentacionit jemi dakort me ato te vena ne dispozicion te Gjykates nga paditesi, per arsye se Jane aktet e administrates tatimore dhe mbi te cilat eshte bazuar detyrimi tatimor, objekt gjykimi.

Si perfundim, duke pasur parasysh pretendimet dhe provat e vena ne dispozicion, kerkojme rrezimin e kerkese padise si te pambeshtetur ne prova dhe ligj ". Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Dures, me Vendimin Nr. Dt.24.12.2014, ka vendosur rrezimin e kerkespadise, duke argumentuar se:

"Gjykata referon ne rastin konkret ne nenin 35 te Ligjit nr.49 te vitit 2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative", ne te cilin eshte parashikuar shprehimisht se: "Organi publik ka detyrimin te provoje ligjshmerine e aktit administrativ, kontrates administrative dhe te veprimit tjeter administrativ, te nxjerre Jo me kerkese te paditesit, si dhe faktet qe ai ka parashtruar dhe ka vene ne themel te veprimtarise se kundershtuar ne gjykate.

Organi i administrates publike ka detyrimin te provoje ligjshmerine e veprimeve ne marredhenien e punes, nga e cila ka lindur mosmarreveshja, objekt gjykimi. Ne rastet e tjera, pala ka detyrimin te provoje faktet, ne te cilat bazon pretendimin e saj.

Par edhe ne keto raste, gjykata, edhe kryesisht, me vendim te ndermjetem, mund te vendose I kalimin e barres se proves tek organi publik, kur ka dyshime tij arsyeshme, te bazuara ne prova me shkrese, qe vertetojne se organi publik fsheh apo nuk paraqet me dashje fakte dhe prova te rendesishme per zgjidhjen e mosmarreveshjes. Ky vendim ankimohet se bashku me vendimin perfundimtar ".

Ne kete dispozite ligji nr.49/12 percakton parimin e rendesishem pocedural te barres se te provuarit, i cili ne gjykimin administrativ eshte e tille qe ligjshmeria e veprimit administrativ (ne cdo forme qofte ajo) eshte detyrim per t'u provuar nga pala e paditur organi publik, ndersa faktet objekt i ketij veprimi Jane barre per t 'u provuar nga ana e pales se paditur.

Fillimi i gjithe procedures per nxjerrjen e aktit administrativ objekt kundershtimi eshte akti i konstatimit nr., date 07.03.2014 ku eshte bere evidentimi i dy shkeljeve nga ana e tatimpaguesit konkretisht mosleshimi i kuponit tatimor si dhe mosperdorimi i deftesave tatimore, si dhe mosmbajtja ne gjendje pune e pajisjes/kases fiskale.

Procesverbali/akti i konstatimit ku evidentohet fakti i mesiperm eshte nenshkruar rregullisht nga punonjesi i gjetur ne detyre duke mos patur asnie reklamim apo kundershtim nga ana e tij ne lidhje me faktet e konstatuara, apo menyren e veprimit te perfaqesuesve te administrates tatimore. Nga ana e tatimpaguesit nuk eshte paraqitur asnje prove qe te vertetoje te kunderten e fakteve te konstatuara ne kete akt.

Ne nenin 256 te Kodit te Procedures Civile parashikohet si me poshte: "Aktet zyrtare qe perpilohen nga nenpunesi i shtetit ose personi qe ushtron veprimtari publike brenda kufijeve te kompetences se tyre dhe ne formen e caktuar perbejne prove te plate te deklarimeve qe Jane here perpara tyre, per faktet qe kane ngjare ne prani te tyre, ose per veprimet e kryera pre} tyre. Lejohet te pretendohet e kunderta vetem kur pretendohet se shkresa eshte e falsifikuar ".

Duke patur parasysh kete nen te Kodit te Procedures Civile gjykata verifikoi akt konstatimin mbajtur pre} inspektoreve te zbatimit i cili provon dhe shkeljen e konstatuar. Nga kjo analize gjykata veren se: - jemi para nje akti te mbajtur nga zyrtare, persona te veshur me pushtet; - pergjate kryerjes se detyres se tyre dhe ushtrimit te kompetencave te tyre; - qe ka per qellim te dokumentoje veprimet e kryera pre} tyre dhe ngjarje te ndodhura ne prani te tyre; i perpiluar ne formen e kerkuar nga ligji.

Fuqia provuese e nje akti zyrtar qe perben prove te plate, sipas nenit 253 te ketij kodi shprehet ne tre drejtime 1. per deklarimet e bera pre} subjekteve zyrtare; 2. per fakte qe kane ngjare ne prani te tyre; 3. per veprimet e kryera pre} tyre. Referuar rastit konkret askush nuk mund te kundershtojte se faktet qe kane ngjare ne prani te ketyre subjekteve/inspektoreve te Task-force ose te veprimeve te kryera pre} tyre perbejne prove te plate dhe nuk mund te kundershtohen vecse per fallsitet, per te provuar te kunderten e asaj qe pasyrohet ne keto akte.

Nje nga detyrat e paleve ndergjyqese ne nje proces gjyqesor eshte detyrimi i tyre te provojne faktet ku ato bazojne pretendimet apo prapsimet e tyre. Pra palet ndergjyqese kane barren e proves per te provuar faktet ku ato mbeshtesin pretendimet, kerkimet dhe prapsimet e tyre. Barra e proves ne procesin gjyqesor eshte e lidhur ngushtesisht me linjen e ndertimit te mbrojtjes te seciles pre} paleve ndergjyqese dhe me interesin e tyre per te provuar faktet ku ato mbeshtesin pretendimet e tyre. Ne nje proces gjyqesor faktet objekt verifikimi mund te jene fakte formuese apo konstitutive. Faktet formuese apo konstitutive jane faktet qe sjellin lindjen e nje te drejte. Faktet formuese gjate procesit gjyqesor duhet te provohen nga pala qe pretendon egzistencen e tyre, pra barren per te provuar keto lloj faktesh objekt verifikimi e ka pala qe pretendon lindjen e nje te drejte (zakonisht paditesi).

Duke patur parasysh raportin pretendime-prapsime te paleve ndergjyqese; vleren provuese te akt-konstatimit; pretendimet e ngritura nga pala paditese lidhur me kete akt gjykata cmon se pretendimi se permbajtja e akt konstatimit ka te dhena te pavereteta eshte nje pretendim qe duhet te provoheJ ne gjykim nga pala paditese.

Ne ligjin nr.9920, date 19.05.2008 "Per procedural Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, neni 122 "Kundervajtjet administrative ne perdorimin e pajisjeve fiskale, per leshimin e kuponave fiskale e te biletave ", pika 1, germa "a" percaktohet:

1. Tatim paguesi, person juridik ose fizik tregtar denohet ne rast se;

a) nuk instalon pajisjen fiskale per regjistrimin e pagesave me para ne dore;

i) heren e pare te konstatimit te mosinstalimit te paJisJes fiskale per te cilen eshte percaktuar nje afat vendosJe deri ne 10 dite pune me gjobe ne masen 100.000 (njqindmije) leke; ... ".

Gjithashtu ne udhezimin e MF Nr.24, date 02.08.2008 ne zbatim te ligjit pika 122, germa a "Kundervajtjet administrative ne perdorimin e paJisJeve fiskale, per leshimin e kuponeve fiskale dhe te biletave ", percaktohet;

122.1 Tatimpaguesi person Juridik ose fizik, tregtar denohet ne rast se:

a) nuk instalon paJisJen fiskale per regjistrimin e pagesave me para ne dore;

i) heren e pare te konstatimit te mosinstalimit te pajisjes fiskale per te cilen eshte percaktuar nje afat vendosJe deri ne 10 dite pune, me gjobe ne masen 100. 000 (njqindmije) leke..

Po sipas ketij udhezimi, pika 55 "Detyrimi per perdorimin e pajisjeve fiskale" percaktohet se "Personat e tatueshem, subJekte te tatimit mbi vleren e shtuar apo te tatim mbi fitimin dhe personat e tatueshem, tatimpagues i tatimit te theJshtuar mbi fitimi e biznesit te vogel Jane te detyruar te paJisen, te perdorin dhe mirembajne pajisjet fiskale ne perputhje me dispozitat e vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 781, date 14.11.2007 "Per karaktersitikat teknike e funksionale te paJisJeve fiskale sistemit te integruar te kompJuterizuar per transferimet periodike, automatike te deklarimeve financiare, sistemit te komunikimit per proceduren e dokumentacionit per miratimin e tyre dhe per kriteret per pasJisJen me autorizim te shoqerive te autorizuara per ofrimin e paJisJeve fiskale "dhe te akteve te tjera nenligjore ne zbatim te tij ". Ne kete vendim pika 1: "Detyrimi per instalimin e pasJisJeve fiskale percaktohet:

Tatimpaguesit qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe te sherbimeve per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes ose ne sektoret e vecante te percaktuar ne kete vendim apo ne udhezimet e Ministrise se Financave Jane te detyruar te perdorin pajisje apo sisteme fiskale per rregjistrimin e qarkullimit duke leshuar kuponin tatimor ...

Ne Udhezimin e MF nr. i.date 03.05.2010 "Per administrimin dhe dokumentimin e procedurave te PaJisJeve Fiskale" pika 9, "Sistemi fiskal per regjistrimin e qarkullimit te shitjeve me pakice, derivative te naftes" percaktohet menyra se si procedohet kur pajisja fiskale peson difekt te karakterit elektrik.

Ne zbatim te dispozitave ligjore dhe nenligjore te sipercituara me te drejte nga pala e paditur eshte konstatuar kryerJa e shkeljes tatimore te percaktuar ne nenin 122 te ligjit nr. 9920, date 19. 05. 2008 pasi ne momentin e kontrollit pajisja fiskale nuk ka qene ne gjendje pune dhe denimi me gjobe per kete shkelje te kryer ne shumen 80. 000 mije leke dhe pervec kesaj nuk eshte i dokumentuar as furnizimi- i ma/lit, nepermjet leshimit te defteses tatimore apo 'te kuponit tatimor dhe mosleshimi i kuponit apo defteses tatimore per shkeljet e kryera parashikohet si kundervajtje administrative dhe per te cilin neni 122, pika 1 shkronJa b, i., duke mos qene perpara te njejtës shkelje, par perpara dy shkeljeve te ndryshme te evidentuara ne menyre te qarte ne akt konstatim dhe u pranua ne fakt dhe

nga vete subjekti tatimpagues i cili nuk solli asnje prove bindese per te vertetuar te kunderten duke u gjetur akti administrativ i kundershuar i drejte ne teresine e tij.

Per ie gjitha sa me lart u argumentuan gjykata cmon se se padia e ngritur duhet te rrezohet si e pambeshtetur ne prova dhe ne ligj.

Shpenzimet gjyqesore te evidentuara ne dosje i ngarkohen paditesit".

Vleresimi i Gjykates se Apelit Administrativ.

Gjykata e Apelit Administrativ cmon se ka pengese ligjore te shprehet mbi shkaqet e ankimit te pales paditese, per arsyet ne vijim. Sikurse parashtruam edhe ne pjesen pershkruese te ketij vendimi, kundervajtasi sh.p.k rezulton te jete ndeshkuar nga DRT Elbasan me gjobe ne masen 280.000 leke, vendimi respektiv i te ciles eshte vene ne diskutim gjyqesisht, duke u vleresuar i ligjshem nga gjykata e shkalles se pare, me vendimin objekt ankimi. Ne Ligjin 49/2012, Neni 45 "Vendime te paankimueshme", parashikon se:

"Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve perfundimtare te gjykates administrative per padi me

a) kundershhtimin e denimit per kryerjen e kundervajtjeve administrative, me vlere me te vogel se njezetfishi i pages minimale, ne shkalle vendi;

b) kundershhtimin e aktit administrativ qe permban detyrim ne te holla, me vlere me te vogel se njezetfishi i pages minimale, ne shkalle vendi;

c) kundershhtimin e aktit administrativ qe ka refuzuar dhenien e detyrimit ne te holla, me vlere me te vogel se njezetfishi i pages minimale, ne shkalle vendi;

9) mosmarreveshjet qe lidhen me mbrojtjen e te drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjore, qe rrjedhin nga sigurimet shoqerore dhe shendetesore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftesise se kufizuar, me vlere me te vogel se njezetfishi i pages minimale, ne shkalle vendi".

Paga minimale, sipas VKM-se Nr.573 Dt.03.07.2013 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", rezulton e percaktuar ne masen 22.000 leke, njezetfishi i te ciles rezulton ne masen 440.000 leke, nderkohe qe paditesi " sh.p.k rezulton te jete ndeshkuar me gjobe ne shumen e pergjithshme 280.000 leke, pra ne nje mase me te vogel se njezetfishi i pages minimale ne shkalle vendi.

Gjykata shkalles se pare, sikurse parashtruam edhe ne pjesen hyrese te vendimit tone, me Vendimin Dt.24.02.2015, pas shqyrtimit paraprakisht te elementeve formale te ankimit, ka vendosur ne perfundim pranimin e tij, duke e investuar ne menyre te panevojshme, Gjykatën e Apelit Administrativ.

Menyra e zgjidhjes se ceshtjes ne rast konstatimi te rrethanave te ndryshme nga ato te percaktuara shprehimisht ne ligjin procedural, parashikohet ne Nenin 50/a te Ligjit Nr.49/2012, sipas te cilit:

"Gjykata Administrative e Ape lit ne dhome keshillimi vendos:

a) mospranimin e ankimit, ne rastet kur ankimi nuk ploteson kushtet e pranueshmerise dhe gjykata administrative e shkalles se pare nuke ka bere nie gie te tille".

Gjykat e Apelit Administrativ cmon se ndodhet ne rrethanat e parashikuara ne dispoziten e cituar me lart. Shpenzime gjyqesore lidhur me kete ceshtje ne Gjykatën e Apelit Administrativ nuk u kryen.

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne Nenin 50/a te Ligjit Nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", unanimisht:

VENDOSI

- Mospranimin e ankimit te paditesit sh.p.k, kunder Vendimit Dt.24.12.2014 te Gjykes Administrative te Shkalles se Pare Durres;
- Shpenzime gjyqesore ne Gjykatën e Apelit Administrativ nuk u kryen;
- Kunder ketij vendimi, nuk lejohet te ushtrohet rekurs ne Gjykatën e Larte.

.....

5.2.3. ÇËSHTJE TË TJERA JOTATIMORE

5.2.3.1. Vendimi nr.1, "Për mosezauruar rekursi administrative"

PADITËS: Subjekti XXsh.p.k.

I PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.
Drejtoria e Apelit Tatimor prane Drejtori e Pergjithshme e Tatimeve.

OBJEKTI: Shfuqizimin e aktit admini trativ, njoftim Vlersimi per detyrimet nr. YYYY/10 prot. date 16.09._01 dh vendimit te Drejtorise se Apelimit Tatimor nr,ZZZ/2 prot., date 05.02.2015

BAZA LIGJORE: Nenet 32, 154 te K.Pr.Civile; ligji nr. 49/201- ..p,• organizimin dhe funksionimin e gjykat administrative dhe gjykimin e administrative"; nenet 115 e vijues

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

pasi degjoi relatoren e ceshtjes dhe bisedoi ceshtjen ne teresi:

VEREN

Ne Gjykatën Administrative te Apelit ne datën 15.06.2015, eshte regjistruar ankimi I paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlore, kunder vendimit nr. XX, date 11.05.2015 te Gjykes Administrative te Shkalles se Pare Vlore, bazuar ne nenet 442, 443 te Kodit te Procedures Civile dhe nenin 48 te ligjit nr. 49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative". Keto ankime jane paraqitur ne Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare Vlore respektivisht ne datat 21.05.2015 dhe 08.06.2015. Kjo gjykate me vendimet e dates 26.05.2015 dhe 12.06.2015, ka vendosur pranimin e ankimit te pales se paditur dhe te ankimit te Avokatures se Shtetit, Zyra Vendore

Vlore duke i derguar ne Gjykatën Administrative të Apelit, së bashku me aktet e njoftimit të tyre, si dhe dosjen e gjykimit për shqyrtim.

Nga aktet e dosjes së gjykimit rezulton se në datën 19.03.2015, pala paditese i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlore me kërkesëpadinë objekt gjykimi. Kjo Gjykatë me vendimin nr. XX, datë 11.05.2014 ka vendosur:

"1. Pranimi i kërkesëpadisë së bazuar në prova dhe në ligj. 2. Shfqiizimi i aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr. YYYY/10 prot., datë 16.09.2014 dhe vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor nr. ZZZZ/2 prot., datë 05. 02.2015. 3. Ndaj këtij vendimi nuk nxirret urdher ekzekutimi. 4. Ky është një vendim i ekzekutueshëm për përmbartuesit gjyqësor nga data që vendimi të marrë formë të prërë. 5. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur. ti. Kunder vendimit lejohet ankimi brenda 15 (pësembe dhjetë) ditëve në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë duke filluar ky afat nga data nesërme e komunikimit të vendimit për palët në mungesë".

Gjykata ka gabuar në vendimin e saj pasi kjo çështje duhet të ishte nxjerrë jashtë juridiksionit të gjykatës, sepse paditesi nuk ka ndjekur rrugën e ankimit administrativ duke mos bërë pagesën e detyrimit sipas aktit administrativ nr. YYYY/10 prot., datë 16.09.2014, sikurse kërkohej nga neni 107 i ligjit nr. 9920/2008.

Rikontrolli është iniciuar nga Auditi i Brendshëm pranë DPT, për kontrollin me nr. 6343, datë, i kryer nga inspektorët _____ dhe në zbatim të referencës ligjore që pala paditese citon, vetëm inspektori _____ nuk mund të merrte pjesë në rikontroll.

Detyrimet që pala paditese i konsideron të dubluara, kanë dalë si rezultat i raportit teknik të inxhinierit të DRT-Fier në aktin e mëparshëm, detyrime të cilat pala paditese nuk i ka kundërshtuar, Edhe Auditi i DPT e ka konsideruar të mirëqenë raportin teknik të Inxhinierit. Në aktkontrollin e përpiluar për rikontrollin është pasqyruar edhe ky detyrim por nuk është kontabilizuar pasi i njëjti detyrim është kontabilizuar me aktin e parë. Pra nuk ka dublime detyrimesh të kontabilizuara.

Pala paditese nuk ka zbatuar dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund të pretendojë për hëmangie të tatimit të dyfishtë. Gjithashtu nuk paraqitet asnjë dokumentacion aplikimi në DPT për shmangien e taksimit të dyfishtë, dokumentacion i cili i është kërkuar palës paditese edhe me shkresën nr. YYYY/4, datë 23.06.2014. Gjate ushtrimit të kontrollit pala e paditur nuk i është referuar në asnjë rast udhëzimit nr. 26. por për TVSH' nenit 15. pika 2 të tij. DRT-ve Fier një rast nuk ka apeluar gjohë mbi x leke të detyrimeve për e njëjtin detyrim pasi pala padite e ka patur munde të re kundërshtojë të dhëna projekt raport- kontrollit, gjë të cilën pala paditese e ka bërë me dërgimin e Observacioneve. Kjo në zbatim të nenit 83. pika 3 dhe 6 të ligjit 9920 datë 19.05.2008 'Për procedurën tatimore në RSH, I ndryshuar. Për mos veprimin e DRT Fier për kompensimin e detyrimeve nga gjendja kreditore, kontabilizimin e aktit të rikontrollit me nr. YYYY/9, datë 04.09.2014 është nxjerrë njoftimi vlerësimi nr. YYYY/10 prot., datë 16.09.2014. Gjate kontabilizimit të aktit u konstatua situata anormale e subjektit.

Me email-in e datës 10.09.2014, situata _____ me qëllim mbartjen në korrigjimin e rubrikës 34. Në përgjigje të shkresës nr. xxxx, datë 30.09.2014 "Kompensimin e detyrimeve të dala nga akti i rikontrollit me gjendjen kreditore të TVSH", paditesit i është kthyer përgjigje me shkresën nr. xxxx/1, datë 28.10.2014 në të cilën i është sqaruar se problemi ishte teknik, i STI, dhe se për këtë i jemi drejtuar DPT për zgjidhje me shkresën nr. 14525, datë 13.10.2014. Duke qenë se problemi ishte

teknik dhe kerkonte impenjimin e disa drejtorive, eshte bere nje takim ne DPT me inspektorin e vleresimit te DRT-Fier, Drejtorin e Vleresimit te DRTFier, Drejtorin Rajonal te DRT-Fier, Inspektore te STI ne DPT, Drejtorin e STI ne DPT dhe Zevendesdrejtorin e Pergjithshem, nga ku u ngrit nje grup auditi per zgjidhjen e problemit. e zbatim te rekomandime e te Jena nga grupi i auditit, me shkresen nr. 17797 /1, date 22.12.2014 dhe email-in nr. 17797/2, date 26.12.2014, STI duhet te riformatonte dhe saktesonte situaten e TVSH-se. Drejtoria e STI ne DPT harton skriptet sipas udhezimeve te grupit te auditit dhe i nis per zbatim ne DRT-Fier ne date 26.12.2014. Menjehere pas kesaj, me date 26.12.2014 u mbajt akt vleresimi me nr. 17797/3, drejtuar sektorit te STI, u vazhdua procedura me implementimin e skripteve me date 27.12.2014 dhe situata e subjektit u normalizua.

Ne zbatim te nenit 75 te ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedural tatimore ne RSH' dhe udhezimit nr. 24, inspektori i dosjes ka njofton tatimpaguesin per te vepruar sa me shpejt me shkresen nr. xxxx/3, date 05.01.2015 per plotesimin e formulareve per rimbursim, per kompensimin e detyrimeve sipas kerkeses se tij . Ne gjithë korrespondencen e mbajtur me subjektin " XX" sh.p.k, asnjehere nuk i eshte refuzuar kompensimi i detyrimeve, por eshte sqaruar sakte situata per proceduren e ndjekur, ne zbatim te legjislacionit ne fuqi. Lidhur me shumat e ndryshme te gjendjes kreditore, konfirmimet jane dhene para dhe pas sistemimit te situates.

Procedura e ndjekur qe nga njoftim-lajmerimi per kryerje kontrolli deri ne dhenien e pergjigjeve te observacionit te projekt kontrollit (me shkresen nr. YYYY/8 prot, date procedure ligjore qe eshte shkelur nga ana e administrates per shkeljet e konstatuara gjate ketij kontrolli jane shprehur hte i administruar nga gjykata. Per sa me siper pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, ka kerkuar ndryshimin e vendimit nr. XX, date 11.05.2015 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore dhe rrezimin e kerkese padise.

Kunder vendimit te mesiperm ka paraqitur ankim Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlore, duke parashtruar keto pretendime:

- Akt vleresimi nr. YYYY/10, date 16.09.2014 eshte mbajtur nga Dega e Tatimeve Fier sipas programit te kontrollit te miratuar te cilat jane njoftuar konform procedurave administrative dhe tatimore.
- Pretendimet e pales paditese per mosrespektimin e procedures nga pala e paditur, jane te pabazuara, per shkak se shoqerise i eshte njoftuar edhe vendimi per manjen e mases administrative.
- Gjykata duhet te vendose per rrezimin e kerkese padise, per shkak se pala paditese nuk ka ezauruar rrugen administrative dhe ceshtja nuk eshte ne juridiksionin gjyqesor,
- Gjithe praktika e ndjekur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier per vendosjen e vleresimit tatimor nr. YYYY/10, date 16.09.2014 eshte nxjerre ne perputhje me ligjin nr. 8560, date 22.12.1999 "Per procedural tatimore ne Republiken e Shqiperise", ligjin nr. 7928, date 19.01.1993 "Per kontabilitetin" dhe ligjin nr. 7758, date 12.10.1993 "Per dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive per tatimet".

Per sa me siper Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlore, ka kerkuar ndryshimin e vendimit nr. XX, date 11.05.2015 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore dhe rrezimin e kerkese padise.

Kunder ankimit te mesiperm ka paraqitur kunderankim pala paditese, shoqeria " XX" sh.p.k, duke parashtruar keto pretendime:

- Ceshtja eshte ne juridiksionin gjyqesor, sepse paditesi ka ezauruar ankimin administrativ, Mospagimi i detyrimit tatimor eshte bere ne perputhje me nenin 75/1 te ligjit nr. 9920. date 19.05.2008 "Per procedural tatimore ne Republiken e Shqiperise", per shkak se nga ana e pales

paditese eshte kerkuar kompensimi i shumes se rimbursimit te TVSH-se. i ili nuk eshte kryer nga pala e paditur.

- Shoqeria nuk eshte njoftuar ne lidhje m shtese.
- Pjesemarrja e te njejtis inspektor ne dy kontrole, perben shkelje te nenit 85/1 te l
- Ne te kundert nga sa eshte pretenduar kontabilizuar dhe njoftim vleresimi del p
- Edhe nga auditimi i Ministrise se Financave eshte konstatuar se gjobat e vendosura per TVSH jane te gjitha ne masen 100% dhe inspektoret aplikojne edhe nenin 115, pika l te ligjit.
- Procesverbalet mbajne datat 05-07.06.2014, pra perpara dates qe eshte miratuar programi shtese i kontrollit dhe shoqerise i jane here me dije bashke me raportin e kontrollit, me date 07.08.2014, duke humbur keshtu te drejten per te here kundershtimet e procesverbaleve,
- Procesverbalet e mbajtura nuk i jane njoftuar shoqerise pale paditese dhe kontrolli eshte kryer perpara se te miratohej korrigjimi i programit te kontrollit.
- Referuar korespondences me Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve, nga data 04.09.2014-05.01.2015, rezulton se DRT Fier nuk ka marre masa per kompensimin e detyrimeve.

Per sa me siper pala paditese, shoqeria " XX" sh.p.k, ka kerkuar lenien ne fuqi te vendimit nr. XX, date 11.05.2015 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore.

Rrethanat faktike te ceshtjes

Pala paditese, shoqeria " XX" sh.p.k, eshte shoqeri tregtare e organizuar ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, e cila ushtron aktivitetin e saj ne fushen e prodhimit dhe tregtimit te energjise elektrike, si dhe burime te tjera energjitike.

Me shkresen nr. YYYY prot., date 25.04.2014 "Njoftim lajmerim per kryerje kontrolli", pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, ka njoftuar shoqerine lidhur me ushtrimin e kontrollit nga ana e saj, nderkohe qe me shkresen nr. YYYY/1 prot., date 25.04.2014 "Program kontrolli", i ka derguar shoqerise pale paditese programin e kontrollit. Referuar akt kontrollit te dates 26.08.2014, kontrolli i pales se paditur perfshinte kontrollin per tatim fitimin e vitit 2010 dhe 2011, per TVSH-ne, sigurimet shoqerore, sigurimet shendetesore e tap per periudhen 07/2010-03/2012, si dhe shqyrtimin e kerkeses se here nga shoqeria per rimbursim te TVSH-se kreditore me nr. 4.211 prot., date 19.03.2012. Me njoftim vleresimin per detyrimet tatimore nr. YYYY/10, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, ndaj paditesit eshte vendosur detyrimi nese njoftim vleresimi per detyrimet tatimore dhe akt kontrolli i hkresen nr. YYYY/9 prot., date 05.09.2014. Nga aktet e administruara ne gjykim, rezulton se me kerkesen nr. xxxx prot., date 30.09.2014 pala paditese i eshte drejtuar pales se paditur duke kerkuar kompensimin detyrimit tatimore sipas njoftim vleresimit per detyrimet tatimore nr. YYYY/10 prot., date 16.09.2014. Konkretisht pala paditese ka pretenduar se per periudhen e kontrolluar subjekti rezulton me gjendje TVSH te rimbursueshme ende te pakthyer ne shumen 35.000.000 leke, qe rezultojne gjendje me date 28.02.2014 dhe per kete arsye ka kerkuar kompensimin e detyrimit qe do paguaje per efekt te apelimit te detyrimit tatimor, ne shumen 17.419.476 leke. Ne pergjigje te kesaj shkrese, pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, eshte shprehur se kerkesa per kompensim detyrimesh nuk mund te plotesohet sepse nuk e mundeson programi i sistemit informatik, e po ashtu ka konfirmuar se rimbursimi i TVSH-se se miratuar eshte ne shumen 22.321.012 leke. Nderkohe me shkresen nr. xxxx/3 prot., date 07.01.2015 drejtuar shoqerise pale paditese, pala e paditur ka konfirmuar se ne daten 27.12.2014 eshte kryer sistemimi i situates duke bere mbartjen e kredise se TVSH-se ne menyre progresive, per periudhen tatimore 2012/02 detyrimet e mbetura ishin ne shumen 3.169.747 leke, detyrimet ne kete periudhe tatimore ishin 14.162.861 leke, detyrime te zbritura 10.993 .114 leke dhe detyrimet per periudhat e tjera nuk

kane ndryshuar.

Duke mos qene dakort me kete vendimmarrje te pales se paditur, paditesi e ka ankimuar ate ne Drejtorine e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, e cila me vendimin nr. ZZZ/2, date 05.02.2015 ka vendosur refuzimin e ankimit me arsyetimin se paditesi nuk ka ndjekur rrugen e ankimit administrativ duke mos here pagesen e detyrimit te percaktuar ne aktin administrativ objekt ankimi. Ne keto kushte paditesi i eshte drejtuar gjykates me kerkesepadine e kerkuar shfuqizimin e ketyre akteve administrative objekt gjykimi pasi ato jane ne kundershtrim me ligjin.

Pas analizes se akteve e provave te administruara ne gjykim, te rrethanave te faktit e te ligjit, si dhe pretendimeve te paleve ndergjyqese, gjykata e shkalles se pare ka arritur ne perfundimin Se kerkesepadia objekt gjykimi eshte e bazuar ne ligj dhe ne prova dhe per kete arsye ka dale me vendim per pranimin e saj. Gjykata ka konstatuar se Drejtoria e Kontrollit Tatimor ne DRT• Fier ka ushtruar kontroll prane shoqerise sipas lajmerim dhe program kontrollit nr. YYYY. Sipas ketij program kontrolli shoqeria dote kontrollohej per periudhen 07/2010 deri me 03/2012 per TVSH, sigurimet shoqerore dhe shendetesore sipas detyrave te lena nga Auditi I Brendshem. Te Ministrise se Financave. Ne lidhje me detyrimet e nxjerra ne njoftim vleresimin tatimor te cilat i referohen aktit te kontrollit i mbajtur ne daten 30.07.2014 inspektoret e kontrollit tatimor kane dale jashteperiudhes se kontrollit. Ne programin e kontrollit paraqitet periudha nga 07/2010 deri me 03/2012 per TVSH, sigurimet shoqerore dhe shendetesore, periudhe per te cilat shoqeria u ka vene ne dispozicion dokumentat. Ne lidhje me periudhen e rikontrollit te tatim fitimit nuk eshte per kete periudhe. Gjithashtu eshte shkelur neni 50, pika 6.3 "Per TVSH" i ndryshuar duke konsumuar 480 ore pune nga kontrollit.

Gjykata ka cmuar se persa i perket aktit te kontrollit konstat ligjit nr. 9920, date 19.08.2008 "Per Procedurat tatimore", i ndryshuar inspektori ka qene pjese e grupit te kontrollit te meparshem dhe nuk ka paraqitur ndonje kerkese nga inspektori per konflikt interesi, si dhe per te njejtën ceshtje mban dy qendrimi te ndryshme.

Gjithashtu kemi dyfishim detyrimesh te cilat jane rinxjerre si dhe jane njoftuar nga kontrole te meparshme.

Moszbatimi i marreveshjes nderkombetare dy paleshe, konsiston ne mospagimin e regjistruar ne organet tatimore respektive dhe qe paguajne duhet qe ne rastin konkret kemi keqinterpretim te udhezimit nr. 26, duke i dhene fuqi prapavepruese per detyrime. Ne rastin konkret ka shkelje te nenit 11 te ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne R.SH" si dhe shkelje te ligjit mbi administrimin e dokumentave udhezimit nr. 17, date 25.07.2011. Gjithashtu eshte konstatuar te ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne nenin 30-34 e 37 , tatimpaguesit duke i shkaktuar pales paditese nje dem te pad kompensim detyrimesh nga gjendja kreditore, duke zvarritur pka shkaktuar paditesit nje dem te madh dhe te padrejte.

Nxjerrja e akteve dministrates publike qe perfaqeson ne vetvete produktin e nje vonenese, paraprihet nga zhvillimi i nje procedure administrative te rregullt dhe ligjore, kjo nenkupton detyrimin e organit administrativ qe ne procesin e nxjerrjes se akteve administrative te respektoje nje sere parimesh esenciale kushtetuese- dhe ligjore te veprimtarise se administrates publike si ai i ligjshmerise, proporcionalitetit, pergjegjshmerise dhe transparences. Gjykata ka cmuar se ky rivleresim i bere prej administrates tatimore nuk qendron pasi ai eshte i kunderligjshem dhe per kete arsye duhet te

shfuqizohet si njoftim vleresimi ashtu dhe vendimi e Drejtorise se Apelimit Tatimor.

Per sa me siper, gjykata e shkalles se pare ka vendosur pranimin e padise si te mbeshtetur ne prova dhe ne ligj duke disponuar per shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vleresimit per detyrimet nr. YYYY/10 prot., date 16.09.2014 dhe vendimit te Drejtorise se Apelit Tatimor m. ZZZ/2 prot., date 05.02.2015.

Vleresimi i ceshtjes nga Gjykata Administrative e Apelit

Se pari Gjykata vlereson te evidentoje kompetencen e saj per shqyrtimin e ankimit objekt i ketij gjykimi. Ne referim te nenit 7, germa "a", nenit 10, paragrafi 2, germa "a" dhe nenit 44 te ligjit nr. 49/2012, kjo Gjykate ka kompetencen lendore dhe funksionale per gjykimin e kesaj ceshtjeje.

Se dyti Gjykata vlereson te marre ne shqyrtim kushtet e pranueshmerise se ankimit. Sikurse eshte referuar edhe me siper ne kete vendim, rezulton qe vendimi te jete shpallur ne daten 11.05.2015, dhe ankimet nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe Avokatura e Shtetit, Zyra Yendore Vlore, jane paraqitur brenda afatit pesembedhjeteditor, te percaktuar ne nenet 443, paragrafi i pare dhe 444, paragrafi i pare te Kodit te Procedures Civile. Po keshtu, nuk rezulton te ekzistojne kriteret penguese te parashikuara ne nenin 45 te ligjit nr. 49/2012 qe e bejne vendimin te paankimueshem. Ankimi rezulton te jene te plote edhe ne elementet e tjere, si ne elementet e formes edhe te permbajtjes, lidhur me nenshkrimin nga palet qe i kane paraqitur, tregimin e paleve ndergjyqese, vendimin kunder te cilit jane paraqitur ankimet, apo kerkimet per te cilat ato jane paraqitur. Per te gjitha sa me siper gjykata cmon se ankimet e paraqitura kunder vendimi nr,XX, date 11.05.2015 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore, objekt gjykimi. Duhet te pranohen per shqyrtim.

Se treti Ne analize te pretendimeve te parashtruara ne kerkesen paditese, te pretendimeve te pales se paditur dhe Avokatures, parashtruara ne ankim, te provave e akteve shkresore te administruar ne perputhje me ligjin, Gjykata Administrative e Apelit vlereson se vendimi marre ne analize te gabuar te ligjit e fakteve.

Ne nenin 137, pika 3 te Kodit te Procedurave Administrative palet e interesuara mund t'i drejtohen gjykates vetem administrative:

Per sa me siper, konkludohet se nje prej kushteve qe gjykata perpara se te marre ne shqyrtim pretendimet e lidhura, detyrimet per ezaurimin e rekursit administrativ, kriter pro per t'u respektuar nga pala paditese dhe qe ben efektive te i permbushjesse ketij kriteri pala paditese mund t'i drejtohet ' ne vend te te drejtave te shkelura apo te mohuara.

Ne kete moment eshte i nevojshem te theksohet fakti se, per jo te ketij kriteri procedural, duhet te merren ne shqyrtim Shqiperisi:P', i cili eshte ligji qe rregullon procedurat per administrimin e detyrimeve tatimore ne Republiken e Shqiperise, si dhe parimet e organizimit e te funksionimit te administrates tatimore ne Republiken e Shqiperise dhe qe ka qene ne fuqi ne kohen e nxjenjes se akteve administrative objekt kundershimi.

Ne nenin 106 te ketij ligji eshte parashikuar shprehimisht se: "Tatimpaguesi mund te ankimoje kunder cdo njoftim vleresimi, cdo vendimi qe ndikon ne detyrimin e tij tatimor, cdo kerkese per rimbursim ose lehtesim tatimor, ose cdo akti ekzekutiv te posacem tatimor, ne lidhje me tatimpaguesin. 2. Ankimi behet me shkrim dhe ne formen e parashikuar ne zbatim te ketij ligji me udhezim te Ministrit

te Financave. 3. Tatimpaguesi e dorezon ankimin ne drejtorine e apelimit tatimor brenda 30 diteve kalendarike nga data kur vleresimi ose vendimi i administrates tatimore eshte marre ose vleresohet te jete marre nga tatimpaguesi. ".

Ndersa ne nenin 109, pika 2 te tij eshte sanksionuar se: "Tatimpaguesi mund ta kundërshtojë vendimin e drejtorise se apelimit tatimor ne gjykate, brenda 30 diteve kalendarike nga data e marrjes dijeni per kete vendim. Nese drejtoria e apelimit tatimor nuk shprehet brenda tre muajve nga data e marrjes se ankimit, tatimpaguesi mund te ankohe drejtperdrejt ne gjykate", Nderkohe ne piken 38.1 te udhezimit nr. 24, date 02.09.2008 "Per procedural tatimore ne Republiken e Shqiperise", i cili ka dale ne zbatim te nenit 10, pika 1 te ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" eshte parashikuar se: "Ne cdo rast kur tatimpaguesi nuk eshte dakord me nje akt administrativ dhe beson se administrata tatimore nuk e ka zbatuar ne menyre korrekte ligjin, ai ka te drejten e ankimit ne Drejtorine e Apelimit Tatimor prane DPT, duke kerkuar rishqyrtimin e pavarur administrativ te ceshtjeve qe lidhen me keti: akt. Nese tatimpaguesi nuk do te jete i kenaqur edhe nga vendimi i Drejtorise se Apelimit, ai ka te drejte te vazhdoje ankimin e tij ne gjykate",

Ne piken 69.4 te tij percaltohet se: "Personi i tatueshem. qe nuk eshte dakord me vleresimin tatimore, ka te drejte ta ankimoje ate brenda 30 diteve kalendarike nga data e marri se nioftimit te vleresimit ne perputhie me procedural e parashikuara ne kreun XIII te ligjit .

Ne analize te dispozitave te mesiperme, konstatohet se kushti i nevojshem qe duhet te ekzistojë, ne menyre qe subjekti te legjitimohet ne ngritjen e padise kunder njoftimeve te vleresimit tatimor eshte ezaurimi i rekursit administrativ. Po keshtu, konstatohet se subjekti tatimpagues pretendon se eshte cenuar nga vendimmarrja e organeve te administrates publike, ne menyre qe te ligjerohet ne parashtrimin e pretendimeve te tij prane organeve gjyqesore, duhet t i parashtroje me pare keto pretendime, prane organeve me te larta te vete administrates tatimore, sic eshte ne rastin konkret Drejtoria e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve.

Ne rastin objekt gjykimi nuk jemi ne asnje prej perjashtimeve te ligjit nr. 49/2012, sepse ligji i posacem per procedurat e Financave i dale ne baze e per zbatim te tij parashikon ankimin administrativ dhe nuk parashikon shprehimisht te drejten per t' u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtperdrejt ne gjykate. Per rrjedhoje, akses i gjykate per paditesin behet i mundur vetem pas shterimit te ankimit administrativ, kushti procedural i nevojshem qe duhet te permbushet ne menyre qe te legjitimohet subjekti i interesuar per t'ju drejtuar gjykates.

Ne analize te rrethanave te faktit e te ligjit sa me siper, si edhe te akteve e provave shkresore te administruara ne gjykim, konstatohet se nga ana e pales paditese, shoqerise " XX" sh.p.k, nuk eshte permbushur detyrimi per ezaurimin e ankimit administrativ, fakt ky qe sjell si pasoje pamundesine e kesaj pale per tju drejtuar gjykates me kerkesepadine objekt gjykimi. Ne pretendimet e parashtruara ne kunderankim, pala paditese ka pretenduar se rekursi administrativ vleresohet i ezauruar, per shkak se kjo shoqeri kishte te drejten e kompensimit te detyrimeve qe duhet te paguante per shkak te ankimit, me shumen e teprices kreditore, referuar kerkeses se saj nr. xxxx prot., date 30.09.2014 "Kerkese per kompensim detyrimesh". Rimbursimi i TVSH-se dhe kompensimi i detyrimeve tatimore eshte parashikuar ne nenin 75/1 te ligjit nr. 9920, date 19.5.2008 "Per procedural tatimore ne Republiken e Shqiperise", dispozite ne te cilen eshte percaktuar se: "Nese personal e tatueshem, le regjistruar per TVSH, rezultojne me teprice kreditore dhe paraqesin, prane drejtorise rajonale tatimore, kerkesen per rimbursimin e TVSH se se paguar teper, administrata tatimore, brenda 30 diteve kalendarike, verifikon saktesine e pretendimit, njofton

tatimpaguesin dhe realizon rimbursimin, kur plotesohen kushtet. Ne rast te kundert, personit te tatueshem i find e drejta e mospageses se detyrimeve te tjera tatimore, ne masen e TVSH-se se pretenduar per rimbursim. Menyra dhe procedural e hollesishme teknike per zbatimin e ketij neni percaktohen ne udhezimin e Ministrit te Financave".

Po ashtu ne nenm 75/1.5 dhe 75/1.6 te udhezimit nr. 24, date 02.09.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", eshte parashikuar se: "75/1.5 Ne rastin kur administrata tatimore ka verifikuar, vleresuar dhe njoftuar me shkrim tatimpaguesin, se nuk plotesohen kushtet ligjore per rimbursimin e TVSH-se, duke dhene edhe sqarimet perkatese, tatimpaguesi nuk mund le pretendoje t'i rimbursohet TVSH-ja e kerkuar per rimbursim e as te kaloje TVSH-ne e pretenduar per t'u rimbursuar per llogari te detyrimeve te tjera. Ne kete rast tatimpaguesi mund te ndjeke le gjitha procedurat ligjore le apelimit. Kompensimi i detyrimit per t'u paguar (detyrim sipas vetedeklarimit me deklaraten tatimore fillestare) me shumen e TVSH-se se e deklarimit te deklarates tatimorefillestare vetem ne rastin eklarate i perket nje periudhe tatimore pas periudhes ne te e vetem per detyrim te papaguar sipas deklarates tatimore te percaktuara sipas ketij ligji apo ligjeve specifike eshte i detyrueshem per t'u zbatuar ne cdo rast, pemdryshe mosdeklarimi ne kohe dote behet shkak per llogaritjen e kamatevonesave dhe gjobave sipas ketij ligji edhe per pagesen e detyrueshme nese tatimpaguesi dote kete sipas deklarimit".

Ne interpretim dhe zbatim te dispozitave te mesiperme, rezulton se kompensimi i detyrimit per tu paguar me shumen e TVSH-se se rimbursueshme, mund te behet vetem ne ato raste kur realizohet procedura e rimbursimit nga ana e organeve tatimore. Ligjvenesit ka parashikuar ne menyre te qarte proceduren qe ndiqet per miratimin e kerkeses per rimbursim, e cila legjitimon me tej subjektin per te kompensuar detyrimet tatimore, ne masen e TVSH-se se pretenduar per rimbursim. Lidhur me proceduren e rimbursimit, ligji kerkon qe paraprakisht administrata tatimore te verifikojte, vleresojte dhe njoftojte me shkrim tatimpaguesin per plotesimin e kushteve ligjore dhe per miratimin e kerkeses per rimbursim, rrethane kjo me konstatimin e te ciles ligji lidh edhe miratimin e kerkeses per kompensim te detyrimeve. Pra, ne menyre qe te procedohet me aprovimin e kerkeses per kompensimin e detyrimeve, kerkohet detyrimisht qe te jete realizuar procedura e rimbursimit te shumes se TVSH-se, procedure kjo qe paraprihet nga verifikimi i saktetise se shumes se pretenduar per rimbursim, vleresimin e saj dhe njoftimin e subjektit lidhur me kerkesen e bere nga ana e tij. Ne ceshtjen ne gjykim nuk rezulton qe te jene plotesuar kushtet e kerkuara nga ligji per kompensimin e detyrimeve tatimore. Pala paditese, shoqeria " XX" sh.p.k, ka pretenduar se nga ana e saj eshte ezauruar rekursi administrativ, per shkak se detyrimi qe duhet te paguhet per efekt te ankimit te njoftim vleresimit per detyrimet tatimore, ne Drejtorine e Apelimit Tatimor, ne kuptim te nenit 107 te ligjit nr. 9920, date 19.5.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", vleresohet si nje detyrim i permbushur, per shkak se detyrimi ne fjale eshte kompensuar me tepricen kreditore te shoqerise.

Pavaresisht ketij pretendimi, Gjykata konstaton se ne rastin konkret, nuk rezulton te jene ndjekur procedurat e evidentuara si me siper, te cilat ligj i i ka vendosur si parakusht per realizimin e kompensimit te detyrimeve tatimore. Konkretisht nuk rezulton qe ne ceshtjen objekt gjykimi administrata tatimore te kete verifikuar shumen e pretenduar te teprices kreditore, te kete bere vleresimin lidhur me te, te kete njoftuar shoqerine " XX" sh.p.k lidhur me te. e me nuk konstatohet qe pala e paditur, ne cilesine e organit te ad kerkesen per rimbursim. Nga hetimi gjyqesor i zhvilluar n konkludua se pala paditese ka paraqitur nr. 13 827 prot., kompensim detyrimesh", ne pergjigje te se ciles pala e paditese, detyrimet tatimore per shkak te programit te sistemit informatik, por nuk rezulton te jete ndjekur procedura e kerkuar nga ligji. Bazuar ne konsideratat e mesiperme, ne kushtet

sipercituar nuk eshte ndjekur procedura e kerkuar nga ligji lidhur me rimbursimin e teprices kreditore, nuk mund te pretendohet kompensimi i detyrimit qe duhet te paguaje pala paditese per efekt te ankimit, me shumen e TVSH-se se rimbursueshme.

Per sa me sipër, arrihet ne perfundimin se kerkesepadia objekt gjykimi nuk mund te ngrihej perpara gjykates, ne kushtet kur kerkimet e parashtruara ne te, qe lidhen me shfuqizimin e njoftim vleresimeve tatimore te nxjerra nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, nuk i jane nenshtruar me pare shqyrtimit administrativ nga Drejtoria e Apelimit Tatimor, pra nuk eshte ezaauruar rekursi administrativ, i cili perben parakusht per paraqitjen e kerkesepadise ne gjykatën administrative.

Mbi kete argumentim, Gjykata Administrative e Apelit konkludon se vendimi nr. XX, date 11.05.2015 i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore duhet te priset duke vendosur pushimin e gjykimit te ceshtjes pasi padia ne gjykim nuk mund te ngrihej. Per te arritur ne kete konkluzion kjo Gjykate referohet ne kriteret e nenit 50 germa "d" te ligjit nr. 49/2012, sipas te cilit: "Gjykata Administrative e Ape/it ne dhome keshillimi vendos: .. d) prishien e vendimit dhe pushimin e gjykimit te ceshties. ne rastet !cur ceshtia nuk hyn ne iuridiksionin giyqesor. si dhe kur padia nuk mund te ngrihej ose gjykimi nuk mund te vazhdonte".

PER KETO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar ne nenet 49 e 50, germa "d" te ligjit nr. 49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative".

VENDOSI

Prishjen e vendimit nr. XX, date 11.05.2015 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore dhe pushimin e ceshtjes.
